

ETIKA

Dymujore

Dua të pendohem me ardhjen e Ramazanit, por...

Rëndësia e muajit të Ramazanit

Muaji i rindërtimit të jetës shpirtërore

Klima e mëshirës

Bashkohu me karvanin e të devoshmëve

Hijeshitë e agjërimit

Xhamia blu e Sulltan Ahmetit

Mirë se erdhe
Ramazan!

Mirë se erdhe Ramazan



Editorial

Padyshim të gjitha ditët e ramazanit përbëjnë në vetvete një mundësi. Ky muaj nga fillimi deri në fund është shi i begatshëm i qiellit frytdhënës. Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) thotë:

“Muaji i ramazanit është muaji fillimi i të cilit është mëshirë, mesi është falje, ndërsa fundi është shpëtim nga xhehennemi...”

Ramazani është stina në të cilën derdhen në shpirtra begatitë e frytshme dhe ku shpërthen gjelbërimi pranveror shpirtëror. Zemrat e thara të besimtarëve do të pastrohen me punë të mira, zemrat dhe shpirtrat e vyshkura do të lulëzojnë me devotshmëri dhe do të bëhen më të prekshme. Ky muaj nga fillimi deri në fund do të jetë një mundësi fitimi.

Kështu e paraqet një hadith profetik faktin që ata të cilët nuk i zbatojnë nuk do të mund ta vlerësojnë këtë mundësi:

Transmetohet nga Ka’b bin Uxhre:

Pejgamberi (a.s) kërkoi prej nesh që ne të uleshim pranë minberit dhe ne të gjithë ashtu siç ishim, u ulëm aty pranë. Hipi një shkallë dhe tha “Amin!” Hipi edhe një shkallë tjetër. Përsëri tha “Amin!”. Hipi edhe një shkallë tjetër. Përsëri “Amin!” tha. Kur zbriti nga minberi i thamë:

- O i dërguari i Allahut! Sot ne dëgjuam prej teje një gjë që s’e kishim dëgjuar më parë. Më pas ai tha:

- Kur isha në minber më erdhi Xhebraili dhe kur isha në shkallën e parë më tha:

- Kush e mbërrin muajin e ramazanit dhe nuk falet, mallkuar qoftë!

Ndërsa unë thashë: “Amin!”

Kur hipa në shkallën e dytë ai më tha:

-“Mallkuar qoftë ai i cili kur të ndodhet afër Teje apo dëgjon të përmendet emri yt nuk çon salate dhe selame për Ty!

Ndërsa unë thashë: Amin!

Kurse kur hipa në shkallën e tretë më tha:

- Mallkuar qoftë ai person i cili nuk arrin të fitojë xhennetin edhe pse arrin moshën e vjetërsisë së prindërve apo kur sheh një të moshur!

Edhe unë thashë: “Ashtu qoftë o Zot (Amin!” (Hakim, Tirmidhi)

Në këtë hadith theksohet edhe njëherë rëndësia parësore që ka adhurimi, robëria, sala-vati dhe respekti ndaj prindërve në këtë muaj kaq të begatshëm.

Përsa i përket kryerjes së adhurimeve në lidhje me vlerësimin e ditëve të madhnueshme ka edhe të tilla si mbikqyrja e të varfërve, jetimëve, atyre që nuk kanë njeri, të pushpresëve bile edhe të sëmurëve që zgjatja e dorës zemrave të tilla, të jetuarit e një vëllazërie shpirtërore me ta dhe të qënurit një prehër i nxehtë për ta përbëjnë edhe aspektet më të rëndësishme që lartësojnë mirësitë e ramazanit të madhrueshëm. Pasiqë këto adhurime, pra punët e mira si sadakaja dhe zekati që u jepen njerëzve në nevojë të çojnë edhe më shumë drejt faljes dhe shpëtimit. U hapin rrugë fryteve dhe begative. Hapin dyert e mëshirës hyjnore. Mbyllin rrugën e dënimit dhe vuajtjeve. I hapin dyert e ndihmës dhe përkrahjes hyjnore.

Zoti ynë na mundësoftë jetën e kësaj bote një ramazan të vërtetë dhe na e mundësoftë mëngjesin e ditës së gjykimit një bajram të vërtetë!

Në këtë numër do të lexoni:

Dua të pendohem me ardhjen e Ramazanit, por...

Mesud Sabri

Papritur, kuptova se Ramazani kishte ardhur. Kanë kaluar nga ai disa ditë. Dëshiroja të priste pak në mënyrë që të përgatitesha për ta takuar.

4



Dua të pendohem me ardhjen e Ramazanit, por...
Mesud Sabri

| 4 |
| |

Rëndësia e muajit të Ramazanit

Naim Drijaj

Ramazani është stina e mëshirës hyjnore që i pajis besimtarët me pjekuri dhe virtyte. Ashtu siç tregohet kujdes gjatë agjërimit që të mos hyjë në gojë ndonjë gjë, po ashtu duhet të tregohemi të kujdesshëm edhe për fjalët që dalin prej goje.

16



Përse agjërojnë muslimanët?
Sejjid Husejn Nasr

| 6 | Ditari i Ramazanit
Mustafa Erish

| |

Muaji i rindërtimit të jetës shpirtërore

Sami Ramazanoglu

Allahu (xh.sh.) e ka krijuar me fuqinë e tij njeriun duke e cilësuar atë superior mbi shumicën e krijesave të tjera.

25



Ramazani nga gjuha e Profetit Muhammed (a.s.)
Isamil Lytfti Çakan

| 12 | Alkooli: e keqe e madhe e përditësisë
Nexhat Ibrahim

| |

Rëndësia e muajit të Ramazanit
Naim Drijaj

| 16 |
| |

| 18 | Ramazani dhe njeriu
Sabri Akdeniz

| |

Klima e mëshirës

Osman Nuri Topbash

Ramazani është muaji në të cilin jetojnë me emocione të mëdha katër kushtet e Islamit. Ramazani, në anën shpirtërore është një përgatitje e përtshpirtshme e adhurimit të posaçëm të haxhit në të cilin jetojnë elemente të rëndësishme.

32



Enigma e feksjes së agimit
Hasan Kamil Jëllmaz

| 22 |
| |

| 25 | Muaji i rindërtimit të jetës shpirtërore
Sami Ramazanoglu

| |

| 28 |

| 30 | Pranë nesh
Elida Kraja

| |

Klima e mëshirës
Osman Nuri Topbash

| 32 |

Përkthyes:

Adelina Muça
Alban Kali
Ali Bardhi
Artur Tagani
Elona Sytari
Elvira Puka
Ernal Nurja
Evans Drishti
Edvin Lohja
Klementina Rrepa
Naim Drijaj

Redaktor: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Viti: III Numri: 14

Shtator - Tetor 2008

Ramazani - Sheval 1429

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

Shtator - Tetor 2008

- 38| Ajete dhe hadithe
për Ramazanin
Naim Driaj



Bashkohu me karvanin e të devotshmëve Adem Ergyl

Këto ajete që tërheqin vëmendje për domosdoshmërinë e të qenit prej të devotshmëve pa ardhur vdekja, janë një paralajmërues i madh për të gjithë ne. "O besimtarë!

40

- Bashkohu me karvanin e të
devotshmëve
Adem Ergyl

- 43| A keni një minutë kohë të
më dëgjoni?
Hymejra Ezergyl



Hijeshitë e agjërimit Abdulhalim Toprak

Të ushqyerit me tepri të jep një ndjenjë përtacitë dhe mendjetrashësie, të verbon edhe intuitën, prandaj edhe në zemër përjeton një peshë që të rëndon dhe të bën të plogët.

46

- Mrekullia e Krijuesit
Fluturimi dhe qëndrimi i
shpendëve në lartësi
Ali Iljazi

- 46| Hijeshitë e agjërimit
Abdulhalim Toprak

- Ndjesi shpirtërore fetare
që kërkon ripërtëritje:
Dhurimi dhe Shërbimi
Evans Drishti

- 52| Xhamia blu e Sulltan
Ahmetit
Ali Bardhi



Ndjesi shpirtërore fetare që kërkon ripërtëritje: Dhurimi dhe Shërbimi

Vepra e autorit turk osman Nuri Topbash e titulluar "Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi" tashmë gjendet e shqipëruar në gjuhën tonë.

48

- Klerikë muslimanë
shqiptar nga Kosova
Ermal Nurja

- 58| Aktualitet
Ermal Nurja



Klerikë muslimanë shqiptar nga Kosova Ermal Nurja

Pasi kemi trajtuar në numrat e kaluar klerikët myslimanë shqiptarë të Shqipërisë së sotme politike dhe trevave shqiptare në Maqedoni...

54

- Shëndeti dhe Familja
Naim Driaj

- 62| Teknologji
Ali Bardhi

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@hotmail.com

etikaeditor@yahoo.com


Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76 768

+355 69 20 58 855

Dua të pendohem me ardhjen e Ramazanit, por...



Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Allahu gëzohet më shumë për pendimin e robit të Tij, se sa gëzimi që përjeton ndonjëri prej jush, i cili duke udhëtuar me kafshë në shkretëtirë, papritur ajo i ikë dhe në të ndodhet ushqimi dhe uji i tij. E humb shpresën se do ta gjej, ulet nën një pemë dhe shtrihet, por gjithmonë pesimist për gjetjen e saj. Ndërkohë që vazhdon në këtë gjendje, sheh përpara syve kafshën e tij, e kap për litari, pastaj nga gëzimi i madh që kishte thotë: O Zoti im, ti je robi im dhe unë jam zoti yt. Gaboi prej gëzimit të madh”. (Muslimi)

Papritur, kuptova se Ramazani kishte ardhur. Kanë kaluar nga ai disa ditë. Dëshiroja të priste pak në mënyrë që të përgatitesha për ta takuar.

Të këqijat e mia janë të shumta dhe mëkatet janë të panumërta, por me gjithë këtë unë jam mysliman, si çdo mysliman që e do shumë Ramazanin dhe pret në të mëshirën e Zotit (xh.sh.)

Çfarë të bëj? Dua të jetoj Ramazanin, dua t’i lë punët e mia të këqija, dua që agjërimi im të pranohet; kam shumë frikë.

E vërtetë është se kam bërë shumë mëkate, por bujaria e Zotit ishte që më la të jetoj deri në Ramazan.

Ai dëshiron të më falë mua.

Po, e ndjej këtë. Ky është një mesazh i veçantë mes meje dhe Zotit tim.

Ai më do mua.. Po, unë i bëj mëkat Atij, por Ai është Mëshirëbërës, Falës, Pranuesi

i pendesës, pa dyshim që Ai dëshiron të më pranojë pendimin, por unë nuk jam i përgatitur. Oh dilema ime, çfarë duhet të bëj?

“Ooooo Zot! Më ndihmo të pendohem te Ti. Dua të “ktheheeeem”, dua të “pendoheeeem”!

O Zoti im, më merr për dore, ma prano pendimin, më ndihmo ndaj egos që urdhëron për të keqen!

O ti djall, shporru nga unë, largohu prej meje, lërmë!

Aaaaaaaah, po dëgjoj të qeshurat e djallit, ai thotë: Nuk të lë ty, sepse ti je i dobët dhe do të çoj larg bindjes e adhurimit.

Po dëgjoj një zë tjetër që mua më thotë: mos ju bind atij,

ai është i dobët. Ti jo. Dëgjo thënien e Zotit “S’ka dyshim se intriga e djallit është e dobët” (4:76), “Vërtet ai (shejtani) nuk ka kurrfarë fuqie kundër atyre që besuan dhe i janë mbështetur Zotit të tyre” (16:99).

Ah grindjet e shpirtit tim, a jam unë i dobët? Jooooo , unë nuk jam i dobët... A është i fortë djalli? Jooooo, ai është i dobët, Zoti im nuk gënjen, Ai ka thënë se djalli është i dobët, d.m.th. unë jam i fortë, do të thotë mundem që unë të kthehem me sinqeritet tek Zoti.

Më kanë humbur disa ditë nga Ramazani, por akoma kanë mbetur shumë prej tij.

Çfarë po më ndalon tani që unë të kthehem? Ngrihu tani, merr abdes dhe drejtohu te Zoti yt, çfarë të ndalon? Djajtë janë të prangosur, dyert e xhenetit janë të hapura, ndërsa dyert e zjarrit të mbyllura.

Të gjithë njerëzit janë në adhurim, xhamitë të mbushura plot dhe të gjithë agjërojnë. Njerëzit falin namazin e teravisë dhe lexojnë Kur’anin. Të gjitha këto a nuk më ndihmojnë të zgjidhë prangat e mia?

Ç’është kjo? Dera po troket? Kush po më thërret? Kush?

Unë jam Ahmed. .

Urdhëro Ahmed. Selamun alejkum, si jeni?

Ve alejkum selam ve rahmet-ullahi.

- Më fal që nuk të kam telefonuar, por kam qenë i zënë.

- Nuk ka gjë.

- Nuk të kam parë në xhami që në Ramazan? Ndoshta të ka penguar ndonjë gjë e hajrit.

“Ooooo Zot! Më ndihmo të pendohem te Ti. Dua të “ktheheeeeeem”, dua të “pendoheeeeeem”!

O Zoti im, më merr për dore, ma prano pendimin, më ndihmo ndaj egos që urdhëron për të keqen!



Nuk ia ktheva; heshta pak caste. Isha i hutuar.

E vuri re heshtjen time, por me të shpejtë e ndërpreu atë dhe tha: “Sot dua të të shikoj në xhami, fryma e teravisë është e bukur dhe të mbush me gëzim”.

Foli dhe fytyra e tij shkëlqente nga gëzimi: në jetën time nuk kam parë gëzim më të madh se sa bashkimi i myslimanëve në adhurim.

Dëshiroj t’i flas por heshtja më ka mbërthyer.

Luftova me veten, duhet patjetër t’i flas dhe të dëgjoj këshillën e tij.

Pas një përpjekje të shpejtë fill-ova t’i flas dhe i thashë: “Ahmed, unë jam shumë i lodhur”.

Ja plasa të qarit. Mu afrua duke u përpjekur të më qetësoj nga trishtimi im duke më thënë: çfarë ke, o vëlla? Më thuaj, çfarë ke?

I thashë: “Dua të pendohem, por diçka në vete më ndalon. Dua të ma pranojë Zoti agjërimin tim, por nuk kam forcë për adhurim”.

Ma ktheu duke më thënë: “Mos i beso, ti mundesh të kthehesh e të pendohesh! Çdo gjë që ke në kokë janë iluzione

dhe ngacmime të djallit, por ato shumë shpejt do të mbarojnë”.

I thashë: “Si arrihet kjo?”

- Në qoftë se nuk më beson mua, tha ai, atëherë ngrihu tani, merr abdes dhe falu. Hajde ngrihu tani, po të pres.

O Zoti im, lavdi Zotit!

Tani ndjej se jam plotësisht i lirë. Nxitova për të marrë abdes, mora dhe u fala. Sikur në sytë e mi kisha pasur perde e ajo u largua dhe sikur u lirova nga robëria.

Pas namazit shokut tim i thashë: “A ke mundësi të ulesh me mua dhe të lexojmë diçka nga Kur’ani?”

Fytyra e tij shkëlqeu nga si-hariqi dhe gëzimi.

Mora librin e Zotit xh.sh, më dukej sikur po e merrja për herë të parë. Ndjeva një prehje dhe qetësi shpirtërore.

Në atë moment kuptova se ne mundemi të ndryshojmë jetën tonë dhe se shumë iluzione na ndalojnë për t’u kthyer te Zoti; le t’i shkatërrojmë këto pranga iluzive. Rruga për te Zoti është e hapur nuk ka gjë ta mbyll atë, përveç iluzioneve të cilat duhet të mos zënë vend në jetën tonë.

Ditari i Ramazanit

Akti fetar i agjërimit është i vetmi adhurim që i drejton zemrat rreth dashurisë së Allahut, që u jep mundësi shpirtrave të jetojnë emocionet e orëve të përjetësisë. Agjërimi mundëson që njeriu të marrë një gjëndje më të prekshme dhe të ndjeshme si dhe të fitojë cilësitë e larta.

Ramazani është muaji i shiut të mëshirës dhe lumturisë që shfaq begati dhe fryte në kopshtet e zemrave tona, që vjen nga qiejt e fshehtë të Allahut dhe sillet në horizontet e ummetit.

Si një shërim ashtu si shirat e prillit, si një aspekt që fal jetë dhe të mban gjallë, edhe mëshira e ramazanit nxjerr në dukje mrekullinë e tij. Ai jep mundësi që ta shpëtojë njeriun nga shtypja e ngarkesës së rëndë të materiale dhe nga robëria, si dhe ta orientojë atë drejt botërave shpirtërore duke shijuar aromën e ajrit shpirtëror, duke e shpëtuar atë nga dëshirat kalimtare, nga freskitë artificiale dhe nga shijet e përkohshme, pasi që agjërimi është bërë farz pikërisht në këtë muaj i përcaktuar si **“adhurimi i pa shembull”**

Akti fetar i agjërimit është i vetmi adhurim që i drejton zemrat rreth dashurisë së Allahut, që u jep mundësi shpirtrave të jetojnë emocionet e orëve të përjetësisë. Agjërimi mundëson që njeriu të marrë një gjëndje më të prekshme dhe të ndjeshme si dhe të fitojë cilësitë e larta.

Çdo njeri lind në natyrën e Islamit. Natyra jonë është krejtësisht e bardhë si qumështi. Nuk ka njolla. Nuk është e papastër bile nuk e ka prekur as pluhuri. Është

krejt e pastër dhe e shndritshme. Një natyrë e tillë kërkon që ta nis njeriun përherë drejt pranverës së Islamit. Prandaj ai rritet pikërisht me këto ndjenja të veçanta. Dhe sa herë që rritet dëshiron ta përngjasojë veten e tij me lulet e bukura të një stine pranverore. Ai përpiket përherë që rrethin e tij, shtëpinë, rrugën e tij ti plotësojë me këto bukuri. Pasi Allahu i Lartë që e krijoi atë thotë: **“O besimtarë! Kini frikë me të drejtë nga Allahu! Bashkohuni me të drejtët dhe të devotshmit”** Një urdhër i tillë është bërë kushtetutë e jetës.

Ramazani dhe agjërimi janë ditë adhurimi, një mundësi e hapur për të mbrojtur bukuritë e kësaj natyre që është mes nesh. Këto ditë zgjojnë në zemrën e çdo besimtari një emocion të veçantë. Ka një ndjesi besimi ndryshe, shtohen punët, rriten të mirat dhe begatitë. Shpirti i besimtarit hapet drejt vizioneve që ndriçohen me drita kandili, drejt një jete të re.

Ditët e ramazanit nuk duhet të jenë ditë që kalojnë pa agjërim. Çdo mysliman duhet të ketë një ditë të tijën të ramazanit. Pejgamberi ynë i dashur na e ka përcaktuar neve një program të tillë me hadithet e veta duke na e shpalosur edhe në jetën e tij. Ai pati thënë:

Pejgamberi ynë i dashur na e ka përcaktuar neve një program të tillë me hadithet e veta duke na e shpalosur edhe në jetën e tij. Ai pati thënë:

“Hani ushqimin e syfyrit. Pasi në këtë ushqim ka begati dhe dhunti. Mos e lini këtë ushqim qoftë edhe me një gllënkë ujë.”

“Hani ushqimin e syfyrit. Pasi në këtë ushqim ka begati dhe dhunti. Mos e lini këtë ushqim qoftë edhe me një gllënkë ujë.”

KËNAQËSIA E SYFYRIT

Ndryshimi i parë në të përditshmen tonë fillon duke u ngritur në kohën e syfyrit, duke i dhënë gjallëri kësaj kohe dhe duke marrë begatitë e saj duke ngrënë qoftë edhe dy kafshata. Kështu që në shtëpinë tona fillon një hare, në xhami një gëzim, në lagjen tonë një ripërtëritje dhe për fëmijët një gëzim dhe hare edhe më e madhe në kohën e syfyrit. Në kohën e syfyrit që i afrohet besimtarit Allahu sikur lëshon mëshirën e tij...

Dyert e nevojshme të hapura, zemrat dhe shpirtat të butë, dashuria ashtu siç e di e brendshme... merr sa të kesh mundësi mëshirën hyjnore...

Me imsak (koha e fillimit të agjërimit) hyjmë në një jetë hyjnore. Lahet goja, bëhet njeti dhe fillon xhihadi me nefsin... në fakt thelbi i gjithë adhurimeve është përpjekja me shpirtin. Zoti ynë urdhëron e thotë: **“Ne do t’u tregojmë rrugën drejt nesh aty-**

re që bëjnë përpjekje për ne” (Ankebut/69) Udhëzimi fillon nga përpjekja me veten. Me ajetin 53 të sures Jusuf **“Padyshim që nefs i urdhëron të keqen”** na tregohet për përpjekjet e nefsit që të na tërheqë drejt tij. I vetmi adhurim që thyen këtë bindje ndaj nefsit është agjërimi. I dërguari i Allahut urdhëron e thotë: **“Agjërimi është një mburojë ndaj xhehennemit dhe gjynaheve”**

Me imsakun fillojnë ezanet. Besimtarët vrapojnë turma-turma drejt xhamisë. Tashmë është shumë e lehtë të shkosh në xhami për namazin e sabahut me xhematë. Sido që të jetë jemi në këmbë. Dhe kjo për të marrë atë fryt të faljes së namazit me xhematë për 30 ditë të ramazanit sabah dhe aksham. Kjo për të arritur që të jemi ballë për ballë, zemër me zemër pranë. Për të forcuar vëllazëritë tona. Ta mbushësh shpirtin me dritën e Kur’anit duke dëgjuar mukabele në sabah, që të gjitha këto bukuri të ramazanit i janë paraqitur ymmetit. Pas namazit fillon jeta e përditshme. Dhe përsëri agjërueshëm...

Shpirti i besimtarit është i mbushur plot me bukuri të natyrës njerëzore sikurse ora e kurdisur

apo veshja e bukur që vishet. Dita duhet të kalohet sikurse koha e ushtarit që qëndron përherë me kujdes në vendin e tij të ruajtjes. Pasi edhe Pejgamberi tregon një rrugë të tillë:

“Agjërimi nuk është vetëm të ndalosh ushqimin, pirjen dhe gjëra të tilla. Agjërimi është edhe të heqësh dorë nga fjalët boshe dhe të padobishme, nga punët e këqija dhe nga përpjekjet e nefsit. Edhe nëse ndonjëri sillet keq dhe me fyerje ndaj teje thuaj me të vërtetë unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm dhe bëj durim”

Me një transmetim nga Xhabir b. Abdillahi **“Kur ti të jesh agjërueshëm duhet ti vësh në agjërim edhe veshët, gojën dhe sytë e tu nga gënjeshtria dhe harami”** është theksuar rëndësia e tre elementeve mjaft me vlerë të agjërimit. Kjo pasi njeriu shumë herë nuk ia di vlerën dhe rëndësinë këtyre tre elementeve. Me anë të agjërimit ai arrin ti shpëtojë këto nga të këqijat duke u bindur sjelljeve të mira. Gjithashtu në një tjetër hadith thuhet:

“Frymëmarrja e atij që agjëron është edhe më e këndshme dhe më e pastër se sa aroma e

miskut” Kjo pasi besimtari nuk merret me thashetheme dhe nuk u vë veshin atyre. Ai nuk sheh gjërat që janë të ndaluara. Nuk dëmton askënd me gjuhën e tij. Ai e di shumë mirë se ai i cili bën kujdes nga gjërat e ndaluara kur është agjërueshëm “qetësia e tij bëhet tesbih, gjumi i tij adhurim, duaja e pranueshme dhe punët dhe veprat e mira shtohen shumëfish”

TI DALËSH PËR ZOT SYRIT

Siç është shprehur edhe në hadithin Kudsî: **“Të shohësh haram është një shigjetë nga ato të Iblisit që kush e lëshon atë duke u frikësuar prej meje si dëmshpërblim i jap atij një besim të tillë që ndjesinë e tij e ndjen në zemrën e vet.”** Ai që agjëron do të tregohet edhe më i vëmendshëm për të mos parë gjëra haram dhe kapaku i syrit nuk do të habitet as edhe me shigjetat e mbrojtësit. Ai do ti dalë për zot syrit të vet në mënyrë që ta gjejë dhe ta shijojë edhe shijen e tij. Jeta që e përfshin besimtarin është e rrethuar me kushte të vështira aq sa mos të mund ti hapë rrugë në këtë temë... Mikrobusi... Autobusi... Vaporit... Rruga dhe lagjja e tij janë të mbushur plot me shigjetat e iblisit. Në gazetë dhe në revistë, në shtëpi dhe kudo halle... këto shigjeta që janë të drejtuara drejt njeriut tonë... Po të kesh kujdes është e vështirë... Por drita e besimit tek besimtari do të përshpejtojë hapat që të çojnë në rrugën që do të prishë këtë vështirësi për t’u bërë një njeri i plotësuar. Në këtë mënyrë do të fillojmë me netët e ramazanit. Fillimisht dotë rrjedhin mendimet pozitive Psh: armiku i botës sonë të brendshme do ti japë fund ekzistencës. Do ti japë fund edhe

Fudajl b. Ijad
është shprehur që
ta përmbash gjuhën
duke thënë: “Të
shkosh në haxh, të
dalësh për xhihad
nuk është m.ë e
vështirë se sa ti vësh
fre gojës.”

mbylljes së botimeve që do ti vërë njollë të ndryshme. Të gjitha të këqijave që do ti vijnë nga jashtë do ti vërë një pengesë. Më pas në jetën e tij do të hyjnë gjëra pozitive. Do të plotësohet me njohuri të mira dhe të bukura. Do të konceptojë kushtet që jeton dhe do të jetojë Islamin. Do të krijojë terren të përshtatshëm për të mënjeluar mangësitë. Pasi këto ditë veten e tij do ta ketë në një atmosferë më të këndshme se ditët e tjera. Me agjërimin ai do ta ndjejë veten të kompletuar...

Pejgamberi ynë (a.s.) kur ecte në rrugë nuk shihte djathtas dhe majtas por duke para majat e këmbëve. Edhe miqtë e ngushtë të Zotit të cilët janë shumë modestë ecin pikërisht duke parë majat e këmbëve. Çdo hap të tyre ata e hedhin duke thënë “Allah Allah”. Çdo frymë e marrin duke thënë “Allah Allah”. Adhurimet tona duhen përgatitur pikërisht mbi bazën e këtyre elementëve... Rrethi ynë duhet ti shohë dhe ti jetojë këto të dhëna. Ditë e Islamit ti vënë në jetë këto ndjenja dhe ju japin të fitojnë këtë etikë dhe moral të bukur. Dhe këto bëhen për atë që ndjek 5 kohët e namazit në ditë me xhematë. Dhe çfarë nuk

merr një fëmijë kur sheh babanë apo gjyshin e tij...

TË RUASH GJUHËN

Gjuha është përkthyesja e gojës. Besimtari që agjëron duhet ti dalë zot edhe gjuhës së vet. Ai duhet të përpiket që të mos nxjerrë asnjë fjalë të keqe nga goja e tij. Ai duhet të bëhet mbrojtës i gjuhës së vet për të mos lënduar askënd qoftë ky i punës, shtëpisë, pazarit, punëtorit, familjes, fëmijëve dhe komshive të vet. Gjuha është si gjarpëri. Ashtu sikurse thonë që nëse nuk i del për zot të helmon ashtu edhe thuhet: “Gjuha e ëmbël e nxjerr gjarpërin nga skuta”. Sa e vështirë është ti vësh të agjërosh edhe këto dy anë që janë sikurse anët e mprehta të thikës...

Ibn Abbas thotë: “Ose bëhu i përshtatshëm për mirësi duke thënë mirë ose gjej shpëtim nga sherri”

Fudajl b. Ijad është shprehur që ta përmbash gjuhën duke thënë: “Të shkosh në haxh, të dalësh për xhihad nuk është m.ë e vështirë se sa ti vësh fre gojës.”

Llukmani i cili thotë: “Nëse fjala është argjend, qetësia është flori” na nxit për një jetë të qetë duke na thënë: “Dija vlerën qetësisë! Kur flet flet gjëra pa bazë dhe të pamenduara!” Edhe Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) duke thënë: **“Braktisja e personit e gjërave që nuk i interesojnë është nga bukuritë e Islamit”** thekson se gjërat të cilat nuk të interesojnë janë boshe dhe të pavlera dhe nëse bën kujdes t’u shmangesh atyre bën një nga gjërat e bukura të Islamit.

Gjuha në kohën tonë ashtu si kurse mban vendin e të folurit është e nevojshme të tregojë të njëjtën përpikmëri edhe përsa i përket shenjave dhe shkrimit. Ti përshtatesh synnetit edhe në shkrime të ndryshme si libra, revista, gazeta, shkrime barcaleta etj është një dhunti e besimtarit. Mes besimtarëve duhet të ekzistojë dashuria duke iu shmangur gjërave të këqija.

Agjërimi është thujse si një fren për njeriun. Besimtari i cili bën përpjekje që të mos bie në gabime dhe të mos hyjë në gjynah në veprime të ndryshme si duke u ulur apo duke u ngritur, duke folur, duke pushuar apo duke punuar i dhuron njeriut një përpikmëri të madhe. Besimtari nuk gjendet në ato vende ku bëhen thashetheme apo punë të ngjashme. Ai preferon qetësinë. Pasi edhe miqtë e ngushtë të Allahut i ka parë në një qetësi të thellë. Brenda një jete të qetë dhe pa fjalë. Një rrjedhje dashurie nga zemra në zemër. Një qetësi mes dy dashurive që nuk do ti ketë zili askush....

Ti lutemi Zotit tonë që të na mundësojë mbërritjen e këtyre ditëve të ramazanit. Ramazan një muaj gufrani... muaji i Kur'anit... Një ramazan që është më i dobishëm se një muaj në të cilin nuk gjendet nata e kadrit... Një ramazan që kalon me hatme dhe mukabele, me salate dhe selame, me tevhide dhe tekbiere... na mundëso në shërimin tënd në shpëtimin e besimtarëve që u digjen zemrat me mallin për tu takuar me ty...

TË JAPËSH SADAKA

Ai besimtar që gjen gjerësinë dhe hapësirën e duhur në botën

Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) tek shprehet se “Nafaka që i jep njeriu fëmijës së vet është në rangun e sadakasë”, “Mbrohuni nga injoranca me sadaka. Dhe kjo edhe me një gjysmë hurme.

shpirtërore në të njëjtën situatë gjen edhe bollëkun në rriskun dhe nafakën e tij. Ai e di se është një punë që ka sevape të bollshme aq sa t’u japësh për të ngrënë dhe për të pirë, të ngopësh ushtarët e mbetur në luftë duke u shtuar nafaka në ramazan.

Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) tek shprehet se “Nafaka që i jep njeriu fëmijës së vet është në rangun e sadakasë”, “Mbrohuni nga injoranca me sadaka. Dhe kjo edhe me një gjysmë hurme. Nëse nuk e arrini as këtë të paktën u thoni atyre fjalë të mira dhe të ëmbla se edhe ajo është një sadaka.” ka krijuar një lidhje dashurie që nuk do të shkëputet me shekuj me radhë. Ai ka lidhur me njëri-tjetrin nga ana shpirtërore anëtarët e një shoqërie, familjen, të pasurin dhe të varfërin. Të jetuarit e të gjitha bukurive të Islamit është në interes të gjithë njerëzimit... ama sikur të dihet... Sikur islami të gjejë një mundësi pasqyrimi në jetën tonë...

Besimtari i cili bën përpjekje për të dalë i gjallë nga të gjitha presionet e ditës mes kaq qarqeve të gjynaheve tashmë jeton një emocion të një rezultati në hyrje

të akshamit. Koha e yftarit është në ardhje e sipër... Jeta thujse ndalet... Melekët bëjnë istigfar për robërit e tyre... Mirësitë janë shtruar përpara... Pritet urdhëri i cili vazhdon “Allahu Ekber, Allahu Ekber”. Gjithsecili duke thënë “Bismilahirrahmani rrahim” dhe duke iu bindur këtij urdhëri e hap agjërimin.

Fëmija është i lumtur, i moshuari po kështu, i riu po kështu... i pasur i varfër secili është i lumtur...

Sa botë e bukur! Apo nuk është kështu? Me dashurinë që këto ditë të arrijmë ti pasqyrojmë në çdo ditë të jetës sonë, në cdo muaj...

Besimtarë! Robëria le të mos jetë vetëm për veten tonë, Dashuria në shpirtat tanë me dritat e saj le të jetë një kandil i përherëshëm për çdo besimtarë. Të mos harrohet që jeta fetare që nuk jetohej pa shijet dhe vlerat e veta nuk ka kuptim. Ti japim atë që meriton kësaj stine xhenneti. Ti drejtohem një jete Kur'anore me thelb në punët e mira. Ti marrim në mbikqyrje të varfërit, jetimët, të vejët, të sëmurët dhe fëmijët. Ditët boshe të jetës ti kthejmë në kopështe të pavyshkura dhe të përherëshme me “punë të mira” dhe të freskëta. Të mos mbyllemi në sulltanetin e kohës dhe të biem pre e boshllëqeve të kohës. Të mos bëhemi të varfërit e ahiretit. Ta dijmë që lumturia është në rrugën e Allahut... Ndërsa keqbërësia dhe dëshpërimi janë në gjurmët e shejtanit.

Përse agjërojnë muslimanët?

Duhet tërhequr vazhdimisht nga jeta e ngarkuar e shqisave, edhe për të mundësuar shijimin e plotë të ndijimeve shqisore. Vetëm një shkallë e caktuar të përmbajturi nga objektet materiale të ndikesave, bën që edhe jeta shqisore të baraspeshohet, pa përmendur faktin se ai i lejon shpirtit njerëzor të hapet drejt jetës shpirtërore.

Disa të vërteta janë evidente për nga natyra dhe në rrethana normale nuk lypsen diskutuar doemos. Por në një çast dhe epokë, ku të vërtetat më evidente vihen në diskutim dhe mbulohen nga retë e dyshimit, duhen diskutuar edhe më të qartat prej tyre. Një nga këto të vërteta është domosdoshmëria e një elementi asketizmi në jetën njerëzore.

Pa një element sakrifice dhe përkoreje, asnjë fe - e kësisoj asnjë kulturë njerëzore - nuk është e mundur. Duhet tërhequr vazhdimisht nga jeta e ngarkuar e shqisave, edhe për të mundësuar shijimin e plotë të ndijimeve shqisore. Vetëm një shkallë e caktuar të përmbajturi nga objektet materiale të ndikesave, bën që edhe jeta shqisore të baraspeshohet, pa përmendur faktin se ai i lejon shpirtit njerëzor të hapet drejt jetës shpirtërore.

Një nga këto praktika kufizuese është agjërimi, që Islami e urdhëron si detyrim për muajin e Ramazanit dhe e këshillon për periudha të tjera të vitit.

Siç tregon Kur'ani i Shenjtë, ai është një praktikë që ekziston në fetë më të lashta dhe Islami s'bëri tjetër veçse e ripërtëriu dhe e institucionalizoi në formën e agjëritimit në muajin e Ramazanit.

Të agjëruarit gjatë këtij muaji ka shumë avantazhe dhe karakteristika, shoqërore e të jashtme, që janë diskutuar shpesh dhe rëndësia e të cilave në të vërtetë është ekzagjeruar në kontekste të caktuara, sipas të cilëve virtyti parësor i agjëritimit reduktohet në bamirësi për të varfrit.

Sigurisht, ky element bamirësie ekziston, por, si çdo bamirësi, merr kuptim shpirtëror vetëm kur i drejtohet Zotit.

Dhe, tek agjërimi është bindja ndaj Vullnetit Hyjnor për të pasur si fryt bamirësinë ndaj të skamurve e nevojtarëve dhe një pjesëmarrje reale në urinë dhe etjen e tyre.

Por aspekti më i vështirë i agjëritimit është tehu i shpatës së vetëpërmbajtjes së drejtpërdrejtë kundër egos epshore, *ennefsu'l-emareh* të përmendur në Kur'anin Famëlartë.

Nëpërmjet agjëritimit, prirjet rebele të egos epshore qetësohen dhe paqohen dalëngadalë, nga një nënshtrim sistematik i këtyre prirjeve ndaj Vullnetit Hyjnor, duke qenë se në çdo çast urie shpirti i muslimanit kujtohet që, nëse nuk u bindet pasioneve të egos epshore, kjo bëhet për t'iu bindur Urdhrit Hyjnor.

Ja përse agjërimi nuk përfshin vetëm të përmbajturit nga ushqimi, por edhe nga çdo formë e

luksi dhe pasioni eashor.

Si rezultat i këtij kufizimi sistematik, shpirti njerëzor e kupton se është i pavarur nga mjedis i afërt natyror dhe ndër-gjegjësohet që ndodhet në këtë botë, por nuk i përket asaj.

Një agjërues fiton shumë shpejt vetëdijen se në këtë botë është vizitor dhe se është krijuar si qenie e destinuar kah një synim që ndodhet përtej kësaj ekzistence materiale.

Bota që e rrethon e humbet në njëfarë mënyre materialitetin e saj dhe merr një pamje zbrahtë dhe tejdukshmërie që, në rastin e myslimanit soditës, shpie drejtpërsëdrejti në një soditje të Zotit në krijimin e Tij.

Natyra e privuar dhe e zbrahur nga gjërat, kompensohet, nga ana tjetër, me shfaqjen e po këtyre si dhurata hyjnore. Gjatë periudhës së agjërimit, ushqimi dhe pijet, që merren për të mirëqena gjatë tërë vitit, shfaqen

si dhunti qiellore dhe fitojnë domethënie shpirtërore të një natyre të shenjtë.

Po ashtu, agjërimi është veshje me mburojën e pastërtisë kundër pasioneve të kësaj bote. Ai do të thotë që trupi të përfshihet edhe “fizikisht” në pastërtinë e vdekjes, e cila natyrisht shoqërohet me lindjen shpirtërore.

Gjatë agjërimit, njeriu kujton faktin se ka zgjedhur t’i afrohet Zotit e t’i largohet botës së pasioneve. Ndaj dhe Profeti i Bekuar e donte shumë agjërimin. Ai ishte element themelor i asaj “varfërie të përshpirtshme”, për të cilën ai thoshte: “Varfëria e përshpirtshme është krenaria ime”.

Kjo vdekje nga pasionet e kullon shpirtin njerëzor nga uji i ndotur i mbetjeve negative psikike të tija. Individidi, dhe përmes tij e tërë bashkësia islame, ripërtërihet nga ky rit, që i kujton detyrat dhe objektivat morale e shpirtërore. Prandaj, ardhja e muajit të Ramazanit

pritet me hare. Gjatë tij, dyert e qiellit janë të hapura kapak për besimtarët dhe Mëshira Hyjnore zbret mbi ata që e kërkojnë.

Plotësimi i agjërimit të Ramazanit nënkupton kryerjen e rigjallërimit dhe ripërtëritjes që e përgatit myslimanin për të përballur një tjetër vit, me vendosmërinë e të jetuarit dhe të vepruarit sipas Vullnetit Hyjnor.

Agjërimi gjithashtu i dhuron shpirtit njerëzor një kundërmim, aroma e të cilit mund të ndijohet edhe për një kohë të gjatë pas mbarimit të shmangies abstenimit.

Ai i ofron shpirtit një burim energjie nga e cila ushqehet gjatë tërë vitit. Falë kësaj, muaji i shenjtë është quajtur “i begatit”, ai në të cilin begatia e Zotit vërshon mbi bashkësinë islame dhe ripërtërin burimet e saja më të thella të jetës dhe veprimt.



Alkooli: e keqe e madhe e përditësisë

Bota në përgjithësi, kurse myslimanët në veçanti sot ballafaqohen me deformime të rënda fetare, morale e shoqërore, grupe dhe individuale, në të gjitha vendet e botës. Kjo e keqe e pakundërshtueshme është alkooli, respektivisht pijet dehëse të të gjitha llojeve.

Nga kjo e keqe nuk është kursyer asnjë vend, asnjë qytet, asnjë familje, asnjë individ. Madje, edhe vendet më myslimane sot janë të goditura nga kjo sëmundje me përmasa pandemie.

Nëse dikur vendi ynë ka mundur të lavdërohet me mospërdorimin e alkoolit, madje edhe nga ana e të krishterëve si ndikim i Islamit, kjo gjendje më nuk është as në trojet tona. Kohëve të fundit, alkooli dhe vese të tjera të rënda e kanë përfshirë edhe familjen tonë, edhe lagjen tonë, edhe shkollën tonë, edhe zyrën tonë, edhe rrugën tonë, edhe qytetin tonë.

Për këtë dhe arsye të tjera këtë artikull timin do t'ia kushtoj alkoolit, njërit nga haramet, veset

e rënda, i cili ka marrë shtrirje shqetësuese edhe në shoqërinë tonë.

Alkooli bën pjesë në rendin e haramëve (gjërave të ndaluara), ndalimi i të cilit bazohet në Kur'an, synet dhe ixhma. Mirëpo, ndalimi i alkoolit nuk erdhi përnjëherë, por për shkaqe praktike ndalimi ndodhi në faza.

Në fazën e parë Allahu i madhërishëm në Kur'an flet për "ushqimin dhe pijet e këndshme, që përfshin të gjitha përveç alkoolit:

"Edhe nga frutat e hurmës dhe të rrushit nxirri prej tyre pije (lëngje) dhe ushqim të mirë. S'ka dyshim se edhe në këtë ka fakte (mbi fuqinë e Zotit) për njerëzit që kanë menduar." (Nahl, 67)

Pastaj u shpall ajeti vijues:

"Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: "Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi (të pakta) në to për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre. ...! Kështu ua sqaron Alla-



hu juve argumentet ashtu që të mendoni (çka është mirë e çka është keq).” (Bekare, 219)

Ky ajet flet se dëmi nga vera dhe bixhozi është më e madhe se dobia dhe se refuzimi i tyre është përparësi kundrejt përdorimit të tij. Ky ajet ende nuk e ndalon alkoolin në mënyrë vendimtare, por me fazat paraprake e përgatit terrenin për këtë.

Në fazën e tretë Allahu (xh.sh.) shkon një hap më tej dhe e ndalon kryerjen e namazit në gjendje të dehur:

“O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç’flitni, ...”! (Nisa’, 43)

Pastaj vjen faza e katërt dhe përfundimtare në ndalimin e alkoolit, rreth së cilës nuk ka pasur kurrfarë dilemash dhe diskutimesh. Për ndalimin përfundimtar flasin ajetet vijuese:

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.”. (Maide, 90)

Pas thirrjes drejtuar besimtarëve dhe të drejtuarit direkt atyre, që kërkon kujdes të plotë në raport me atë që dëshirohet t’u thuhet, në ajetin e cituar në vend të parë vjen ndalimi i alkoolit, e pastaj ndalimi i bixhozit, idhujve dhe shigjetave për fallin. Që të katër gjërat janë quajtur me një emër, e ky është rixhs (vepra e ndyrë, gjë neveritëse) dhe ky jo çfarëdo rixhsi, por ai i cili bën pjesë në veprat e shejtanit. Allahu (xh.sh.) me Kur’an kërkon nga njerëzit t’u largohen këtyre mëkateve që të jenë të shpëtuar:

“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?” (Maide, 91)

Nëpërmjet verës dhe bixhozit, shejtani i mallkuar dëshiron të hedh armiqësi dhe urrejtje ndër njerëzit dhe t’i pengojë nga përmendja e emrit të Allahut, nga namazi dhe nga adhurimet e tjera fetare, t’i përçajë familjarët, shokët, fqinjët; dëshiron t’i shpenzojë mjetet në paudhësi, kurse shumë projekte individuale, grupore dhe të vendit të mbesin pa mjete të dëshiruara.

Ndalimi i alkoolit është urdhëruar në vitin e tretë hixhri menjëherë pas betejës në Uhud, kur kasneci i Muhamedit (a.s.) u komunikoi të pra-



nishmëve:

“O njerëz, alkooli është bërë haram (i ndaluar).”

Të gjithë ata që i dëgjuan këto fjalë, ndërsa në duar kishin gota me verë, i thyen ato. Ata që në gojë kishin gllënjkat e verës të cilat ende nuk i kishin gëlltatur, i pështynë. Të gjitha enët për verë u thyen apo u shpërthyen, sikurse qëndron në transmetimin që e përcjell ashabi Enesi (r.a.):

“Kam shërbyer me pije në shtëpi të Ebu Talhasë, ndërsa në këtë kohë alkooli ishte i qortuar. Muhamedi (a.s.) i urdhëroi kasnecit të shpallë ndalesën e alkoolit me ç’rast kemi dëgjuar: - Alkooli është i ndaluar! Ebu Talha më tha: - Del dhe derdhe! Dola dhe e derdha në rrugë! Disa ashabë thanë: - Ka nga njerëzit tanë të cilët kanë rënë shehidë, kurse në barqet e tyre kishte mbetur alkool! Dhe u shpall ajeti:

“Ata që besuan dhe bënë punë të mira, nuk kanë mëkat për atë që u ushqyen (më herët) derisa ata ruhen (prej haramit), besojnë dhe bëjnë vepra të mira, mandej ruhen (nga ajo që ka qenë e lejuar e është e ndaluar) dhe besojnë e pastaj ruhen (nga çdo mëkat) dhe bëjnë mirë. All-llahu i do ata që bëjnë mirë.” (Ma’ide, 93) (Buhari)

Ndalimi i alkoolit shkallë-shkallë është dëshmi e nevojës për përshtatje në mendje dhe zemër, në mentalitet, në transformim në Islam, sidomos në gjërat të cilat qenë rrënjësuar te arabët para isla-

Alkooli bën pjesë në rendin e haramëve (gjërave të ndaluara), ndalimi i të cilit bazohet në Kur'an, synet dhe ixhma. Mirëpo, ndalimi i alkoolit nuk erdhi përnjëherë, por për shkaqe praktike ndalimi ndodhi në faza.



mit dhe të cilat ishte vështirë me shkop magjik të ndalohen, braktisen dhe çrrënjosen.

Ashabët të cilët kanë pirë alkool edhe pas ndalimit të tij, Muhamedi (a.s.), si transmeton Ebu Enesi (r.a.), i ka fshikulluar me degë palme apo me nalla, deri kur Ebu Bekri (r.a.) ata të cilët kanë pirë alkool, gjatë hilafetit të tij, i ka fshikulluar me 40 goditje.

Në një hadith thuhet se në xhenet nuk do të hyjnë tre persona:

Ebu Se'idi (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: Në xhenet nuk do të hyjë: ai që përflet atë që ka dhuruar, ai që është i padëgjueshëm ndaj prindërve dhe pijaneci." (Ahmedi)

Alkooli paraqet një rën nga të këqijat më të mëdha të aktualitetit dhe bën pjesë ndër rreziqet sidomos për popullatën e re, e cila nga dita në ditë bëhet gjithnjë e më e varur nga ai. Alkooli në masë të madhe është shkak i drejtpërdrejtë i vrasjeve, vetëvrasjeve, aksidenteve në komunikacion, dhunimeve, perversiteteve, rrahjeve, zënkave, divorceve e të tjera. Disa qytetarë, madje edhe njerëz me peshë publike, bëjnë garë kush pi pije më cilësore dhe sa më shumë, e të mbetet në këmbë! Alkooli ka depërtuar në shkollë, nëpër zyra të institucioneve arsimore, politike, kulturore. Çdo inaugurim, çdo përvjetor, çdo festë celebrëhet me alkool, nga prijësit e popullit. Çfarë skene bizare, çfarë shembulli televiziv trishtues para fëmijëve, familjarëve etj.

Populli që bën gara në të keqe, populli që mburret me të keqen dhe jo me të mirën është populli që do ta humb vlerën e vet dhe do të shkojë në plehra të historisë. Ata do të jenë në përqafim të ndëshkimit të xhehenemit.

Muhamedi (a.s.) në vitin e tetë hixhri e ka ndaluar tregtinë me alkool, me mishin e kafshës së ngordhur, derr dhe me idhuj, sikurse tregohet në

hadithin vijues:

"Transmeton Xhabir Ibn Abdullahu (r.a.) se e ka dëgjuar Pejgamberin (a.s.) se ky ka thënë në vitin e çlirimit të Mekës: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar shitjen e alkoolit, cofëtinat, derrin dhe idhujt." Dikush tha: A mund ta shesim dhjamin e cofëtinës, me të cilin lyhen anijet, lëkurat dhe e përdorin për ndriçim?" Tha: "Jo, kjo është haram!" Pastaj Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Për këtë shkak Allahu është hidhëruar me hebrenjtë, sepse pasi Allahu ua ndaloi dhjamin e shtazëve, e kanë shkrië, shitur dhe i kanë shfrytëzuar paratë që fitonin me këtë shitje!" (Buhari).

Siç shkruan në hadithin paraprak, Pejgamberi (a.s.) e ka ndaluar përdorimin e katër gjërave, kurse në pyetjen se a lejohet shitja e dhjamt të cofëtinës, thotë se edhe ai është i ndaluar dhe se Allahu është hidhëruar me hebrenjtë, të cilët edhe pas ndalesës e kanë shitur dhjamin dhe i përdornin paratë e fituara nga ai.

Simaku transmeton se e ka dëgjuar Alkame ibn Vailin, kurse ky transmeton nga babai, se ka qenë në shoqëri me Pejgamberin (a.s.) kur e ka pyetur Suvejd ibn Tariku mbi alkoolin dhe Muhamedi (a.s.) ia ka ndaluar. Ai pyeti: A mund të mjekohem me të? Pejgamberi (a.s.) u përgjigj:

"Ai nuk është mjekim, por sëmundje." (Tirmidhi)

Ne jemi bashkësia fetare e të natyrshmes (fitre), kurse Pejgamberi ynë në Isra, kur iu afrua gota e qumështit dhe gota e verës zgjodhi qumështin, sikurse shkruan në hadithin vijues:

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Natën që isha në Isra, mu servirën dy enë: në njërin kishte qumësht, kurse në të dytën verë. Më tha meleku Xhibril: - Zgjidh cilën të duash! Dhe unë zgjodha qumështin dhe e piva. Më tha:

"Zgjodhe atë që është natyrore, sepse sikur të ki-



she marrë verën, ymeti yt do të lajthiste!" (Buhari).

Me dhënien pas alkoolit a mos dëshirojnë myslimanët të largohen nga natyra e pastër humane dhe të bëhen nga ata që i ndjekin hapat e shejtanit? A mos populli të cilit i është bërë haram alkooli dëshiron të tregojë se mund të jetë mysliman dhe të pijë dhe se ky në njëfarë mënyre është mysliman bashkëkohor i cili si i tillë mund të shkojë në Evropë!

Shumë tregtarë aktualë, që dikur arsyetohehin se shteti ua imponon shitjen e alkoolit dhe derrit, tash arsyetohen se puna u shkon shumë më mirë kur ofrojnë alkool dhe mish e prodhime derri. Natyrisht, se shejtani ua rrit xhiron atyre, por rritja e pasurisë nuk do të thotë edhe rritje e bereqetit, sepse pasuria haram shkatërrohet në mënyrën si është fituar, kurse ka shumë raste që mund të na shërbejnë si shembull për ata të cilët janë të talentuar me arsye.

Muhamedi (a.s.) i ka përmendur ata të cilët janë të mallkuar, të cilët janë të gjithë ata që gjenden në zinxhirin e prodhimit, shitjes, shërbimit dhe konsumimit të alkoolit. Ibn Umeri (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"Allahu e ka mallkuar alkoolin dhe atë që e pinë atë, dhe atë që e mbush gotën, atë që e shet, atë që e blen, atë që e prodhon dhe për kë prodhohet, atë që e shërben dhe kujt i shërbehet." (Ebu Davudi)

Muhamedi (a.s.), në hadith flet për ata të cilët pinë, se namazet nuk do t'u pranohen për një

kohë të caktuar: Abdullah ibn Umeri (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"Kush pi alkool Allahu nuk do t'ia pranojë namazin dyzet ditë, dhe nëse pendohet, Allahu do t'ia falë. Nëse sërish i kthehet alkoolit, Allahu nuk do t'ia pranojë namazin dyzet mëngjese e nëse pendohet Allahu do t'ia falë. Nëse sërish dehet, Allahu nuk do t'ia pranojë namazin dyzet mëngjese, e nëse pendohet Allahu do t'ia falë. Nëse sërish i kthehet alkoolit për të katërtën herë, namazi nuk do t'i pranohet dyzet mëngjese, e nëse pendohet, pendimi nuk do t'i pranohet dhe Allahu do ta ngop nga lumi i helmuar me qelb (në xhehenem)." (Tirmidhi)

Atij që qëllimisht dehet, qoftë kjo edhe një glënjë, nuk i pranohet namazi, e me këtë edhe veprat e tjera të mira dyzet ditë. Nëse këtë e përsërit edhe dy herë dhe sërish i kthehet alkoolit, namazi nuk do t'i pranohet por nuk do t'i pranohet as pendimi.

Çdo mysliman e myslimane që deri në këtë muaj të bekuar e ka shijuar alkoolin le të marrë vendim të prerë që ta braktisë alkoolin nga pirja, shërbimi, servirja në raste të përditshme dhe në festa, në raste gëzimi dhe morti, i ri apo i vjetër, të ndihmojë çka ka mundësi që të sillt ligji mbi ndalimin e konsumimit dhe shitjes së alkoolit... së paku të bëhet ajo që është bërë në disa vende botërore: kufizimi i përdorimit të alkoolit.

Çdo mysliman e myslimane duhet të vendosë prerazi se nuk do t'i kthehet alkoolit dhe le të bëjë tevbe - pendim të sinqertë!

Rëndësia e muajit të Ramazanit

Ramazani është stina e mëshirës hyjnore që i pajis besimtarët me pjekuri dhe virtyte. Ash-tu siç tregohet kujdes gjatë agjërimit që të mos hyjë në gojë ndonjë gjë, po ashtu duhet të tregohemi të kujdesshëm edhe për fjalët që dalin prej goje. I Dërguari i Allahut a.s.) porositi: "Agjërimi është mburojë për atë që nuk e trondit agjërimin që ka mbajtur me gjëra që nuk i kanë hije atij që agjëron."

Sjelljet dhe mendimet e njeriut mund t'i vlerësojmë të drejta apo të gabuara, sepse jeta është e kompozuar nga gjëra të tilla. Mosvlerësimi i gabimeve të vogla që i ka vepruar, bëhet shkas që njeriu të gabojë përsëri. Kjo psikologji e gabuar shndërrohet pak nga pak në arsye për gabime më të mëdha. Muaji i Ramazanit është një muaj i vlefshëm, në të cilin shtohet shpresa për faljen e gjynaheve. Profeti (a.s.) në një hadith të tij thotë: "Fillimi i Ramazanit është mëshirë, mesi është falje, fundi është shpëtim nga rreziku i xhehenemit..."

Pra në këtë atmosferë të tillë si Ramazani, njeriu duhet ta mendojë thellë se çfarë ka punuar në të kaluarën. Asnjë njeri nuk është i përsosur dhe pa të meta. Nëse është pa të meta atëherë nuk është njeri. Qëllimi për të cilin na ka krijuar Zoti i madhëruar nuk është dënimi, por sprovuar se cili prej nesh është më vepër mirë. **(Mulk, 2)** Duhet t'i shtojmë punët e mira, të bëjmë sa më pak gabime, të ndihemi përgjegjës për ato gjëra që veprojmë. I Dërguari i Allahut (a.s.) thotë: "Sikur njerëzit do ta dinin siç duhet se ç'është Ramazani do të dëshironin që gjithë viti të kalonte si muaji Ramazan." **(Ibn Huzejme, Sahih, III, 190)**

Natyra e njeriut dhe vlerësimi i ngjarjeve ndryshon nga njëri tek tjetri. Ka disa njerëz të cilët gjërat e vogla i zmadhojnë dhe gjërat e mëdha i nënvlerësojnë. Allahu i Madhëruar në Kur'anin famlartë thotë: "Kur ju shpifjen e përcollët me gjuhën tuaj pa patur rreth saj asnjë dijeni, flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te Allahu nuk është i tillë" **(Nur, 15)**

Pra agjërimi i njeriut, i cili merret me gënjeshtira ose me shpifje ka pak apo aspak vlerë tek Perëndia, sepse agjërim do të thotë që njeriu në një kohë të caktuar ta pengojë dhe ta ruaj veten prej një sërë gjërash materiale të padobishme d.m.th ta mbrojë jetën e vet ndiesore prej dëshirave, prirjeve dhe të këqijave egoistike e sensuale.



Njeriu nuk duhet të mjaftohet gjatë agjërimit vetëm me mospërmbushjen e nevojave materiale si ushqimi etj., por ta ruajë edhe botën e vet shpirtërore prej çdo vepre të shëmtuar, si gënjeshtër, përgojimi etj. I Dërguari i Allahut thotë: “Njeriu që agjëron nuk duhet të merret me gënjeshtër dhe mashtrime dhe gjëra të tilla si këto, sepse Zoti (xh.sh.) nuk ka nevojë për një agjërim që i pengon njerëzit vetëm nga ngrënia dhe pirja.”

Nënvlërësimi i disa gjërave që janë kryesore dhe mbivlerësimi i gjërave të vogla janë bërë shkak për përhapjen e problemeve shoqërore në masat e njerëzve. Duke iu bashkëngjitur shumicës së njerëzve nuk shpëtojmë nga përgjegjësia që kemi ndaj Perëndisë. Transmetohet në një hadith nga Abdullah ibn Mesudi se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Besimtari aq të madh e konsideron gjynahin saqë i duket sikur qëndron në rrëzë të një mali dhe thua se ai mal po rrëzohet mbi kokën e tij. Ndërsa një mëkatari gjynahet i duken si një mizë e vendosur mbi hundë.”

Enesi ibn Malik (r.a.) ua ka tërhequr vëmendjen një grupi prej tabiinëve duke u thënë: “Ju jeni duke punuar gjëra të cilave nuk u jepni rëndësi as sa një qime. Kurse në kohën e Profetit (a.s.) ato i konsideronim si gjynahe shkatërrimtare për jetën fetare.”

Ramazani për muslimanët është një muaj i veçantë dhe me vlera të shumta. Drita e Islamit në këtë muaj ka lindur. Libri ynë i shenjtë, Kurani gjatë këtij muaji ka filluar të zbresë. Nata e Kadrit që është më e çmuar se një mijë muaj është njëra prej netëve të këtij muaji.

Në Ramazan duhet treguar kujdes ndaj disa gjërave kryesore që zënë vend edhe në porositë e Muhamedit (a.s.):

1. Pendesa dhe të përmendurit e Allahut (xh.sh.)
2. Largimi dhe ruajtja nga gjërat e ndaluara dhe të

shëmtuara për t'i shpëtuar xhehennemit.

3. Dhënia iftar një agjëruesi.

4. Kryerja e shumë të mirave sipas mundësive. Fiti-mi i bekimit dhe lutjes së njerëzve zemërthyer dhe të dëshpëruar.

5. Punë të mira të shumta për të fituar xhennetin dhe të tjera si këto.

Një ndër sahabet e mëdhenj, Ebu Ejjub el-Ensari (r.a.) ka thënë: “Ka nga njerëzit të atillë që bën një të mirë dhe kujton se mjafton me aq, i beson atij akti, ndërsa gjynahet e vogla i harron. Kështu ai takohet me Allahun dhe shikon që gjynahet e vogla e kanë rrethuar atë. Ka edhe një njeri që bën gjynah, por që nuk pushon së kërkuari falje për shpëtim nga dënimi i Allahut derisa të takohet me Të.”

Ky muaj është muaji i lutjeve, i pendesës dhe i kërkesës së mbrojtjes dhe faljes së Zotit për mëkatet e bëra. Prandaj besimtarët nxiten për të kërkuar mbrojtjen e Allahut për gjynahet e tyre pikërisht në këtë muaj. Njeriu nga natyra e tij njerëzore gabon dhe kundërvihet duke u larguar nga mësimet e fesë. Si pasojë, ai ka nevojë për një mundësi që t'i lejojë kthimin dhe ndreqjen, prandaj ekziston edhe pendimi. Allahu i madhëruar urdhëron e thotë: “Thuaj, o robët e mi të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut se vërtetë Allahu i fal të gjitha mëkatet. Ai falë shumë dhe është mëshirues.” (Zumer, 53)

O Zot! Mbushi zemrat tona me dashurinë për ty, me frikën ndaj Teje, me besnikërinë ndaj Teje, me besimin tek Ty. Allahu (xh.sh.) e bëftë jetën e kësaj bote Ramazan dhe na bëftë të mundur agjërimin e këtij muaji të madhërueshëm deri në fund. **Amin!**



Ramazani dhe njeriu

Sa më pozitive
dhe më të thella,
sa më të kapshme
dhe të kuptueshme
të jenë ndjenjat,
sa më i pasur dhe
pozitiv të jetë
mendimi dhe
kuptimi që zgjon
në mendjet e
njerëzve, aq mirë
do ta bëjë ky muaj
i madhnueshëm
detyrën e tij
edukative,
drejtuese,
lartësuese dhe
influentesuese
në karakterin e
individit.

Duke filluar që nga fëmijëria shoqëria e ka për detyrë çdo individ ta brumosë me veçoritë e besimit, zakoneve, traditave dhe sjelljeve të veta duke i formuar kështu atij edhe karakterin. I jep atij tiparet dalluese të vetat. Individit ka për detyrë që t'i mbrojë dhe t'i tejkalojë tiparet dalluese që i ka dhënë shoqëria.

Institucionet shoqërore këtë detyrë e bëjnë në dy rrugë: 1- mendimet e individëve për institucionin; 2- Sjelljet dhe drejtimi që pret institucioni nga individit apo grupi shoqëror. Edhe pse mund të duket sikur këto dy drejtime dalin në të njëjtën derë, përsëri e vërteta nuk është e tillë. Individët mund të kenë mendime të ndryshme në lidhje me institucionet. Nga ana tjetër ata që presin institucionet nga individët përherë i tejkalojnë atë që ka në mendje individit. Psh: ne meqë jemi edhe në muajin e madhnueshëm të ramazanit në sjelljet tona gjatë ditës nuk arrijmë që të ngrihemi në atë shkallë që pritet prej nesh sidomos në jetën tonë shpirtërore. Përherë janë të pranishme disa gabime apo mangësi tona. Ç' është e drejta disa nga vëllëzërit tanë janë në shkallë të ndryshme, ka nga ata që nuk mund të ngjiten qoftë edhe një shkallë më lart sesa uria apo

agjërimi, ndërsa ka nga ata që i afrohen lartësisë shpirtërore që kërkon ramazani. Ja pra, që ta kryejmë më devotshmëri detyrën e muajit të madhnueshëm të ramazanit, duhet që t'i afrohem mënyrës së të jetuarit një ramazan pa gabime duke u ngritur çdo ditë nga një, dy, tre shkallë e kështu me radhë dhe duke e përgatitur veten nga një ramazan në tjetrin. Sa më pozitive dhe më të thella, sa më të kapshme dhe të kuptueshme të jenë ndjenjat, sa më i pasur dhe pozitiv të jetë mendimi dhe kuptimi që zgjon në mendjet e njerëzve ky muaj i madhnueshëm aq mirë do ta bëjë detyrën e tij edukative, drejtuese, lartësuese dhe influencuese në karakterin e individit. Padyshim kjo është e lidhur me atë se sa vend do t'i japim ne dhe sa rëndësi do t'i kushtojmë në shoqërinë tonë. Çdo institucion shoqëror bëhet ndikues aq sa rëndësi i jepet këtij institucioni në shoqëri, sa vlera bashkohen me të, aq sa pasuri idesh ka në raport me mundimin që i jepet. Ai që ka përfituar më shumë nga ramazani, është ai që ka zgjedhur për vete qëllimet më të mira duke u përpjekur t'i arrijë ato.

Muaji i madhnueshëm i Ramazanit nuk duhet të jetë vetëm një muaj që i afrohem më tepër Zotit me dëshirë më të

fortë edhe më të madhe se në çdo kohë tjetër, por është edhe një muaj i mbushur plot me jetë të pastër dhe të paharrueshme si dhe me kujtime të lumtura. Një gjë e tillë shton edhe më tepër begatinë e këtij muaji të madhnueshëm dhe si rrjedhojë rrit vlerën dhe vijueshmërinë e influencave të dobishme.

Fatkeqësisht ne e kemi lënë mangët atë që i takon këtij muaji, për gjatë 12 muajve tjerë nuk ia kemi dhënë dot duke e varfëruar në këtë drejtim. Kështu që edhe ky muaj është sjellë në të njëjtën formë ndaj nesh duke na dhënë pak nga mirësitë e tij. Kemi kohë që jemi në një rizgjim në rrugën e drejt Tij. Nuk ka dyshim që shpërblimin e kësaj do ta shohim që të gjithë, qoftë ato që e bëjnë detyrën e tyre si individ, qoftë edhe si popull.

Ramazani dhe agjërimi janë ngjarje të tilla që e shpëtojnë adhurimin brenda një viti nga kufizimi me pritja si dhe u ngarkojnë besimtarëve akoma pa filluar një ngarkesë shpirtërore që sa vjen e rritet. Me këtë tipar dallues mund të influencojë në

sjelljet e individit në çdo moshë si dhe mund ta shpëtojë nga ndryshimet dhe zakonet e këqija. Por vetëm nëse arrijmë që ta presim ashtu siç duhet këtë muaj... Për këtë arsye qoftë ata që janë predikues, qoftë edhe besimtarët që ta çojnë në vend në shkallën më të lartë detyrën e muajit të madhnueshëm të ramazanit, duhet të bëjnë atë që u takon duke qenë të kujdesshëm në sjelljet dhe veprimet e tyre. Është shumë e rëndësishme që shkrimet në gazeta dhe revista, bisedat e bëra në radio dhe televizor, bisedat që bëhen në shtëpi, në rrugë apo në mbledhje të synojnë ta pastrojnë ramazanimin nga veset e këqija për t'u përgatitur për të çuar në vend detyrat që na takojnë. Në këtë drejtim muaji i madhnueshëm i ramazanit është një mundësi ideale. Tashmë është bërë traditë që në hutbet e xhumasë së parë si dhe në ligjëratën e ramazanit të trajtohen këto tema. Por me këtë rast ka shumë rëndësi se çfarë temash do të trajtohen si dhe si të trajtohen.

Në këtë aspekt një rëndësi të madhe mbart edhe fillimi i agjërimin për fëmijët. Nuk mjafton

Tashmë është bërë traditë që në hutbet e xhumasë së parë si dhe në ligjëratën e ramazanit të trajtohen tema të ndryshme, por ka shumë rëndësi se çfarë temash do të trajtohen dhe si do të trajtohen ato.

t'i thuash: "Tashmë ke ardhur në moshën për të agjëruar, nesër do të agjërosh që nga fillimi i ditës e deri në të ngrysur të saj, nuk do të hash gjë, nuk do të pish", duke i dhënë disa këshilla dhe duke i shpjeguar se priten disa sjellje të mira në përshtatje me muajin e madhnueshëm të ramazanit (durimi, shmangia nga fjalët e këqija dhe fjalori i rëndë, kryerja e mirësive e dhënia e ndihmave). Këto nuk duhen dhënë me presion, por të përgatitet fëmija për të përdorur vullnetin e tij në realizimin e këtyre detyrave. Këto

Ramazani dhe agjërimi janë ngjarje të tilla që e shpëtojnë adhurimin brenda një viti nga kufizimi me pritje si dhe u ngarkojnë besimtarëve një ngarkesë shpirtërore që sa vjen e rritet.



Sjelljet e mira të individit, mirësitë që ka bërë për t'iu afruar Allahut, janë një burim i fortë për t'i hapur zemrën, ndërsa sjelljet e këqija i ngushtojnë dyert e zemrës dhe të shpirtit për këtë dashuri.

duhet t'u jepen si një detyrë e lartë dhe me shumë nder. Është mjaft e rëndësishme në aspektin e edukimit dhe të arsimimit fetar që fëmijët që do të fillojnë për herë të parë ramazanin të mblidhen një natë përpara në familjet mike si mysafirë duke u dhënë shpjegimet e duhura në lidhje me këtë muaj. Një natë e tillë e lumtur fëmijës mund t'i lërë gjurmë të paharrueshme. Por edhe në këtë rast patjetër duhen t'u shmangemi metodave të presionit gjatë shpjegimeve.

Që ta adhurojmë Allahun me vërtetësi, që ta mbushim shpirtin tonë me dashurinë për të, që të meritojmë dashurinë e tij duhet që të pastrohemi nga të gjitha të këqijat. Sjelljet

e mira të individit, mirësitë që ka bërë për t'iu afruar Atij, janë një burim i fortë për t'i hapur zemrën, ndërsa sjelljet e këqija i ngushtojnë dyert e zemrës dhe të shpirtit për këtë dashuri. Ja pra, pikërisht ky muaj i madhnueshëm duhet të merret dhe të kuptohet si një periudhë e tillë edukimi brenda një "uni" shpirtëror. Do të forcohen zakonet e mira dhe do të lihen ato të këqijat në mënyrë që të mos kthehen më... Sevapet e fituara gjatë këtij muaji janë më tepër sevape ndërsa gjynahet më tepër gjynahe...

Muaji i madhnueshëm i ramazanit nuk është një institucion i vetëm por një buqetë institucionesh. Muaji i madhnueshëm i ramazanit është një institucion shoqëror i pazëvendësueshëm për bajramin si dhe "zeqatin" që është bërë traditë të jepet në këtë muaj, për iftaret dhe rregullimin e marrëdhënieve njerëzore në rrugë sa më të mirë. Në asnjë shtet përveç shoqërive myslimane nuk ka ndonjë institucion që i mbledh të gjithë njerëzit brenda dhe jashtë vendit nën një çati të lumtur për një kohë një mujore, që i bashkon të gjithë kokë më kokë të pasur dhe të varfër, me shkollë dhe pa shkollë dhe që u ofron një bise-

dë tepër serioze për një natë. Është faji ynë nëse nuk marrin atë që duhet prej tij. Veçanërisht mes gjendjeve shpirtërore të atyre që mblidhen në xhami dhe atyre që mblidhen në kine-ma apo në vende të ngjashme, ka shumë dallime të mëdha. Së pari atyre që u flitet për ramazanin apo bajramin ju vjen si një ndriçim dhe shpresë për zemrën e tyre ndërsa tek të tjerët nuk ka një përgatitje të tillë.

Muaji i madhnueshëm i ramazanit është një mundësi e mirë edhe për të shfaqur dashurinë për njëri-tjetrin. Një gjë e tillë zgjon ndjenjat e lumturisë tek individët, ndihmon në shëndetin e shoqërisë, forcon lidhjet e sadakasë mes njerëzve fetarë.

Ashtu sikurse është një detyrë e jona që të përgatisim popullin dhe fëmijët tanë për këtë muaj, duhet edhe ta përcjellim dhe të përgatitemi mjaft seriozisht për bajramin; pasi edhe mbarrimi i ramazanit edhe ardhja e bajramit të ramazanit, janë ngjarje të rëndësishme, është koha për t'i dhënë llogari vetes sonë. Veçanërisht sjellje të mira, si: vizita tek të dashurit e zemrës, përshëndetjet për bajram, marrja e rrobave të reja për fëmijët, shkëmbimi i dhuratave

etj. janë gjurmë të lumtura që i kanë lënë në mendjen e secilit të madh dhe të vogël, janë edukues i mirë në kujtime të lumtura dhe krijojnë mundësi për përshtatje në jetën shoqërore. Mendoj se është detyrë e çdo myslimani që të shfrytëzojë në maksimum këtë mundësi. Edhe këshillat që u jepen fëmijëve në këtë drejtim, janë me dobi për ne dhe ata. Përsëri është detyrë e jona që të shfrytëzojmë ramazanin dhe bajramin si një periudhë e paqes dhe e harmonisë. Kështu që mes njëri-tjetrit zhvillohen ndjenjat e mirëkuptimit dhe e tolerancës, të dashurisë për njëri-tjetrin dhe një pjesë e madhe shpëton nga ato mërzitje që janë burim i prishjes së qetësisë duke mbyllur kështu edhe dyert e një kujtimi të pakëndshëm.

Kur marr parasysh përgatitjet e bëra për pritjen e Vitit të ri të të krishterëve dhe Vitin e Ri që është një bajram i të krishterëve me përgatitjet për pritjen e bajramit të ramazanit diçka më mbledhet përbrenda. Myslimani ynë! ... Përgatitjet e bëra për një vit të ri, një pritje si për një perandor që pritet nga larg 50-100 kilometra nga kryeqyteti, dhe dyqanet e mbushura plot e përplot që një muaj përpara. A

është “e dhimbshme” apo “një turp” nuk e di si të them. Çdo përgatitje e bërë në çdo skaj të vendit dhe në shumë shtëpi të myslimanëve veçanërisht duke bërë reklama në televizione, festohet thuajse është bajrami ynë i vërtetë. E aq më tepër kjo nuk bie as në kundërshtim edhe me shtetin tonë dhe me ligjin laik.

Kur shkruaj këto reshta nuk është se s’më lind edhe një ndjenjë gëzimi. Kjo pasi mendoj ramazanet dhe bajramet këtu e 50 vite më parë... padyshim që kemi bërë hapa mjaft të rëndësishëm. E kemi shmangur mjaft edhe vuajtjen tonë.

Po hyjmë në muajin e madh-nueshëm të ramazanit. Mos të harrojmë, që tani të fillojmë me përgatitjet për ramazanin, për bajramin, t’i përvishemi punës që ta presim sa më mirë, të zbuskurojmë aq mirë veten tonë, shpirtrat tanë, xhamitë dhe qytetet tona në mënyrë që edhe ata që merren me pritjen e Vitit të Ri, me përgatitjet e pemëve, me shkuarjet në kryeqytetet perëndimore, me ata myslimanë që i bëjnë fëmijët e tyre të puthin dorën e plakut të vitit të ri, sado pak të mendojnë dhe të turpërohen. Edhe tek ne të zgjohen që herët ndjenjat e dashurisë

Ja pra, pikërisht ky muaj i madh-nueshëm duhet të merret dhe të kuptohet si një periudhë e tillë edukimi brenda një “uni” shpirtëror. Do të forcohen zakonet e mira dhe do të lihen ato të këqijat në mënyrë që të mos u kthehemi më...

dhe të lumturisë dhe gëzimit. Të duam më tepër, të dashurojmë dhe të shfaqim më shumë ndjenjat e dashurisë për të tjerët. Të fillojmë që tani të bëjmë më shumë mirësi dhe të vazhdojmë kështu, në mënyrë që ramazani dhe lumturia e bajramit të na mbulojnë për një kohë të gjatë duke filluar që tani. T’u shmangemi gjynaheve, mungesës së dashurive, mungesës së ndjenjave, thashethemeve, përplasjeve me njëri-tjetrin. Që tani të fillojmë të bëhemi miq dhe vëllezër. Ditët tona të madh-nueshme mos t’i presim fëtyrëvarur dhe të mërzitur por me gëzim, me këngë, me ilahi, me lojëra të bukura... le ta zhvillojmë kulturën tonë, le t’u japim vend traditave tona.



Ramazani nga gjuha e Profetit



Idërguari profeti Muhamed (a.s.), mëshirë për botët, na e ka sqaruar muajin e ramazanit me të gjitha dimensionet që ka. Këtë muaj e kishte bërë shprehi ta quante edhe “muaji i myslimanëve”. Literatura e hadithit është e mbushur përplot me shumë thënie që rrëfihen prej profetit Muhamed dhe me raportimet e ndryshme të tyre. Do të qe e pamundur të mund t’i radhisim dhe t’i trajtojmë të gjithë ato hadithe brenda një artikulli. Për këtë arsye edhe ne, zgjodhëm një ligjëratë profetike (hutbe) në të cilën profeti Muhamed (a.s.) e ka sqaruar më gjërësisht muajin e Ramazanit. Ligjëratat profetike në fjalë është shkëputur nga një ndër veprat më eminente të literaturës së hadithit, më saktësisht nga vepra Sahih e dijetarit të hadithit Muhamed b. Ishak Ibn Huzejme (311 H / 923) ⁽¹⁾

Në kapitullin në lidhje me vlerat fetare dhe shpirtërore të muajit të Ramazanit që gjendet në veprën e Ibn Huzejmes, pasi jepet zinxhiri i raportuesve që shkon pas deri tek Selman Farisiu thuhet: “I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) mbajti një ligjëratë në ditën e fundit të muajit Shaban në të cilën tha:

“O myslimanë!

“Mbi ju ka rënë hija e një muaji madhështor dhe të bekuar. Ky është muaji në të cilin gjendet edhe nata e Kadrit, natë që është më e mirë se një mijë muaj së bashku.

Ky është muaji në të cilin Allahu u obligoi të agjëroni ditën dhe u begatoi me faljen e namazit (të teravisë) mbrëmjeve.

Kush punon ndonjë vepër të mirë në këtë muaj fiton po aq sevape sa fiton personi që kryen një detyrë fetare të detyruar (farz) në një kohë tjetër përjashta këtij muaji. Ai që përbush një farz në këtë muaj fiton sevapin e kryerjes së shtatëdhjetë farzeve në muajt e tjerë.

Ky është muaji i durimit, shpërblimi për të cilin është xheneti.

Ky muaj është muaji i bamirësisë, ndihmës dhe barazisë.

Ky është muaji në të cilin besimtarit i shtohet begatia hyjnore materiale.

Kush i shtron iftare një personi që ka agjë-

ruar, ky veprim bëhet shkas që t'i falen mëkatet që ka vepruar dhe të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Ai me këtë rast do të fitojë po aq sevape sa fiton ai që ka agjëruar, por pa marrë nga sevapet e këtij të fundit."

Të pranishmit e pyetën:

- "Jo të gjithë ne i kemi mundësitë financiare që të mund të ushqejmë për iftar ata që kanë agjëruar..."

Këtyre profeti Muhamed (a.s.) iu përgjigj duke u thënë se:

"Allahu (xh.sh.) këtë sevap ia dhuron edhe atij personi që e gostit një person që ka agjëruar qoftë edhe me një hurmë apo disa gllënjka ujë apo qumësht " dhe vazhdoi ligjëratën me këto fjalë:

"Bëjini sa më shpesh katër gjëra në muajin e ramazanit. Me dy prej tyre fitoni kënaqësinë e Allahut, ndërsa prej dy të tjerave nuk mund të rrini larg edhe po të doni. Dy gjërat me të cilat do të fitoni kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) janë të dëshmoni për njësinë e Allahut duke thënë shpesh La ilahe illallah dhe të kërkonit sa më shpesh nga Zoti juaj që tua falë mëkatet. Sa i takon dy gjërave të tjera nga të cilat nuk mund të qëndroni larg ato janë të kërkonit nga Zoti xhenetin dhe t'i luteni që t'u shpëtojë nga xhehenemi."

Hytja e profetit Muhamed, sikurse shihet, është shumë e qartë dhe e prerë, por gjithsesi ne jemi të mendimit se ka vlerë të ndalemi në disa pika të saja që na tërheqin vëmendjen.

Ardhmëria e vërtetë


Muhamedi (a.s.) e ka prezantuar në këtë ligjëratë muajin e ramazanit nga aspekti i rezultateve pozitive që u dhuron ai besimtarëve si në jetën personale, ashtu edhe në atë të botës së përtejme, sepse çdo mysliman pret diçka të re nga muaji i ramazanit që ai ka mbërritur. Këto aspirata të tijat sa kanë lidhje me jetën e kësaj bote, po aq, madje edhe më shumë, kanë lidhje me jetën në botën e përtejme, sepse e ardhmja e vërtetë për besimtarin është bota e përjetshme.

Nga ana tjetër është një e vërtetë e njohur fakti që përmirësimi një e nga një i njerëzve shpie në një përmirësim të caktuar të shoqërisë, sep-

se bashkësitë njerëzore formohen nga individët. Kur ndahen me të tjerët momentet e gëzimit dhe haresë, kanë ndikim edhe më të madh, prandaj edhe hareja që të fal muaji i ramazanit, do ta rrethojë shoqërinë në atë masë që ajo ndahet me tjerët.

Profeti Muhamed (a.s.) na e ka bërë të qartë se nuk është domosdoshmëri që të kemi të ardhura financiare në mënyrë që të fitojmë sevape nga kryerja e bamirësive në muajin e ramazanit. Me këtë deklaratë të Tijën që ne e cituam

Kush i shtron iftare një personi që ka agjëruar, ky veprim bëhet shkas që t'i falen mëkatet që ka vepruar dhe të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Ai me këtë rast do të fitojë po aq sevape sa fiton ai që ka agjëruar, por pa marrë nga sevapet e këtij të fundit.



në ligjëratën e mësipërme, ai sikur dëshironte të na mësonte se "Allahu nuk ka nevojë për pasuri të mëdha që të shpërndajë mëshirën e Tij të cilën njeriu mund ta fitojë edhe duke kryer një akt të thjeshtë bamirësie". Edhe t'i japësh personit që ka agjëruar për të çelur iftarin një gllënjë ujë apo qumësht mjafton që ne të përfitojmë nga kjo mëshirë hyjnore. Sa është i rëndësishëm akti bamirës që kryhet, po aq i rëndësishëm është edhe qëllimi me të cilin ai kryhet. Prandaj askënd nuk duhet ta kaplojë pesimizmi

po qe se mendon se të ardhurat materiale që ka nuk do t'i mundësojnë të kryejë akte bamirësie. Në qoftë se ne do të tregojmë kujdesin e duhur në përmbushjen e dy akteve që na këshilloi profeti Muhamed (a.s.) që të kryejmë gjatë muajit të Ramazanit, të cilat qenë shprehja e dëshmisë dhe lutja që të na falen mëkatet, kuptojmë sesa e lehtë është për një besimtar të sinkertë që vetëm duke përdorur gjuhën e tij në ziqër të mund të fitojë shumë sevape.

“Zemrat gjejnë qetësi vetëm kur e përmendin Allahun”



Ndjesia e besimit në njësinë e Zotit dhe ndër-gjegjësimi rreth kësaj të vërtete duhet forcuar dhe i duhen mundësuar të hedh rrënjë sa më thellë me anë të përsëritjeve të dëshmisë islame, sepse **“zemrat gjejnë qetësi vetëm kur e përmendin Allahun”**.

Humbja e rëndë

Sqarimi profetik që “nata e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj”, qoftë shpërblimi hyjnor

(sevap) që fitohet kur kryhen vepra të mira dhe bëhen bamirësi në këtë muaj, shpërblim që është shumëfish më i lartë kur të njëjtat akte dhe vepra kryhen në muajt e tjerë përjashta Ramazanit, tregojnë se muaji i ramazanit në vetvete është një “mundësi e jashtëzakonshme që na dhurohet”. E vërteta që njihet nga të gjithë është se, momentet e jashtëzakonshme sjellin me vete edhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Teksa na tregojnë rreth vlerës së veprave të mira që bëhen në muajin e ramazanit, profeti ynë i dashur, na ka sqaruar njëkohësisht se personat që do të mbeten indiferentë ndaj këtyre mundësive do të përjetojnë humbje dhe dështime shumëfish më të rënda se ato që do të përjetojnë në muajt e tjerë për shkak të indiferencës së tyre.

Të jesh pozitiv

Meqë ra fjala në këtë temë, e konsiderojmë me vlerë të theksojmë se çdo veprim dhe akt që do të kryejmë duke u nisur nga respekti që ushqejmë për muajin e ramazanit, do të ketë pa tjetër një vlerë të veçantë. Shpresojmë që këto lloj aktesh bamirësie do të jenë plotësim për gabimet që njerëzit mund të kenë kryer gjatë jetës së tyre. Mirëpritja me nderim dhe respekt e çdo mjeti apo metode që mundëson të ndërgjegjësojë shoqërinë rreth temave fetare dhe domosdoshmërisë së jetës fetare, janë të përshtatshme që të arrijnë të masivizojnë nismat e këtilla. Qoftë edhe një muaj gjatë gjithë vitit, çdo ndërmarrje që do të ndihmonte në përthithjen më të shpejtë të atmosferës fetare brenda shoqërisë, do të ishte shumë më e efektshme që të mirëpritet duke u parë si një ftesë e shpërndarë në emër të veprave të mira.

Ata që meritojnë me të vërtetë për të ndjerë keqardhje, janë individët tek të cilët nuk dallohet as ndryshimi më i vogël për sa i përket ndjesive dhe mënyrës së vjetër të jetesës, të cilët nuk ndikohen qoftë edhe një grimë nga atmosfera e muajit të ramazanit. Më mjeranë se personat në fjalë janë ata individë që nuk e durojnë dot formën e re të bukur që sjell atmosfera e jetës së përditshme gjatë këtij muaji dhe përhapjen e saj në shtresat e ndryshme të shoqërisë, madje përpiqen të vënë në dukje shqetësimin që ndjejnë nga kjo atmosferë e përsëritshme.

Muaji i rindërtimit të jetës shpirtërore

Allahu (xh.sh.) e ka krijuar me fuqinë e tij njeriun duke e cilësuar atë superior mbi shumicën e krijesave të tjera. Me këtë epërsi dhe veçori përzgjedhjeje njeriu u bë mëkëmbësi i Zotit në këtë botë dhe u ngarkua me përgjegjësinë e rregullimit të jetës së tij vetjake në përputhje me dëshirën hyjnore dhe më pas me rregullimin dhe përjetësimin e të njëjtit rregull hyjnor në të gjithë begatitë dhe mirësitë që i janë vënë nën urdhrin dhe në të mirën e tij. Kjo përgjegjësi madhore që i është dhënë njeriut duhet të realizohet brenda një kufiri kohor të kronometruar që quhet jetë. Megjithëse koha në dispozicion të jetës është e kufizuar dhe numërohet me frymëmarrjet që thithim dhe lëshojmë, si një begati tjetër e Krijuesit tonë për njeriun, secilit nga hallkat e shumta që përbëjnë zinxhirin e jetës i është dhuruar nga një vlerë dhe begati më vete. Kjo begati është një servirje hyjnore në mënyrë që të fitojmë kohën e humbur apo për ta shumëfishuar me një, dhjetë apo shifra të panumërta kohën që mund të na duket si e pamjaftueshme. Disa vende gëzojnë një status të përzgjedhur nga ana fetare. Fjala vjen namazi që falet në Mekke është më me vlerë sesa namazi i falur në çdo vend tjetër, po ashtu namazi që falet në Medine është më me vlerë se çdo namaz tjetër që falet në çfarëdo vendi, me përjashtim të namazit që falej në Meke; ndalesa gjatë kryerjes së haxhit (vakfe) do të kryhet vetëm në vendin e quajtur Arafat. Në këtë linjë mendimi themi se pjesë kohësh të caktuara brenda jetës kanë fi-

tuar një veçanti më të madhe. Këto janë dy ditët e bajrameve për të gjithë vitin, dita e xhuma nga ditët e javës. Nata e Miraxhit që më e veçanta për profetin tonë Muhamed, ndërsa nata e Kadrit për bashkësinë myslimane ka një veçanti dhe dallim më të spikatur nga netët e tjera. Nga mesi i muajve Ramazani, muajt Rexhep dhe Shaban që na parapërgatitin shpirtërisht për ardhjen e Ramazanit, janë muajt më të veçantë në kalendarin hënor, muaj në të cilët mëshira hyjnore vjen për të na mbuluar si retë e ngarkuar. Më saktë jemi ne ata që shkojmë drejt tyre për të marrë sadopak nga hija e tyre mëshiruese.

Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) kur afronte muaji Rexhep bënte këtë lutje: "Allahu im! Na begato në muajt Rexhep dhe Shaban, si dhe na bëj të mundur që ta mbërrijmë muajin e Ramazanit¹. Nga këto fjalë të tija ne mësojmë se atë e kaplonte hareja dhe gëzimi i muajit të Ramazanit që në dy muajt paraardhës. Me të vërtetë Allahu (xh.sh.) llogarit me kohë të reja brenda ditëve të jetës si për profetin tonë të dashur Muhamedin (a.s.), ashtu edhe për bashkësinë e tij besimtare në këtë periudhë kohore tre mujore që zë fill me muajin Rexhep, për të vazhduar më pas me muajt Shaban dhe Ramazan. Nata e Miraxhit, në muajin Rexhep, që nata më e lumtur për profetin tonë Muhamed, sepse në atë natë ai u thirr si i ftuari special i Allahut në agorën hyjnore. Kjo vlen edhe për besimtarët, sepse në këtë natë u dhurua namazi. Më shumë se një urdhër hyjnor namazi duhet konsideruar si një dhuratë

speciale për besimtarët nga ana e Allahut. Po qe se do t'i lihej në dorë të njeriut gjetja dhe përzgjedhja e një veprë apo akti që do ta afronte krijesën tek Allahu duke fituar njëkohësisht edhe kënaqësinë e Tij, a mund të pretendohet vallë që njeriu të mund të përzgjidhte ndonjë formë më të bukur sesa ajo me të cilën na ka obliguar Allahu, pra namazi?! Nata e Beraetit në muajin Shaban dhe ajo e Kadrit në muajin Ramazan nuk janë gjë tjetër përveçse begati hyjnore për rifitim të kohës së humbur për ata njerëz që nuk kanë ditur ta vlerësojnë kohën që u ka kaluar apo kohë të reja brenda jetës për ata që kanë ditur ta vlerësojnë jetën deri në ato momente.

Programi i ri për jetën tonë

Në këto ditë kur koha na jep sihariqin e horizontit të lumtur të muajit të Ramazanit, njerëzit duhet ta rishikojnë edhe një herë jetën fetare dhe të përpiqen që ta rifreskojnë atë me sa më shumë vepra dhe akte fetare, duke shkuar pas selefëve salihë që lumturinë e madhe e shikonin

Koha në dispozicion të jetës është e kufizuar dhe numërohet me frymëmarrjet që thithim dhe lëshojmë, si një begati tjetër e Krijuesit tonë për njeriun, secilit nga hallkat e shumta që përbëjnë zinxhirin e jetës i është dhuruar nga një vlerë dhe begati më vete.



tek shkalla e pasimit të gjurmëve të jetës fetare të profetit Muhamed:

1 Së pari t'i përkujtojmë shpirttrave tanë lumturinë që të fal përjetimi i një dite të re. Për sa kohë që të mbajmë ndër mend fjalët e profetit "Allahu im! Më begato në muajt e Rexhepit dhe Shabanit! Më mundëso që të mbërrijë muajin Ramazan! ta mbajmë veten përherë në këtë linjë.

2 Teksa i bëjmë vetvetes një llogari të asaj që ka ndodhur duhet të fillojmë përherë nga pika që na ka urdhëruar Allahu dhe na ka mësuar profeti. Pra të rishikojmë edhe një herë akiden dhe besimin tonë. Të tregojmë kujdes që besimi ynë të jetë i bazuar mbi Kur'an dhe traditën profetike, të jetë në linjën e ehli syneetit.

3 Të tregojmë kujdes më të madhe për adhurimet për të cilat jemi të obliguar që t'i kryejmë, mes tyre për namazin. Të gjithë përpjekjet tona në këtë pikë duhen përqendruar me qëllim që të arrijmë në thelbin e vërtetë dhe frymën e namazit, në mënyrë që ky adhurim si në jetën tonë, ashtu edhe në jetën shoqërore, brenda së cilës gjendemi, të mund të jap fryte të begata. Të bëhet shkas që të shtojmë imanin, njohjen e urtësive hyjnore, dashurinë ndaj Allahut dhe të mund të na afrojë sa më shumë me të, sepse nuk është e mundur për njeriun të afrohet tek Zoti i tij me ndonjë gjë më të dashur për Të sesa me ato veprime të cilat Ai Vetë i ka urdhëruar. Që namazi që falim të mund të na çojë në këtë shkallë afiniteti hyjnor, duhet ta falim në kohën e përcaktuar me prehje të madhe shpirtërore. Për këtë duhet pasur parasysh rëndësia e madhe që i është kushtuar kësaj pike në ajetet fisnike dhe hadithet profetike.

Prehja shpirtërore në namaz do të thotë që njeriu që fillon të fal namazin, që nga momenti kur merr tekbinin fillestar dhe deri në momentin që jep selamin, duhet të jetë i ndërgjegjësuar që ndodhet përpara Allahut (xh.sh.), se është një njeri mëkatar nevojtar për mëshirën dhe butësinë e Zotit të tij, se në saje të fjalëve që thotë dhe veprimeve që kryen në namaz, ai kërkon falje dhe mëshirë hyjnore dhe kaplohet nga ndjesitë e frikës duke u përpjekur që të fitojë begatinë dhe bamirësinë hyjnore. Namazi që falet me këtë botë shpirtërore, është më i vyeri nga adhurimet e tjera pasi që në të mblidhen adhurimet në forma të ndryshme të melekëve dhe është shkaku më i mrekullueshëm që të fitojmë faljen

hyjnore.⁸

Sipas raportimit me rrugën e Ibn Abbasit (r.a.) Davudi (a.s.) e pyeti kështu Zotin gjatë një lutjeje:

“Zoti im! Kush do të hyjë në xhenet dhe namazin e cilit person do të pranosh më përpara?”

Allahu i Lartësuar u përgjigj:

“Ata që do të hyjnë në xhenet dhe do tua pranoj namazin që falin janë personat që tregohen të përkorë përballë madhësisë Sime, që më përkujtojnë Mua natë e ditë, që distancohen nga epshet e tyre për hir të pëlqimit Tim, që ushqejnë të uriturit, që mbajnë afër të ngratët, që u dhimbsen njerëzit që pësojnë fatkeqësi”.


Allahu (xh.sh.) i ka shpallur kështu Musait (a.s.):

“O Musa! Kur të më kujtosh Mua të të dridhet trupi, teksa më kujton Mua të të kaplojë prehja shpirtërore. Më përkujto duke medituat rreth asaj që mendon, kur të hysh në agorën Time për të m’u lutur, qëndro ashtu sikurse qëndron robi përpara zotërisë së Tij. Lutu me zemrën që rreh dhe gjuhën që flet të vërtetën”.

4 Në këto muaj përkrah namazeve që falen teksa përfitojmë një përshtirshmëri të thellë fetare duhet të përfitojmë edhe nga ditët e agjërimit vullnetar në përputhje me traditën profetike të bekuar, sepse në burimet islame rrëfëhet se profeti Muhamed nëse ka agjëruar ditë tjera, përveç agjërimit të detyrueshëm të Ramazanit, këtë e ka bërë në dy muajt paraardhës për të cilët kemi folur më sipër.

5 Pas këtyre duhet të shtojmë përpjekjet tona në mënyrë që të mund ta hijeshojmë moralin dhe ta stolisim atë me virtyte të larta duke e pastruar egon tonë dhe duke u distancuar nga situatat e këqija nga aspekti fetar, sepse etika e keqe na pengon që të përfitojmë nga këshillat profetike dhe mësimet e Allahut. Njeri me fat është ai person që pastrohet nga sëmundjet etike që e kaplojnë çdo njeri siç janë mendjemadhësia, zilia, pangopësia, babëzia, mllefi, të dhënit shumë pas të mirave materiale të kësaj bote, nënvlerësimi i vëllait të tij mysliman etj. Në të njëjtën mënyrë fatlum është edhe ai njeri që arrin të gjejë një prijës shpirtëror i cili do t’i tërheqë vërejtje kur të jetë në rrugë të gabuar

Teksa i bëjmë vetvetes një llogari të asaj që ka ndodhur duhet të fillojmë përherë nga pika që na ka urdhëruar Allahu dhe na ka mësuar profeti. Pra të rishikojmë edhe një herë akiden dhe besimin tonë. Të tregojmë kujdes që besimi ynë të jetë i bazuar mbi Kur’an dhe traditën profetike, të jetë në linjën e ehli synetit.



dhe do t’i tregojë rrugën e drejtë, prej të cilit do të mund t’i mbushet zemra me dritë, nga i cili mund të marrë mësim dhe ta përrudhë drejt devotshmërisë, frikës së Allahut dhe llogarisë personale. Ahmed ibn Hanbeli e nxiste të birin që të asistonte nëpër tubime njerëzish të mirë dhe të devotshëm, paçka se ata mund të ishin më pak të ditur në fushën e njohurive të hadithit dhe i përsëriste shpesh herë këto fjalë: “Biri im! Njeriu duhet të ulet të qëndrojë vetëm në ato ambiente dhe rrethe ku gjen prehje shpirtërore..”

Dëshiroj ta përfundojë këtë artikull duke përsëritur lutjen e të dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.):

Allahu im! Bekoji muajt e Rexhepit dhe Shabanit.. Na mundëso që ta mbërrijmë muajin e Ramazanit.

ENIGMA E FEKSJES SE AGIMIT

Sipas mistikëve myslimanë gjumi, ngaqë është diçka trupore dhe njerëzore, konsiderohet si një gjendje indiference shpirtërore, sepse njeriu nuk mund ta përkujtojë dhe ta përmend Allahun ndërsa është duke fjetur. Por personi të cilin e kaplon gjumi ndërsa ai ka një zemër të kulluar dhe një mendje të qashtë arrin që ta shpëtojë atë kohë që kalon në gjumë prej papastërtisë së indiferencës shpirtërore. Njeriu që shtrihet të flejë me një zemër të pastër, duke kërkuar pendesë dhe falje për gabime nga Allahu si për veten, ashtu edhe për myslimanët e tjerë, që nuk i shkon ndërmend asnjë mendim që synon të dëmtojë ndonjë person tjetër apo ndonjë ide për të kryer ndonjë mëkat të nesërmen, që shtrihet në shtrat pasi ka marrë abdes dhe që e merr gjumi ndërsa gjuha e tij është duke e përmendur Allahun, shtrati i tij deri në feksjen e sabahut do të konsiderohet faltore, ndërsa koha që kalon në gjumë do t'i numërohet si kohë e kaluar me kryerjen e adhurimeve fetare. Njeriun që e ka zënë gjumi me këto ndjesi shpirtërore kur të zgjohet të nesërmen do t'i drejtohet me gjithë shpirt Allahut, do t'i përqendrojë mendimin e tij tek Allahu dhe kujdesin tek zbatimi i urdhrave të Tij dhe do ta kalojë ditën duke e përmendur Zotin e Tij.

Mendja e njeriut është nën ndikimin e përqendrimit dhe vazhdimësisë. Prandaj edhe të sëmuret

që vihen në gjumë duke ju dhënë narkozë kur të zgjohen, mendja e tyre do të jetë e përqendruar në ato gjëra me të cilat ishin duke u marrë deri në momentin kur pacientin e zuri gjumi nën efektin e narkozës. Mendja dhe zemra nga ky aspekt i përngjajnë kasetës së videos që vazhdon aty ku është ndaluar nga larg me anë të një telekomande. Kjo është arsyeja pse është aq e rëndësishme gjendja shpirtërore dhe mendore e trurit në momentin që njeriun e zë gjumi. Prandaj edhe të urtët e mbrujtur me mësimet e fesë së Allahut janë shprehur se: "Njeriu që e ha meraku rreth shkallës shpirtërore që ai posedon duhet të sjellë ndërmend se cila është gjëja e parë që i vjen atij ndërmend në momentin që zgjohet nga gjumi, sepse ngritja nga varri është e lidhur me gjendjen e mëparshme në të cilën na ka zënë momenti i vdekjes ashtu sikurse ngjan edhe në gjumë. Ashtu sikurse njeriu zgjohet me ato mendime në të cilat e ka zënë gjumi, ashtu edhe do të ringjallet me mendimet dhe besimin në të cilin e ka zënë vdekja dhe në varësi të tyre dhe do të merret në llogari."

Besimtari i devotshëm duhet të jetë nga ata që zgjohen përpara feksjes së agimit dhe ta quaj për kapital personal të besimit kohën përpara se të feks drita e agimit. Në literaturën islame individët që e kalojnë duke kryer adhurime kohën që i takon të jetë 1/3 e fundit e kohës së mbrëmjes, quhen seheri.

Besimtari i devotshëm që e kalon zgjuar këtë orar pas namazit të te-hexhudit për të cilin ngrehet nga gjumi në mbrëmje, e kalon kohën duke u marrë me lutje për falje mëkatesh, duke përmendur fjalën e dëshmisë, duke e lavdëruar emrin e Allahut dhe duke lexuar salavat mbi profetin Muhamed (a.s.). Të ndash një pjesë nga koha e darkës për namazin e natës dhe pas tij për t'i drejtuar Allahut lutje, është një moment i rëndësishëm i jetës së përditshme fetare që inkurajohet me shprehje lavdërimi, pasi që Muhamedi (a.s.) ka thënë: "Zgjohu në mbrëmje një kohë të shkurtër qoftë edhe aq minuta që do të duheshin për të mjelë një dele dhe në këtë kohë të shkurtër fal namaz! (Bejhaki, es-Sunenu'l-kubra, III, 18-19; Zebidi, Ithafu's-saade V, 476)

Ebu Dher tregon: E pyeta të dërguarin e Allahut:

- Cila është koha më me vlerë në mbrëmje për t'u zgjuar dhe për të falur namaz? Ai m'u përgjigj:

- Koha kur zë mbrëmja e fillon të largohet. Në këtë kohë falu . (Ibn Hanbel, Musned, V, 179)

Ndërsa me një rast tjetër duke u shprehur "Kapuni fort pas namazit që falet në kohën e fundit të natës, sepse ky namaz është namazi në të cilin asistojnë për të dëshmuar edhe engjëjt" (Muslim, Musafirin, 294; Nesai, Mevakit,

35; Ibn Mâxhe, Ikâme, 148; Ibn Hanbel, Musned, III, 300, 315) ai na tregon se në namazin që falet në kohën e seherit asistojnë edhe engjëjt e mbrëmjes dhe të ditës.

Sipas të dhënave që i mësojmë nga burimet e literaturës së hadithit, profeti Muhamed (a.s.) zgjohet menjëherë kur dëgjonte zërin e këndesit në kohën e seherit. (Buhari, Tehexhud, 7; Muslim, Musafirin, 131; Nesai, Kijamu'l-lejl, 8; Ibn Hanbel, Musned, VI, 110, 147, 203)

Rrugën për të shpëtuar nga gjumi që e kaplon njeriun në kohën e feksje së agimit duke e kthyer në skllavin e tij, profeti Muhamed (a.s.) na e ka treguar me anë të këtij krahasimi: "Kur njeriu bije të flejë, shejtani i lidh tri fije peri në qafë. Kur njeriu zgjohet nga gjumi dhe ulet duke thënë Bismilahir-rahmanir-rahim, zgjidhet njëri prej tyre, kur çohet e shkon që të marrë abdes, zgjidhet i dyti dhe kur fal dy rekate namaz, i zgjidhet edhe i treti. Kështu njeriu besimtar del në mëngjes nga shtëpia me zemër të qetë dhe me trup dinamik. Në të kundërt e nis ditën me një ndjenjë përtacie. (Buhari, Tehexhud, 12; Muslim, Musafirin, 207; Ebu Davud, Tatavvu, 17; Ibn Maxhe, Ikame, 174)

Hadithi profetik që na tregon se shejtani përmjerr në veshin e njeriut që bie të flejë gjumë duke mos e pasur aspak problem mosgjimin e tij për sabah, (Buhari,

Tehexhud, 13; Muslim, Musafirin, 205; Nesai, Kijamu'l-lejl, 5; Ibn Maxhe, Ikame, 174) na tërheq vëmendjen në faktin që dinamizmi i kohës përpara feksjes së agimit dhe gjallëria e mëngjesit konsiston në zgjimin nga gjumi përpara se të lind dielli.

Një ditë prej ditësh një person erdhi tek Hasan Basriu, njëri nga figurat më madhore të brezit të tabinëve dhe nga mësuesit e parë të mistikës islame, duke ju qarë me këto fjalë: "Mjeshtër, netët i kaloj teksa gëzoj shëndet të mirë dhe kam dëshirë natën që të zgjohem për t'u falur, por me gjithë përgatitjet që bëj nuk arrij të zgjohem assesi." Hasan Basriu i dha këtë përgjigje: "Janë mëkatet tua që nuk të lejojnë dhe të bëhen pengesë që të zgjohesh natën për të bërë adhurime. Përpiku të rrish ditën sa më larg mëkateve që do të pengojnë natën vonë që të mund të zgjohesh, sepse njerëzit besimtarë privohen nga namazet e natës për shkak të mëkateve që i kryejnë gjatë ditës."

Ebu Husejn Nuri ka thënë: "Për shkak të një mëkati që kam bërë u privova për shtatë muaj me radhë nga mundësia për t'u zgjuar netëve për të kryer adhurimin e natës." Kur e pyetën se çfarë mëkati paska qenë ai që ka bërë që të privohet nga namazet e netëve, ai u është përgjigjur: "Një ditë pashë një njeri që po qante me dënësë nga frika e Allahut por mendjen time e kaploi mendimi se ky person qan sa

për të rënë në sy të njerëzve dhe në fund u dënova, prandaj kam këto pasoja shpirtërore."

Në krye të atyre gjërave që na pengojnë që të zgjohemi për të falur namazin e natës në kohën e tij, është lodhja e mendjes pas punëve të kësaj bote. Interesimi vetëm pas kësaj bote ashtu sikurse e angazhon zemrën vetëm me gjëra materiale, ashtu edhe i lodh dhe i rraskapit gjymtyrët e trupit. Ngopja pa masë e stomakut, marrja me llafë dhe gjërat që nuk na takojnë dhe zhytja në mëkate e lënë në hije enigmën e përshpirtshme të kohës përpara feksjes së agimit, ndërsa të ushqyerit me ushqime të blera me rrugë fitimi të dyshimtë apo këmbëngulja në mëkate e vështirësojnë edhe më shumë situatën.

Në të kundërt me këto që thamë gjërat që e lehtësojnë zgjimin për namazin e natës janë ushqimi i blerë me të ardhura të fituara në rrugë të ligjshme, të shkosh rrugës së drejtë duke bërë përherë pendesë për lëshimet eventuale, frika që të shtie në shpirt mundësia e dënimit në botën tjetër dhe shpresa për të hyrë në xhenet.

Gjuha e heshtjes së natës i tingëllon në vesh mistikut si gurgullima zhurmëmadhe e adhurimit. Edhe begatia e kohës përpara feksjes së agimit është e fshehur në enigmën që pëshpëritet në heshtje.

Pranë nesh

Ishthe hera parë që hyja në dhomën e prindërve që kur se vdiqën të dy bashkë aksidentalisht. Qëndrova pak çaste pa lëvizur dhe vështrova përreth sikur të kisha një shekull pa e parë atë dhomë.

Krevati dopio ishte i rregulluar. Kornizat në mur, dollapi, komodinat s'kishin aspak pluhur për çudi. Abazhuri ishte i ndezur. E fika dhe hapa dritaren. Më lindi një dëshirë e trishtuar: të shihja fotografitë. Shkova pranë sirtarit për t'i marrë duke kaluar pranë një pasqyre të madhe të vendosur në mur. Pasqyra kishte formë vezake me një kornizë argjendi plot dekoracione. Mora fotografitë e u ula t'i shihja në krevat. Sa shumë fotografi, sa shumë! Aty nëna buzëqeshte pafajshëm dhe babai e përqafonte. Diku tjetër nëna më puthte mua e diku tjetër unë atë.

Qava. Trupi më dridhej si të isha zhytur në dëborë. Lashë mënjane albumin dhe mbulova fytyrën me duar. Sa shumë kujtime! Sa shumë

lot! Nënë! Baba!

Diçka më preku lehtë kra-hun. Menjëherë më shkoi mendja te fantazmat. U ngrita shpejt e trembur, por kish-te qenë perdja që lëkundej nga era. Megjithatë qëndroja në këmbë e trembur.

"Nga më erdhi kjo frikë."

Ndjeja ftohtë. Fshiva lotët dhe vendosa të dilja nga dhoma.

"S'kam pse të kem frikë. Do dal ngadalë, e qetë, do pi pak qumësht e do ndjem me mirë!"

Fillova të ec drejt derës duke mu dridhur këmbët. Në gjoks më shtrëngonte një ndjenjë trishtimi e malli, përzier me frikë.

Perdet lëkundeshin, por frika s'më linte të mbyllja dritaren. Doja vetëm të ikja. Kalova pranë pasqyrës vezake, por sapo bëra një hap larg saj, u ktheva me nxitim.

"O Zot!"

Isha mësuar që gjithnjë në pasqyrë të shihja veten, por kësaj rradhe pashë nënën.

"Ç'po ndodh?!"

Qëndrova para pasqyrës e ngrirë me sytë përlotur, me buzë të lagura.

Vura duart në faqe, pastaj në flokë, pastaj nëpër trup dhe ajo bënte të njëjtat lëvizje si unë, bile mbante të njëjtin fustan. Vetëm fytyra na dallonte nga njëra tjetra.

"Si është e mundur?!"

Çudia gati po më mbyste. Iu afrova më afër pasqyrës.

"Nënë!"

Buzët e saj lëviznin njëherësh me të miam.

Më erdhi një mendim të dilja me vrap nga dhoma, ose të bërtisja fort e të vinte vëllai të më merrte, por asnjërën nga këto s'munda ta bëja. Diçka më pengonte. Zgjata dorën drejt pasqyrës që ta prekja. Ajo nuk lëvizi. Atëherë u tmerrova dhjetë fish. Fillova të qaja.

"Nënë! Mos më bëj keq, të lutem! Unë të dua shumë! Mos më bëj keq!"

Dridhesha dhe gati sa s'po më binte të fikët.



Nëna në pasqyrë uli kokën mendueshëm dhe pastaj foli si e penduar:

-“S’desha të të trembja!”

Shtanga. Ia ngula sytë dhe vura re se ishte e trishtuar sikur dikush ta kishte fyer.

“Më fal, nënë, nëse të kam lënduar ndonjëherë!”

“Po, më ke lënduar.”

Unë fillova të qaja përsëri me dënësë, kokën ulur, duke u dridhur.

“Pse qan?”

“Më vjen keq! Më vjen keq për ty e për babin! Më vjen keq për gjitha ato gjëra që po ndodhin në këtë botë! Për gjitha këto padrejtësi! Oh! Nënë.

Çdo ditë vdesin të pafajshëm, të rinj, krejt papritur e, unë trishtohem...

Gjithë bota trishtohet, por prapë vazhdon ritmin vet. Por unë acarohem e më vjen të plas kur shoh diellin të lindë përsëri e rrugët të vlojnë si zakonisht, sikur asgjë të mos ketë ndodhur.

Më duket sikur jam në një ëndërr të keqe e pres me padurim të zgjohem, por...kur çdo mëngjes më ndesh me të njëjtën realitet, e kuptoj trishtueshëm se kurrë s’do të ketë një zgjim final e të lumtur... Sa e vështirë për t’u pranuar!”

Nëna buzëqeshi pakëz:

“Është vetëm një provë, e dashur. Vetëm një provë e shkurtër. Bëhu e fortë e kalojë! Dhuroju të tjerëve mirësi nga mirësia që Zoti ka vendosur në zemrën tënde! Do të ketë një zgjim final, por ti duhet të jesh gati për të!”

Ndalova lotët. Bënte fresk dhe u solla të mbyll dritaren! Mos e mbyll! Mos mbyll asnjë dritare! Bile, krijo të tjerë!...dhe mbështetu te Zoti!”

Ktheva kokën... s’ishte më në pasqyrë.

“Nënë!”

Përsëri qava. U kujtova se desha ta pyes për shumë gjëra, për vdekjen, për botën e atjeshme. Deshe të pyes nëse ishte mundur ta përqafoja ...por ajo kish ikur...

Në dhomë ushtronin vetëm fjalët “mbështetu te Zoti!”, “mbështetu te Zoti!”

Dhe ...u përmenda. E pashë veten të ulur në shtrat me fotografi në duar. E kuptova që kisha fantazuar. E kisha çuar shumë larg imagjinatën time. Hodha sytë nga pasqyra që heshte indiferente dhe qesha.

“Sa budallaqë! Kam folur me veten!”


Lashë fotografitë dhe u ngrita të mbyllja dritaren.

“Mos e mbyll, i thashë vetes, - nuk duhet t’i mbyllësh dritaret, por të krijosh të tjerë!”

Vështrova dhomën rreth e qark para se të dilja.

Era tundte perdet lehtë-lehtë dhe rrezet e diellit puthnin pasqyrën vezake. Më rrëshqitën ca lot, por gjeja forcë t’i thoja vetes:

“Mbështetu te Zoti!” dhe ndjeva që Ai është kudo, pranë nesh!



Klima e mëshirës

**Padyshim të gjitha
ditët e ramazanit
përbëjnë në vetvete
një mundësi. Ky
muaj nga fillimi
deri në fund është
shi i begatshëm i
qiellit frytdhënës.
Pejgamberi ynë
Muhammedi (a.s)
thotë:**

**“Muaji i ramazanit
është muaji fillimi
i të cilit është
mëshirë, mesi është
falje, ndërsa fundi
është shpëtim nga
xhehennemi...”**

Falenderimet e pafundme
i qofshin Allahut të Lar-
të që dhuroi ramazanin
si një klimë mëshire në të cilin
të gjithë besimtarët mblidhen
nën stehën e mëshirës hyjnore.

Ramazani është muaji në të
cilin jetohej me emocione të
mëdha katër kushtet e Islamit.
Ramazani, në anën shpirtërore
është një përgatitje e përtshpirt-
shme e adhurimit të posaçëm
të haxhit në të cilin jetohej ele-
mente të rëndësishëm.

Padyshim të gjitha ditët e ra-
mazanit përbëjnë në vetvete një
mundësi. Ky muaj nga fillimi
deri në fund është shi i begat-
shëm i qiellit frytdhënës. Pej-
gamberi ynë Muhammedi (a.s)
thotë:

“Muaji i ramazanit është
muaji fillimi i të cilit është më-
shirë, mesi është falje, ndërsa
fundi është shpëtim nga xhe-
hennemi...”

Ramazani është stina në të ci-
lën derdhen në shpirtira begati-
të e frytshme dhe ku shpërthen
gjelbërimi pranveror shpirt-
ëror. Zemrat e thara të besimta-
rëve do të pastrohen me punë
të mira, zemrat dhe shpirtat

e vyshkura do të lulëzojnë me
devotshmëri dhe do të bëhen
më të prekshme. Ky muaj nga
fillimi deri në fund do të jetë një
mundësi fitimi.

Kështu e paraqet një hadith
profetik faktin që ata të cilët
nuk i zbatojnë nuk do të mund
ta vlerësojnë këtë mundësi:

Transmetohet nga Ka'b bin
Uxhre:

Pejgamberi (a.s) kërkoi prej
nesh që ne të uleshim pranë
minberit dhe ne të gjithë ash-
tu siç ishim, u ulëm aty pra-
në. Hipi një shkallë dhe tha
“Amin!” Hipi edhe një shkallë
tjetër. Përsëri tha “Amin!”. Hipi
edhe një shkallë tjetër. Përsë-
ri “Amin!” tha. Kur zbriti nga
minberi i thamë:

- O i dërguari i Allahut! Sot
ne dëgjuaam prej teje një gjë që
s'e kishim dëgjuar më parë. Më
pas ai tha:

- Kur isha në minber më erdhi
Xhebraili dhe kur isha në shka-
llën e parë më tha:

- Kush e mbërrin muajin e
ramazanit dhe nuk falet, mall-
kuar qoftë!



Një person pati ardhur tek profeti dhe e pati pyetur:

- O i dërguar! Cila sadaka është më e madhe për nga bamirësia dhe shpërblimi? Ndërsa ai i pati dhënë këtë përgjigje:

- Sadakaja e dhënë në muaj të Ramazanit...(Tirmidhi)

Ndërsa unë thashë: "Amin!"

Kur hipa në shkallën e dytë ai më tha:

- "Mallkuar qoftë ai i cili kur të ndodhet afër Teje nuk çon salate dhe selame për Ty!

Ndërsa unë thashë: Amin!

Kurse kur hipa në shkallën e tretë më tha:

- Mallkuar qoftë ai person i cili nuk arrin të fitojë xhennetin edhe pse arrin moshën e vjetërsisë së prindërve apo kur sheh një të moshur!

Edhe unë thashë: "Amin!" (Hakim, Tirmidhi)

Në këtë hadith theksohet edhe njëherë rëndësia parësore që ka adhurimi, robëria, salavati dhe respekti ndaj prindërve në këtë muaj kaq të begatshëm.

Përsa i përket kryerjes së adhurimeve në lidhje me vlerësimin e ditëve të madhnueshme ka edhe të tilla si mbikqyrja e të varfërve, jetimëve, atyre që nuk kanë njeri, të pashpresëve bile edhe të sëmurëve që zgjatja e dorës zemrave të tilla, të jetua-

rit e një vëllazërie shpirtërore me ta dhe të qënurit një prehër i nxehtë për ta përbëjnë edhe aspektet më të rëndësishme që lartësojnë mirësitë e ramazanit të madhrueshëm. Pasiqë këto adhurime, pra punët e mira si sadakaja dhe zekati që u jepen njerëzve në nevojë të çojnë edhe më shumë drejt faljes dhe shpëtimit. U hapin rrugë fryteve dhe begative. Hapin dyert e mëshirës hyjnore. Mbyllin rrugën e dënimit dhe vuajtjeve. I hapin dyert e ndihmës dhe përkrahjes hyjnore.

Në hadith thuhet:

"Sadakaja mbyll derën e shtatëdhjetë sherreve." dhe "Sadakaja shuan dënimin dhe vuajtjet e saja që Allahu i dërgon."

Llukman Hakim i thoshte të birit:

- Biri im! Kur të bësh një gjynah, me vetëdije apo pavetëdije, menjëherë bëj tevbe dhe pendohu.

Kështu është transmetuar edhe për rëndësinë e sadakave të dhëna në këtë muaj:

Një person pati ardhur tek profeti dhe e pati pyetur:

- O i dërguar! Cila sadaka është më e madhe për nga bamirësia dhe shpërblimi? Ndërsa ai i pati dhënë këtë përgjigje:

- Sadakaja e dhënë në muaj të Ramazanit...(Tirmidhi)

Kështu i shprehin miqtë e ngushtë të Zotit cilësitë e atyre që japin lëmoshën:

Lëmosha e atyre të sheriatit është nga mallrat, ndërsa i atyre të së vërtetës së përsheptshme është nga gjëra të tjerë përveç mallrave. Lëmosha e njerëzve me kulturë shpirtërore bëhet me shpirtrat e tyre. pasi ata nuk mund të mbesin asnjë cast pa Zotin. Nafakaja e të dashurve të Zotit bëhet nga shpirtrat e tyre pasi shpirtrat e tyre e pranojnë përcaktimin hyjnor. Lëmosha e të pasurve është nxjerrja e parave nga qesja. Lëmosha e der Vishëve është dalja në pah nga shpirti i gjendjes shpirtërore që përjetojnë.

Të pasurit kur japin nafakanë nuk kanë zili nevojtarët e mallrave të tyre. Të gjithë të varfërit

dhe ata që nuk kanë njeri janë të pasur dhe të lumtur me qënien e të pasurve bujarë që falëndë-rojnë. Ashtu sikurse reja e prillit vërshon bega-ti dhe mëshirë mbi tokën mbi të cilën ndodhet, edhe robërit e mëshirshëm dhe bujarë bëhen shkak i mëshirës së Allahut. Ai që jep lëmoshë, sa më shpirtërisht dhe përzemërsisht ta jape, sepse edhe për atë që e merr bëhet edhe më e begatshme. Një shkëmbim i tillë është burim qe-tësie si për atë që jep, ashtu edhe për atë që merr. Pasi thellësia shpirtërore e dhënësit pasqyrohet tek marrësi. Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) urdhëron e thotë: “Varfëria është mburrja ime!”

Ky hadith është një pllakatë mirësie. Pikëpamja që zgjedh apo preferon pasurinë shpirtërore për-para pasurisë së kësaj bote, urdhëron mjaftuesh-mërinë dhe të qënurit i ngopur. Kjo shprehje ësh-të për të kuptuar nga afër bukurinë dhe mirësinë që ekziston tek të varfërit e devotshëm.

Ata të cilët janë përcaktuar në ajetin Kur'anor si “të varfër”, ora ata të cilët nuk mund të kërkojnë

Ai që jep lëmoshë, ta jape atë sa më shpirtërisht dhe përzemërsisht, sepse edhe për atë që e merr bëhet më e begatshme. Një shkëmbim i tillë është burim qetësie si për atë që jep, ashtu edhe për atë që merr. Pasi thellësia shpirtërore e dhënësit pasqyrohet tek marrësi.



për shkak të etikës dhe moralit të tyre, janë ata të cilët janë të përgatitur për të qenë të ngopur dhe të mjaftueshëm, me një thesar dhe me një pasuri shpirtërore. Sa thesar i madh është të mjaftohesh me atë që ke. Mevlana thotë:

“Ajo që i shkon një bujari është mirësia ndaj një të varfëri. Ajo që i shkon të dashuruarve është sakrifica në rrugën shpirtërore”

Për të qenë shembull në lëmoshë Ibn Kajjim e shpreh kështu pasurinë shpirtërore në dhënien e një nafakaje të Pejgamberit (a.s):

“Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) nuk mund ti ngjasonte asnjë njeriu përsa i përket dhënies si sadaka të gjërave që kishte. Ai nuk i mblidhte gjërat që Allahu ia kishte dhënë, nuk i mbante në një qoshe. Nëse dikush i kërkonte pak apo shumë ai padyshim që ia jepte. Mënyra e tij e dhënies së sadakasë të bënte të mendoje se ai nuk frikëso-hej aspak nga varfëria. Dhënia e sadakasë ishte për të një kënaqësi e madhe. Gëzimi që ndjen-te ai kur jepte sadakanë ishte shumë herë më e madhe se gëzimi i atij që merrte prej tij sadaka. Ishte më bujari i njerëzve përsa i përket punëve të mira. Dora e tij e djathtë ishte si një erë që vër-shonte begati. Kur një nevojtar i tregonte hallin që kishte ai emocionehej shumë, e merrte pranë vetes dhe nganjëherë i jepte ushqimin që kishte për vete apo edhe veshjen e tij”.

Në Tefsirin e Hazimit, si transmetim nga Xha-biri thuhet:

“Një fëmijë i vogël erdhi tek profeti. I paraqiti atij dëshirën e nënës së tij për një këmishë. Në atë moment Pejgamberi ynë nuk kishte tjetër këmi-shë përveç asaj që kishte veshur. Ai i tha fëmijës që të vinte një ditë tjetër. Fëmija iku. Erdhi për-sëri dhe i transmetoi kërkesën e nënës së tij për këmishën që pejgamberi kishte veshur. Më pas profeti hoqi këmishën që kishte veshur duke ia zgjatur fëmijës. Në atë moment Bilali po thirrte ezanin meqë kishte hyrë koha e namazit. Por pe-jgamberi meqë s’kishte diçka të hidhte sipër nuk mundi ti bashkohej xhematit. Disa nga ashabët të merakosur shkuan pranë tij. Ata e panë pro-fetin pa këmishë. Një gjëndje e tillë ato i vuri në mendime të thella.

Umer bin Abdulaziz si “halifeja i pestë” që ish-te thoshte:

Namazi të çon deri në gjysmën e rrugës. Agjë-

rimi hap rrugën e padishahut. Kurse sadakaja të fut në qetësinë e padishahut.”

Nga Ubejd bin Umejr:

“Njerëzit shkojnë në ditën e gjykimit të uritur, të etur dhe ta paveshur. Cili prej tyre që u ka dhënë për të ngrënë të tjerëve për hir të Zotit kur ka qënë në këtë botë, edhe Allahu e ushqen atë në atë moment. Kush u ka dhënë të tjerëve për të pirë, edhe Allahu i jep për të pirë. Dhe së fundi kush ka veshur dikë në këtë botë, edhe Allahu e vesh atë në ahiret.”

Në hadith thuhet:

“Jep sadaka o njeri që edhe ty të të jepet” (Buhari, Muslim)

Sa bukur e shpjegon Mevlana këtë çështje në këtë shembull:

“Malli nuk pakësohet aspak kur jep sadaka. Me punë të mira malli nuk humbet, por ruhet.”

“Zekati që jep bëhet mburojë për atë që jep. Edhe namazi që fal bëhet ruajtës për ty duke të ruajtur ty nga të këqijat.”

“Fara boshatiset tek ambari i atij që mbjell. Ndërkohë që kur vjen koha e korrijes sa përqind të farave merr. Sa ambar të mbushur merr përkundrejt një ambari të boshatisur.” Por nëse gruri nuk mbillet dhe nuk përdoret në vendin e duhur, ai bëhet ushqim për insektet e tjera. Këta e shkatërrojnë atë plotësisht.”

Allahu Teala urdhëron e thotë:

“Jepni sadaka nga ajo që u kemi dhënë ne!” (el-Munafikun/10)

“(O i dërguari im! Lajmëroji me një lajm të hidhur ata që grumbullojnë arin dhe argjendin dhe nuk e harxhojnë atë në rrugë të Allahut!” (et-Tevbe/34)

Në hadith thuhet:

“Sadakatë fillimisht kalojnë në dorën e atij që Allahu i ka dhënë dhunti dhe më pas në dorën e nevojtarit...” Besimtari sadakanë dhe zekatin ia jep në dorë Allahut, nëse nevojtarit e merr këtë dhe bëhet mëkëmbës i Allahut. Ata që jepen i jepen nevojtarit me një etikë të caktuar. Për të kuptuar pikërisht rëndësinë e këtij adhurimi në ajet thuhet:

“Njerëzit shkojnë në ditën e gjykimit të uritur, të etur dhe ta paveshur. Cili prej tyre që u ka dhënë për të ngrënë të tjerëve për hir të Zotit kur ka qënë në këtë botë, edhe Allahu e ushqen atë në atë moment. Kush u ka dhënë të tjerëve për të pirë, edhe Allahu i jep për të pirë. Dhe së fundi kush ka veshur dikë në këtë botë, edhe Allahu e vesh atë në ahiret.”



“Sadakatë i merr Allahu” (et-Tevbe/104)

Etika që duhet patur kujdes duke dhënë sadaka është shumë e rëndësishme. Etika në sadaka shprehet e tillë në shprehjet Kur’anore:

“O ju që besuat! Mos i çoni dëm të mira e bëra duke lënduar të tjerët sikurse ai që harxhon mallin e vet sa për tu dukur kur nuk beson tek Allahu dhe tek dita e gjykimit!” (el-Bakare/264)

Miq të e ngushtë të Allahut kur jepen sadaka dhe zekat nga dyshimi për të mos rënë në mburrje tregoheshin tepër modest para nevojtarit.

Sulejmani nuk ka treguar asnjë lloj përlujeje ndaj salltanetit që Allahu i kishte dhënë në këtë botë duke e mbartur atë jashtë zemrës së vet. Ai shpesh herë shkonte pranë të varfërve dhe kënaqej nga biseda me ta.

Ai thoshte:

“Nevojtar i shkon nevojtarëve!”

Kështu ai arrinte të ketë modestinë më të madhe në jetën e kësaj bote.

Ai e kuptonte plotësisht kuptimin e ajetit:

“O njerëz! Të gjithë jemi të varfër. I pasur është vetëm Allahu.”

Një ditë një njeri i pavetëdijshëm i pëlqen të rrijë pranë të varfërve me shpirt të pasur dhe i thotë Sulejmanit që rrinte përherë me ta:

-Pse rrin me këta të varfër?

Ndërsa Sulejmani iu përgjigj:

- Pasi unë dua vetëm ata që kanë shpirtrat e pasur.

Një shtambë që grykën e ka të mbyllur dhe përbrenda ka vetëm ajër ecën pa u fundosur në ujë. Edhe besimtari i cili është i mbushur me dashurinë për Allahun dhe që të njëjtën kohë gojën e ka të mbyllur ndaj debateve dhe gjërave të kësaj bote arrin në sa e sa dekada të larta duke mos u përmbysur. Një besimtar shpirti i të cilit është i mbushur me bujari, mëshirë, modesti dhe dashuri nuk mashtrohet pas kësaj bote duke ecur përpara.

Sa e sa mirësi që i takojnë kësaj bote në syrin e tij janë asgjë. Ata dëshirojnë që shpirtrat e tyre të jenë të mbushur me dashurinë hyjnore në mënyrë që edhe ngritja në qiejt e dashurisë hyjnore të bëhet e lehtë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet ti kushtojmë kujdes në këtë muaj të madhërueshëm të faljes dhe të shpëtimit është edhe përjetimi i natës së Kadrit.

Nata e Kadrit është një natë dhuntish të veçanta që vijnë nga mëshira e pafundme e ymmetit të Muhammedit. Sa e sa thesare shpirtërore dhurohen në këtë natë. Përveç madhështisë së kësaj nate, po këtë natë është zbritur edhe një sure.

Nata e kadrit është ndriçuar me zbritjen e Kur'anit të madhnueshëm pikërisht në këtë natë. Një ndodhi e tillë është formuar edhe nga ana shpirtërore nga Xhebraili dhe melekë të tjerë. Kjo natë, në të cilën i është dhënë prehja nga ana shpirtërore e padukshme besimtarëve, është një dhunti plot fryte dhe begati, një natë mëshire e dhënë robërve të zotit, dhe një stinë pranvere muaji i ramazanit.

Nata e Kadrit është një natë plot mëshirë dhe falje që vijnë nga Pejgamberi (a.s) në hadith thuhet:

“Ai që e kalon natën e Kadrit duke i besuar mirësive dhe fuqisë hyjnore, duke pritur seapin nga Allahu dhe duke e kaluar këtë natë me adhurim dhe përkushtim i falen të gjitha gjynahet –përveç të drejtës së robit-“(Buhari, Muslim)

Të kuptuarit dhe të jetuarit e të vërtetës së natës së Kadrit bëhet e mundur vetëm me detyra që nuk përzihen me përpjekjet e kësaj bote dhe me namaze, agjërim, zekat dhe punë të tilla që realizohen me përkushtim. Vetëm nëse arrijmë ta përfundojmë shkollën e ramazanit me këtë përkushtim shpirtëror bëhet e mundur marrja e dëshmisë apo pranimi i fjalës së njësisë që është një bajram i vërtetë.

Përsa i përket të jetuarit të bajramit kjo do të bëhet duke forcuar lidhjet farefisnore dhe miqësore dhe duke i zgjatur shpirtrat tanë drejt të varfërve, të pastrehëve, jetimëve, atyre që kanë

mbetur pa bashkëshort dhe atyre që janë të lodhur. Për ata të cilët i kanë kthyer shpinën miqve të tyre të ngushtë, të afërmve, të pashpresëve dhe vëllezërve që kanë mbetur pezull në një qoshe nuk mund të mendohet ndjesia dhe shijimi i bajramit.

Mevlana kur thotë se është e domosdoshme të sillemi me kujdes ndaj “zemrave të thyera” ai shprehet kështu:

“Një shpirt i shkatërruar është këndvështimi i Zotit. Është vendi ku ka urdhëruar Zoti. Arritjet e Zotit janë tek këto shpirta. Në këto shpirta të shkatërruar ka plot varre. Sa i lartë dhe i fuqishëm është ai që ka krijuar shpirtin.”

Duhet të dihet se bajrami nuk duhet të jetë një pushim apo shkak i një lumturie individuale por duhet të jetë shkëndija e zjarrit sociale e një dashurie të përgjithshme, e një dhembshurie dhe mëshire si dhe të ndjenjave njerëzore. Bajrami i vërtetë duhet të jetë një atmosferë e gjerë mëshire dhe një ditë e madhnueshme plot kujtime të mrekullueshme të cilat përzihen dhe bashkohen me njëra-tjetrën në një emocion besimi të thellë të myslimanëve që shohin një falje të pafundme.

Bajrami është një ditë e madhe e përbashkët e të madhit dhe të voglit, e të dëmtuarit dhe e të shëndetshmit, e të pasurit dhe e të varfërit. Të qënurit e të gjithëve të lumtur arrihet me të jetuarit e kuptimit të vërtetë të bajrameve. Në këtë aspekt bajrami është një ditë e cila bëhet shkak i një dashurie, dhembshurie, Ramazani dhe bajramet janë pjesë e mëshirës për ditë të lumtura pas vdekjes. Por në botën që jetohej bajrami i vërtetë që do ti falë buzëqeshje një të mjeri, që do ta gëzojë një të pazot vallë për çfarë lënde ka nevojë?

Vallë ky bajram sa mund ta ndihmojë një nënë nevojtare që nuk mund ti japë qumësht fëmijës së saj dhe që ka nevojë për një kokërr pilaf apo shpirti ynë i mbetur jetim në një qoshe?

Në ç’pozicion do ta marrim në llogari veten tonë duke përcaktuar pikën në të cilën ndodhemi dhe duke peshuar shpirtat tanë me ato shërbime dhe mëshira që do të shfaqim?

Sa botë e bukur xhenneti është bajrami për ata që arrijnë tu kthejnë vështirimet e tyre me buzëqeshje atyre që kanë nevojë!

Sa i bukur është bajrami për ata shpirta besimtarësh që arrijnë të përqafojnë ymmetin me gjithë anën e tyre shpirtërore!

Ne sot jemi udhëtarë që do të merremi prej këtyre duarve të këtyre shijeve artificiale.

Shpirtat e frytshëm do të shijojnë mallin e këtyre zemrave shpirtërore që shkojnë e vijnë. Ndarja nga shpirtat e shkatërruar nga xhehenemi do ti bëjë të vetmuarit që të derdhin lotët e lamtumirës. Zoti ynë do të na gostisë ditët e bajramit si një shpërblim pas sadakave të dhëna dhe punëve të mira të bëra duke ditur vetëm fuqinë e mëshirës dhe të durimit.

Zoti ynë na mundësoftë jetën e kësaj bote një ramazan të vërtetë dhe na e mundësoftë mëngjesin e ditës së gjykimit një bajram të vërtetë!

Ajetet dhe Hadithe për Ramazanin

O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm (Bekare, 183)

(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. Është ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor) i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. (Bekare, 184)

Muaji i Ramadanit që në të filloi të shpallet Kur'ani, udhërrëfyes për njerëz dhe sgarues i rrugës së drejtë dhe dallues i të vërtetës nga gënjeshtria. Është kush përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim dhe nuk dëshiron vështirësim për ju. Të agjëroni më vonë ditët e lëshuara që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun sepse Ai u udhëzoi dhe ta falënderoni Atë. (Bekare, 185)

"Çdo punë e birit të Ademit është e tij me përjashtim të agjërimin, i cili është i Imi dhe Unë e shpërblej me të ..." (Buhariu dhe Muslimi)

Transmetohet nga Ebu Hurejra se Profeti (a.s.) ka thënë: "Agjërimi është mburojë. Kur ndonjëri prej jush agjëron nuk duhet të flasë fjalë (të këqija) dhe të veprojë vepra të pahijshme. Kur dikush e godet apo e shan, le të thotë: "Jam agjëruar, jam agjëruar." Pasha Atë në dorën e të cilit është vetja ime, era e gojës së agjëruarit tek Allahu është më e mirë se era e miskuut" (Buhariu dhe Muslimi)

Hudhejfe ka thënë se ka dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: "Sprovën e personit në familjen e tij, pasurinë e tij, fqinjin e tij, e fshin namazi, agjërimi dhe sadakaja" (Buhariu dhe Muslimi)

Transmetohet nga Sehl, i cili rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: "Në xhenet ka një derë që quhet Rejhan. Në ditën e Kiametit futen prej saj vetëm agjëruesit dhe nuk futen në të tjetër veç tyre. U thuhet: 'Ku janë agjëruesit?' Kur futen ajo mbyllet dhe nuk futet tjetër veç tyre". (Buhariu dhe Muslimi)

Ebu Hurejra rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: "Kur vjen Ramazani hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xehenemit dhe shejtanët lidhen" (Buhariu dhe Muslimi)

Ebu Hurejra rrëfen se Profeti (a.s.) ka thënë: "Kush ngrihet Natën e Kadrit me besim dhe përkushtim i falen atij gjynahet e kaluara. Kush agjëron me besim dhe përkushtim i falen atij gjynahet e kaluara" (Buhariu dhe Muslimi)

"Çdo punë e birit të Ademit është për të, shpërblehet prej dhjetë deri në shtatë-gjind herë më shumë, përveç agjërimit, që në të vërtetë është vetëm për Mua dhe unë e shpërblejë për të, e të epshin e vet dhe ushqimin e tij vetëm për Mua. Agjëruesi ka dy gëzime: një gëzim e ka kur të bëjë iftar dhe tjetrin kur të takoj All-llahun" (Muttefekun Alejh)

"Agjërimi dhe Kur'ani ndërmjetësojnë për robin në ditën e gjyqimit.

Agjërimi thotë:

"O All-llah, i kam larguar ata nga ushqimi dhe kënaqësitë pra mundësoma mua që të ndërmjetësoj për të. Poashtu edhe Kur'ani thotë: O All-llah i kam ndaluar ata nga gjumi i natës, prandaj mundësoma mua që të ndërmjetësoj për ta. All-llahu (xh.sh.) ua mundëson që të dyve" (Ahmedi)

Nga Ebu Hurejre (r.a.) transmetohet se ky e ka pyetur Pejgamberin Muhamed (a.s.): Cila është vepra më e mirë? Ka thënë: "Agjëro, me agjërimin nuk ka të barabartë." (Nesai)

Tregon Ebu Uthane: "Shkova tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i thashë: "Më urdhëro me një vepër që të kem dobi tek Allahu me të." Më tha: "Të urdhëroj të agjërosh, ngase nuk ka diçka të njëjtë me të."

BASHKOHU ME KARVANIN E TE DEVOTSHMËVE

Shumë prej nesh kanë parë që u ka shkuar jeta duke ecur me ndjenjën “Inshallah një ditë do ta rregulloj edhe jetën time” dhe herë pas here jemi penduar. Por kur kujtohen të vërteta të tilla si: artificialiteti i jetës, moskthimi mbrapa përsëri i kohës së kaluar dhe ajo që është më e rëndësishmja, mosnjohja e kohës që na ka mbetur deri në frymën e fundit, do të na bëj të kuptojmë menjëherë se ky mendim është një cytje prej shejtani.

Kur fillojmë ta lexojmë Kur'anin me vëmendje të madhe si një mesazh që na është dërguar nga Allahu, bëhemi dëshmitarë të disa ajeteve paralajmëruese tronditëse. Bile herë pas here ka ndodhur që të themi me vete: **“Subhanallah! Nuk e paskam lexuar asnjëherë këtë ajet!”** Një situatë e tillë sikurse është një rezultat i natyrshëm i freskisë së përhershme të fjalës hyjnore, është edhe e lidhur nga afër me shkallën e zgjimit të botës sonë shpirtërore, pasi të kuptuarit drejtë të Kur'anit është i mundur vetëm me zemra të shëndetshme. Përveç kësaj ajeti kuranor: “A nuk e mendojnë ata Kur'anin në detaje të detajeve? Apo zemrat e tyre janë të kyçura me çelës?” është një tregues i këtij realiteti. Ashu siç e ka shprehur edhe mendimtari mysliman Muhamed Parsa “Kush e ka zemrën më të pastër, ai do ta kuptojë më mirë Kur'anin dhe do të përfitojë më tepër nga e fshehta hyjnore” Zoti na e mundësoftë një gjë të tillë dhe na e shtoftë mundësinë për të marrë sa më shumë pjesë prej tij! (Amin)

Këto ajete që tërheqin vëmendje për domosdoshmërinë e të qenit prej të devotshmëve pa ardhur vdekja, janë një paralajmërues i madh për të gjithë ne. “O besimtarë! Mallrat dhe fëmijët tuaj mos t’ju pengojnë për të përmendur shpesh Allahun. Kush e bën këtë ai është i humbur. Kur ti vijë vdekja secilit prej jush askush mos të thotë: “Zoti im! Sikur të më lësh edhe për pak kohë, sikur të jap sadaka dhe të jem prej të devotshmëve! Pasi Allahu askujt nuk ia zgjat kohën pasi t’i vijë momenti i duhur dhe i përcaktuar prej Tij. Allahu i di ato që ju keni bërë.” Edhe pse në këto ajete të përmendura ka shumë mesazhe që duhen analizuar në dëshirojmë të ndalemi pikërisht tek ky mesazh: “Zoti im! Sikur të më japësh mua edhe një kohë të shkurtër dhe unë të bëhem prej të devotshmëve!”. Shumë prej nesh kanë parë që u ka shkuar jeta duke ecur me ndjenjën “Inshallah një ditë do ta rregulloj edhe jetën time” dhe herë pas here jemi penduar. Por kur kujtohen të vërteta të tilla si: artificialiteti i jetës, moskthimi mbrapa përsëri i kohës së

kaluar dhe ajo që është më e rëndësishmja, mos-njohja e kohës që na ka mbetur deri në frymën e fundit, do të na bëjë të kuptojmë menjëherë se ky mendim është një cytje prej shejtani.

Një nga duatë që Kur'ani na ka mësuar është edhe kjo: **“Zoti im! Ma merr shpirtin tim si mysliman dhe më përfshij mua mes të devotshmëve”** Kjo lutje është e rëndësishme. Pasi për lumturinë e përfjetshme është e nevojshme të jemi prej të devotshmëve. Edhe Kur'ani njofton se ata të cilët tregohen të verbër në këtë botë ndaj të drejtës dhe të vërtetës janë të verbër edhe në ditën e ahiretit. Në lidhje me temën Muhjiddin ibn Arabi transmeton nga Abdullah b. Ustadh el-Mervezi:

“Sot pashë në ëndërr vëllanë tim që u nda nga jeta dhe pyeta: “Cili ishte shpërblimi që të dha Allahu ty?” Ai m'u përgjigj: “Mua më vendosi në xhenetin e Tij dhe unë atje ha dhe pi si të dëshiroj nga mirësitë e Tij. Dhe unë i thashë: “Unë nuk të pyeta këtë; a arrite ta shikosh ekzistencën e Allahut?” Më pas mua m'u përgjigj “Fatkeqësisht nuk arrita ta shoh. Atë e shohim vetëm ata që e njohin!” dhe ndërkohë unë u zgjova nga gjumi”.

Këto fjalë të transmetuara nga Ubejdullah Ah-rar janë një paralajmërim shumë serioz për ata që kanë marrë mirësinë për të qenë bashkë me të devotshmit ose edhe që kanë pasur mundësi të njihen me ta: “Kur ju duke qenë në jetë, ku nuk arritët të shihni Allahun por kur të vdisni çfarë do të bëni” Këto fjalë në lidhje me “të parët e Allahut” kur je në jetë të transmetuara nga të mëdhenjtë e thënë me shprehjen e Xhunejd Bagdadit kanë kuptimin “Të njohësh Allahun me zemër (marifetullah)”. Rruga më e sigurt për të marrë pjesë në karvanin e të devotshmëve është t'i duash ata. Kjo pasi edhe lidhja e dashurisë është themeli apo baza e çdo gjëje. Një ditë një person erdhi tek Profeti ynë Muhamedi (a.s) dhe e pyeti: “O i dërguari i Allahut! Ç'mendim keni për atë person që edhe pse e do një shoqëri, nuk është bashkuar me të” Pejgamberi i zbritur si mëshirë për gjithë botët urdhëron e thotë: **“Njeriu bashkohet me atë që do”**. Sa lajm i mirë është ky hadith për ata që duan pejgamberët, besnikët, shehitët dhe të devotshmit. Ata që në zemrat e tyre mbartin dashuri të tilla, do të thotë se padyshim janë bërë pjesë e mirësisë së Allahut. Prandaj është e nevojshme që të kërkohet dashuri nga Zoti ynë që ka edhe emrin tjetër “Kerim” sikurse Davudi (a.s), i cili i lutej me këto fjalë

Pejgamberi i zbritur si mëshirë për gjithë botët urdhëron e thotë: “Njeriu bashkohet me atë që do”. Sa lajm i mirë është ky hadith për ata që duan pejgamberët, besnikët, shehitët dhe të devotshmit. Ata që në zemrat e tyre mbartin dashuri të tilla, do të thotë se padyshim janë bërë pjesë e mirësisë së Allahut.



Allahut të Lartë.


“Zoti im! Kërkoj që të të dua Ty, kërkoj që të të dojë ai që të do, gjithashtu kërkoj prej teje edhe punën e mirë që do të më çojë në dashurinë Tënde. Zoti im, le të jetë dashuria jote për mua më e dashur.”

Të duash të devotshmit është një derë shprese e madhe shpëtimi për vetë individin. Por për një person siç është Pejgamberi i dërguar si mëshirë për gjithë botët dhe që edhe në Miraxh thotë “Ymeti im! Ymeti im!” sa mund të jetë i drejtë mendimi për të shpëtuar vetëm veten e tij? Vallë a nuk nevojitet që në vend që t'u bëhemi barrë të devotshmëve, duke përparuar edhe më shumë në rrugën e shpëtimit t'i ndihmojnë me sa të kemi mundësi? Ndërsa Mevlana thotë:

“O byrazer! Mirësia e Zotit është një det i pa-fund. Kudo që të ndodhesh në të, mos humb kohë, ec përpara për hir të Zotit”

“Në çfarë do lloj posti qofsh, Unë jam rob i

“Ata të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira Ne padyshim që do t’i përfshijmë tek të devotshmit”



mirësisë së lartë që ka ai që është i vetëdijshëm që nuk e ka arritur mirësinë e Allahut dhe se nuk e ka përgatitur akoma veten për aty.”

Sipas transmetimit të Feriduddin Attar një ditë Hatem-i Essam i thotë Bejazid-i Bistamit:

- O Bejazid, a është e vërtetë kjo fjalë që ti u paske thënë muridëve të tu që “Ai i cili shkon në derën e xhehenemit dhe që ne vend të atij që është aty nuk vendos veten e vet, nuk është më nxënësi im”

Bejazidi i përgjigjet:

- Po ashtu është. Edhe tani bile them që ai që qëndron në derë të xhehenemit dhe nuk ndër-mjetëson.

Nuk duhet të habitemi nga këto fjalë, pasi kjo është ajo lidhje që i ka çuar edhe miqtë e ngushtë të Zotit drejt postit hyjnor, bile edhe drejt dhembshurisë së kërkuar. Padyshim që është më mirë që peygamberëve dhe miqve të ngushtë të Zotit t’u qëndrojmë pranë në ndihmesë dhe shërbime

në vend që t’u bëhemi ngarkesë për ta. Në këtë aspekt sa kuptimplotë është kjo fjalë e Alvarli Efesë: “Mos u bëj gjynahqar. Mos e ul veten në këtë botë kalimtare”.

Ibrahim Dusuki thotë: “Ata që dua unë mes bijve të mi, janë ata që çdo moment ngrihen nga një shkallë. Kur shohim bij të tillë na habiten sytë. Ja pra prej këtyre njerëzve mund të mësohet”, nëse mendohet se adhurimi më i rëndësishëm pas farzit, është të gëzosh shpirtin e një besimtari do të kuptohet se sa mirësi e madhe është çdo hap që hidhet në këtë rrugë. Përpjekjet e bëra në këtë rrugë nuk ka dyshim që me kohë individin do ta përfshijnë në karvanin e miqve të ngushtë të Zotit. Mevlana thotë: “Të çalosh është të ecësh me katër këmbë në tokë. Edhe sikur të jesh si i fjetur ec në rrugën e Zotit dhe kërkoje Atë. Pasi edhe sikur të të vijë rëndë, padyshim kush kërkon gjen” Kjo pasi edhe në një ajet kuranor thuhet: “Ata që përpiqen për Ne padyshim që do t’ua tregojmë rrugën”

Allahu i Lartë i cili na informon se të devotshmit do të bëhen miq të ngushtë të Zotit i paraqet kështu detyrat e tyre: **“Ata kanë besuar dhe kanë punuar në shkallën e devotshmërisë”** Edhe në një tjetër ajet kuranor e njëjta e vërtetë theksohet në këtë mënyrë: **“Ata të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira Ne padyshim që do t’i përfshijmë tek të devotshmit”**

Temën tonë dëshirojmë ta përfundojmë duke i thënë “Amin” duase së një miku të ngushtë të Allahut:

“O Zoti im! Na bëj neve ashtu sikurse i kë bërë të devotshmit dhe na mundëso përsëri neve që të marrim fryte nga sjelljet dhe veprimet e tyre”

A keni 1 MINUTË KOHË TË MË DËGJONI?

Me kënaqësi i vëmë veshin që të dëgjojmë cicërimat e zogjve, fëshfëritjet e gjetheve të pemëve dhe tingujve që lëshojnë dallgët e detit tek përplasen për shkëmbinj të gjenden në breg, por a ia arrijmë vallë të dëgjojmë shprehjet dhe mendimet e njerëzve? A ia japim vallë këtë vlerë njeriut me të cilin duam apo nuk duam ne, duhet të krijojmë marrëdhënie të përditshme? Teksa përpiqemi të sigurojmë një komunikim sa më të efektshëm dhe pozitiv me ta, a e përsosim ndjesinë e shpirtit dhe zemrës sonë që të mund të perceptojmë madje edhe nevojat njerëzore që fshihen mes radhëve të fjalëve të artikuluar?

I dashuri ynë profeti Muhamed (a.s.) çdo fjalë dhe shprehje e të cilit është e mbushur përplot me urtësi ka thënë: **“Kur një grup njerëzish ulen të kuvendojnë dhe nuk i lënë mundësi njëritjetrit që të shprehin mendimet e tyre duke i ndërprerë në mes fjalët, begatia hyjnore largohet nga ai kuvend njerëzish”.**

Udha që të fitoni respektin e të tjerëve ndaj jush kalon nga respektimi që tregoni ju ndaj të tjerëve. Nuk duhet harruar se edhe po qe se nuk paraqet rëndësi dhe interes për ne çdo fjalë që na thuhet, ajo është shumë e rëndësishme për personin që ndjen nevojën për ta shprehur. Në qoftë se arrijmë t’i kushtojmë rëndësi fjalëve të bashkëbiseduesit tonë dhe këtë e shndërrojmë në etikë të jetës së përditshme, do të arrijmë edhe të kemi respekt për të tjerët, edhe të fitojmë respektin e tyre. Ja në sajë të këtij arti mund të kemi ndikim me fjalët tona mbi shumëkënd dhe mund të na çelen përpara nesh një nga një dyer të shumta.

Njerëzit që e kanë shndërruar në art durimin e të dëgjuarit të tjetrit me kujdes, mund të sjellin ndërmend edhe pas shumë vitesh ato gjëra që i kanë ruajtur në skutat e kujtesës dhe ndërsa ngrenë frone mbi zemrat e njerëzve në një anë

suksesin e realizojnë edhe në sajë të avantazhit që u fal kjo veçori e tyre.

Në situatat kur mendimet dhe ndjenjat tona reflektohen tek fjalët që themi secili prej nesh ka përjetuar se si rritet apo zbret tensioni i gjakut teksa shprehim apo përballemi me fjalë që vjellin urrejtje dhe mllef apo që shprehin gëzim dhe hare. Kjo do të thotë që aftësitë e të folurit dhe të dëgjuarit janë të rëndësishme për shëndetin shpirtëror, po aq sa edhe për atë fizik.

Po qese do të ndalim një çast dhe do t’i hedhim një vështrim gjendjes në të cilën ndodhemi, shohim se nuk arrijmë të përqendrohemi tek ato që thuhën kur nuk ndjejmë interesim për atë që dëgjojmë.

Ose ndodh që i kushtojmë aq shumë rëndësi pamjes së jashtme të personit që flet sa që lëmë të na ikën fjalët që ai thotë.

Ose ngjan që t’u japim kuptimin që dëshirojmë fjalëve që na thuhën nisur nga paragjykimet që kemi ndaj personit dhe e bindim vetveten që të dëgjojë atë që i thotë mendja jonë dhe jo atë që na shpreh personi përpara nesh.

Allahu i Lartësuar na mundësoftë të jemi nga ata njerëz që lavdërohen në Kur’an me ajetin **“Vetëm ata që dëgjojnë me çiltërsi i japin një përgjigje pozitive ftesës që u bëhet...”** (Enam, 36)

MREKULLIA E KRIJUESIT FLUTURIMI DHE QËNDRIMI I SHPENDËVE NË LARTËSI

Allahu i madhëruar në Kur'anin fisnik urdhëron e thotë: "A nuk i shohin ata shpendët fluturues në qiell, të cilët nuk i mban kush, përveç Allahut. Edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë." (Nahl, 79)

Për të mundur të përballojnë një fluturim kaq të rëndë Allahu i madhëruar u ka dhuruar shpendëve mjeshtërinë e shfrytëzimit të erërave të përshtatshme. P.sh. lejlekët fluturojnë mbi 2.000 metra lartësi, duke arritur rrymën e ajrit të ngrohtë dhe pastaj fluturojnë duke shfrytëzuar rrymën e tyre deri te lëvizjet e nxehta të tjera, të cilat do t'i mundësojnë pa lëvizjen e krahëve, të kalojnë distanca të mëdha.

Teknika tjetër e fluturimit që shfrytëzojnë lejlekët është fluturimi në formacionin e formës "V". Në këtë mënyrë, lejleku më i madh dhe më i fuqishëm në ballë të tufës

shërben si mburojë kundër rrymave të fuqishme të ajrit dhe kështu u përgatit rrugën atyre që janë të dobët. Inxhinierët e aeronautikës po-hojnë që me këtë mënyrë të organizimit lejlekët arrijnë të kursejnë energji deri në 23%.

Disa shpendë shtegtarë fluturojnë në lartësi shumë të mëdha. P.sh. patat e egra mund të fluturojnë në lartësi deri në 8.000 metra. Kjo është lartësi e jashtëzakonshme për faktin që në lartësi 5.000 metra atmosfera është 63% më e rrallë se sa në nivelin e detit. Duke fluturuar në këtë lartësi, shpendët duhet të rrahin më shpejtë me krahët e tyre sepse u nevojitet më shumë oksigjen.

Mirëpo, mushkëritë e këtyre shpendëve janë të krijuar nga Allahu i Plotfuqishëm në atë mënyrë që ata të shfrytëzojnë maksimalisht oksigjenin që kanë në dispozicion në këto lartësi. Mushkëritë e shpendëve funksionojnë

ndryshe nga ato të gjitarëve dhe kjo i ndihmon ata që edhe nga ajri më i rrallë madje të mund të marrin më shumë energji.

Gjatë emigrimit, zogjtë shtegtarë marrin parasysh fenomenet atmosferike.

P.sh. ata ndryshojnë drejtimin e fluturimit të tyre për t'iu shmangur shtrëngatave. Shkencëtarët që kanë hulumtuar shqisën e dëgjimit të shpendët, kanë vërejtur që disa prej tyre mund të dëgjojnë zëra në frekuenca shumë të ulëta që vijnë nga atmosfera në largësi të mëdha.

Zogjtë shtegtarë mund të dëgjojnë fillimin e shtrëngatës nga malet e largëta ose zërin e tornados në oqeanin që është me qindra kilometra larg. Përveç kësaj, është i njohur fakti që zogjtë zgjedhin me kujdes rrugën e shtegtim të tyre larg nga zonat ku nuk janë të sigurtë për kush-tet atmosferike.



Si e përcaktojnë zogjtë drejtimin e rrugës së tyre të gjatë me mijëra kilometra, pa hartë, pa busull apo ndonjë mjet të ngjashëm gjatë fluturimit të tyre? Teoria e parë pohon që zogjtë mbajnë mend karakteristikat e tokës ku fluturojnë dhe kështu arrijnë te caku i tyre pa probleme. Por, eksperimentet treguan që kjo teori është e pasaktë. Në një eksperiment me pëllumbat, u përdorën thjerra të padukshme me të cilat ju dobësua shikimi i tyre. Në këtë mënyrë ata privoheshin nga përcaktimi i drejtimin të udhëtimit në bazë të terrenit në tokë. Por, prapë se prapë pëllumbat kanë arritur të gjejnë rrugën, bile edhe kur kanë qenë larg me disa kilometra nga tufa e tyre.

Hulumtimi tjetër ka treguar që fusha magnetike e Tokës ndikon te shpendët. Eksperimentet e ndryshme kanë treguar që shpendët kanë sisteme tejet të avancuara të

vëzhgimit magnetik i cili u mundëson të gjejnë rrugën e tyre duke shfrytëzuar fushën magnetike të Tokës. Ky sistem efikas u ndihmon shpendëve që gjatë shtegtimin të përcaktojnë drejtimin duke vëzhguar ndryshimet në fushën magnetike të Tokës. Eksperimentet kanë treguar që zogjtë shtegtarë mund të regjistrojnë bile edhe 2% të ndryshimeve të fushës magnetike të Tokës.

Mirëpo, pyetja kryesore mbetet: Si është e mundur që shpendët të jenë të pajisur me "busulla natyrale?" Jemi të vetëdijshëm që busulla është "zbulim dhe vepër e inteligjencës njerëzore".

Atëherë busulla, si instrument i zbuluar dhe prodhuar nga njeriu që me shekuj ka mbledhur dituri, si ka mundur të gjejë vendin e saj në trupin e shpendëve? A është e mundur që shpendët, përdërisa kanë gjurmuar për drejtimin e fluturimit të tyre,

kanë menduar për shfrytëzimin e fushës magnetike të Tokës dhe kanë prodhuar aparate magnetike në trupin e tyre?

Apo ndoshta shpendët rastësisht janë pajisur me këtë mekanizëm?

Shpendët këtë nuk kanë mundur ta bëjnë vetë dhe as rastësia nuk ka mundur t'i pajis ata me këtë busull tejet të zhvilluar.

Ndërtimi trupor i shpendëve, mushkëritë e tyre, krahët, sistemi i tretjes dhe aftësia e tyre të gjejnë drejtimin e fluturimit janë shembujt e krijimit të përsosur nga Krijuesi i Plotfuqishëm.

Përgjigjen për këtë na e jep qartë Kur'ani fisnik:

"A nuk i shohin ata shpendët që fluturojnë mbi ta krahëhapur dhe kur krahët i palosin ata nuk i mban askush në ajër përveçse Zotit Fuqiplotë." (Mulk, 19)

Hijeshitë e agjërimit

Në të ushqyerit me karar trupi dhe gjymtyrët mbeten të shëndetshëm, sëmundjet shmangen, sepse shkaku i sëmundjeve në përgjithësi është të ngrënë dhe të pirët pa karar. Sëmundja bëhet pengesë për adhurimet, i zhduk prehjen e zemrës dhe thyen dëshirën e madhe për adhurim.

Dijetarët e fesë kanë thënë: dhjetë veçori të hijshme gjenden tek agjërimi dhe të ushqyerit me masë:

1. Në ushqimin e pakët zemra qëndron e pastër, shpirti i orientuar drejt së vërtetës dhe shikimi është i mprehtë.

Të ushqyerit me tepri të jep një ndjenjë përtacie dhe mendjetrashësie, të verbon edhe intuitën, prandaj edhe në zemër përjeton një peshë që të rëndon dhe të bën të plogët. Nuk arrin të ndjekësh dhe kuptosh ato që të thuhën dhe nuk i kupton të fshehtat.

2. Në të ushqyerit e paktë zemra bëhet e ndjeshme. Pastërtia e zemrës bën që njeriu të konceptojë shijen që të fal lutja ndaj Zotit dhe të shoh ndikimin e ziqrit dhe adhurimeve të tjera fetare.

3. Zemra bëhet e vendosur dhe pastrohet nga shfaqjet e nazeve. Allahu në një hadith kudsî thotë: **“Unë jam së bashku me personin zemra e të cilit është thyer për hir të fitimit të kënaqësisë Sime”**. Shkatërrohet ndjenja e vetë-

lavdërimit që është fillimi i haresë së kotë dhe shkak për privime të madhe. Egon nuk e thyen gjë tjetër më shumë sesa uria.

4. Njeriu nuk i harron fatkeqësitë, as njerëzit e tjerë që kanë rënë nën kthetrat e fatkeqësive të tilla. Ai që ngop vetveten i harron të uriturit të cilët ua dinë mirë vuajtjeve që të shkaktajnë fatkeqësitë dhe uria.

5. Uria i thyen të gjitha dëshirat dhe kërkesat mëkatore duke e shtypur nën të frymën njerëzore që urdhëron vazhdimisht për keq.

6. Uria shporr edhe gjumin e tepërt i cili nga ana e tij i fal njeriut mpirje dhe ndjesi moskokëçarjeje. Ai që dëshiron të hajë shumë, ka nevojë edhe të pijë shumë, ai që dëshiron të konsumojë shumë lëngje freskueses, ka nevojë edhe të flejë shumë, ai që fle shumë është moskokëçarës për urdhrat e fesë. Kush është shumë indiferent ndaj mësimëve të fesë, është i humbur dhe ka nevojë përherë e më shumë që të pendohet për gabimet në jetë.

7. Në të ngrënët e pakët lehtësohet edhe ndjekja përherë e më shumë e adhurimeve. Kur barku ngopet, për gjymtyrët e trupit vësh-tirësohet shprehia e ndjekjes së adhurimeve.

8. Në të ushqyerit me karar trupi dhe gjymty-rët mbeten të shëndetshëm, sëmundjet shman-gen, sepse shkaku i sëmundjeve në përgjithësi është të ngrënët dhe të pirët pa karar. Sëmund-ja bëhet pengesë për adhurimet, i zhduk preh-jen e zemrës dhe thyen dëshirën e madhe për adhurim.

9. Kalon një jetë të thjeshtë dhe të përkorë pa telashe dhe kokëçarje. Ata që dëshirojnë të hanë sa më pak mjaftohen edhe me fitime të pakta. Për këtë shkak edhe profeti Muhamed kur ka thënë se “Ai që tregohet ekonomik me të ardhurat e tija nuk bie në varfëri”. Kjo na ka mësuar se ata njerëz që në plotësimin e nevoja-ve jetësore, janë të ekuilibruar me shpenzimet që bëjnë, nuk kanë për të njohur varfërinë.

10. Lëmoshën fetare (sadaka) e dhuron me hare shpirtërore, atë që i tepron ua shpërndan nevojtarëve dhe jetimëve dhe ditën e gjykimit shpëton nën hijen e sadakasë që ka dhënë.

Agjërimi i devotshmërisë

Në ajetin fisnik Allahu na e ka qartësuar këtë të vërtetë me fjalët “Agjërimi është për devot-shmërinë tuaj” Agjërimi ashtu si i thyen ndjesi-të epshore që i thith fiziku njerëzor me organet e tij, bën që njeriu të distancohet nga mëkatet dhe bëhet shkas për një jetë më të devotshme dhe mistike. Njeriu në këtë jetë më së shumti dëshiron dy gjëra: të ketë të hajë e të pijë sa të dojë dhe të plotësojë dëshirat epshoret Ashtu sikurse janë parandaluar brenda kufijve nor-malë këto dy kërkesa humane, edhe shumë sëmundje të zemrës dhe pastrimi i saj është arritur përmes agjëritimit. Të shtojmë edhe fak-tin që sipas mjekësisë agjërimi ka ndikim dhe efekt shumë pozitiv për stomakun e njeriut.

Muhamed bin Harisi rrëfen: Kam pyetur pesë grupe të ndryshme njerëzish dhe nga të gjithë kam marrë të njëjtën përgjigje:

1. Pyeta mjekët për kurën më me efekt shë-rues për trupin e njeriut dhe m’u përgjigjën “Të ushqehesh pak dhe të agjërosh”

“Ai që tregohet ekonomik me të ardhurat e tija nuk bie në varfëri”



2. Pyeta të urtët e fesë se cili është adhurimi fetar që do të më ndihmojë të afrohem sa më shumë me Zotin dhe m’u përgjigjën “Të ushqehesh pak dhe të agjërosh”

3. Pyeta eremitët myslimanë se cila është ajo gjë që të jep më shumë forcë në jetën askete dhe m’u përgjigjën “Të ushqehesh pak dhe të agjërosh”

4. Pyeta dijetarët e fesë se cila është ajo gjë që ju ka ndihmuar më shumë të ruani në kujtesë mësimet e fesë dhe m’u përgjigjën “Të ushqehesh pak dhe të agjërosh”

5. Pyeta mbretërit cila është heja më e shij-shme, por që ju bën vigjilent për çdo moment dhe m’u përgjigjën “Të ushqehesh pak dhe të agjërosh”.

Osman Nuri TOPBASH

VAKEFI DHURIMI DHE SHERBIMI



VAKEFI DHURIMI DHE SHERBIMI

Osman Nuri TOPBASH



Ndjesi shpirtërore fetare që kërkon ríptëritje:

Dhurimi dhe Shërbimi

Vepra e autorit turk osman Nuri Topbash e titulluar “Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi” tashmë gjendet e shqipëruar në gjuhën tonë. Kjo vepër cek një nga pikat dhe nevojat më nevralgjike të jetës shoqërore të bashkësisë muslimane, atë të dhurimit dhe shërbimit në rrugën dhe sipas mësimeve të fesë.

Thelbi shpirtëror i Islamit është, në besim, tevhibi, dome-thënë uniteti i Allahut, kurse në veprim, edukata, orientimi dhe mëshira. Mëshira është fryti i parë i besimit. Një zemër larg mëshirës nuk mund të quhet e gjallë. Edhe historitë e jetës së profetëve dhe të prijësve shpirtërorë janë plot me akte legjendare mëshire. Ndërkaq, njëra nga shfaqjet më të plota të mëshirës është **dhurimi** që në terminologjinë përkatëse shprehet me fjalën **infak**.

Krijimi i një mjedisi shoqëror të qetë e të kënaqur duke rritur e formuar njeriun delikat, të mirë e të thellë, është një prej synimeve bazë të fesë. Ky formim është i mundur vetëm me mbushjen e zemrave me ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë dhe me anë të zeqatit, dhurimit dhe shërbimit që janë shfaqjet më të bukura të mëshirës dhe dhembshurisë. Sepse të gjitha këto janë një detyrim falenderimi nga më të rëndësishmit të robit ndaj Zotit të vet.

Shenja më e madhe e dashuri-

së së vërtetë është sakrifica. Ai që do dikë, sakrificën për atë që do e kupton, në masën e dashurisë që ndjen, si kënaqësi dhe detyrë. Prandaj, do të duhej që zemra besimtare t’i rrokë, t’i dojë e t’i trajtojë tërë krijesat me mëshirë dhe dhembshuri për hir dhe respekt të Krijuesit!

Vepra e Osman Nuri Topbashit “Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi” ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë flitet për vakfet, në pjesën e dytë për dhurimin për hir të Allahut, ndërsa në pjesën e tretë për shërbimin dhe etikën e tij. Një vend të rëndësishëm në pjesën e dytë i jepet edhe zeqatit, si një nga pesë kushtet bazë të fesë islame duke e trajtuar atë edhe nga dritarja e legjislacionit islam dhe duke plotësuar kështu informacionin në gjuhën shqipe rreth zbatimit nga aspekti i rregullave fetare të këtij detyrimi fetar.

Në kohën tonë kur ndjenjat e vëllazërisë janë dobësuar, kur qetësia dhe prehja shoqërore janë humbur dhe kur urrejtja dhe armiqësia janë shtuar, është nevoja e një bashkëpunimi serioz për dhurim, ndihmë dhe shërbim. Por sa keq që në shoqërinë ku ndodhemi sot, për shkak të krizave shoqërore e ekonomike, nga njëra anë, dhe faktit që shumica e individëve janë shtënë pas interesit material, nga ana tjetër, aspekti zbatues i fesë me anë të sakrificave materiale është ndër specifikat më të shumta të nënvleftësuar

e të harruara, nga të cilat, ato që vijnë në mendje të parat, janë detyrimet fetare të zeqatit, dhurimit dhe ndihmës si dhe institucionet mirëbërëse mbështetur mbi ndjenjën e dhembshurisë, siç janë vakëfet.

Temat islamike që e rregullojnë jetën nga djepi gjer në varr, duhet të ritrajtohen në përputhje me nevojat, kërkesat dhe domosdoshmëritë e çdo periudhe. Po të mos bëhet kjo, ndodh që, në rrjedhën e kohës dhe baticë-zbaticat e jetës, as të mos vihet re se sa mund të largohemi nga bukuritë e sjelljes të Islamit dhe se gjer në ç’gradë mund të dobësohen këto ndjenja të larta ndër zemrat! Për shembull, njëra nga këto, siç është prekur shkurt në librin “Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi”, është “çështja e të dhjetës”.

Autori Osman Nuri Topbash shprehet mes rreshtave për nevojën që ka ndërjer për ta shkruar këtë vepër me qëllim për t’i kujtuar parimet themelore të disa çështjeve lidhur me aspektin material-financiar të fesë islame dhe për t’i vlerësuar me anë të atyre parimeve të vërtetata e shoqërisë brenda së cilës jetojmë. Synimi tij është që të përpiqet që, në shoqërinë tonë që po përjeton në nivelin më të lartë një shqetësim materialo-shpirtëror, me pretekstin e bashkëpunimit në fushën e vakëfit, zeqatit dhe dhurimit, të sigurojë arritjen e një gjendjeje dëshirimi, entuziazmi dhe vetëdijshmërie.

Shenja më e madhe e dashurisë së vërtetë është sakrifica. Ai që do dikë, sakrificën për atë që do e kupton, në masën e dashurisë që ndjen, si kënaqësi dhe detyrë.



Në librin “Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi” autori dëshiron që, të vërtetat shkencore lidhur me çështjen, t’i përdorë si kriter për të bërë një vetëllogari ndërgjegjeje. Me të vërtetë, njëri prej motiveve themelore të sukseseve historike të qytetërimit islam, në përgjithësi, dhe shtetit osman, në veçanti, i cili, duke marrë përsipër apologjinë dhe mbrojtjen para gjithë botës të një botëkuptimi të ndryshëm, pati qëndruar gjashtë shekuj e gjysmë në këmbë dhe u pati dhënë mundësi të bashkëjetonin dhjetra shoqërive me fe, gjuhë dhe raca të ndryshme, ka qenë, pa dyshim, “institucionaliteti i mirëbërësisë” dhe rëndësia që u kushtoi vakëfeve mes institucioneve të mirëbërësisë.

Meqë i erdhi vendi, duhet thënë se historia si manual përvojash kombëtare, është kujtesa e kombeve. Prandaj nuk mund të përfytyrohet ndonjë komb që s’është nevojtar për funksionin udhëzues të historisë me qëllim për ta orientuar drejt e saktë të ardhmen, sidomos po qe se ajo

histori është e mbushur plot me suksese dhe fitore materiale e shpirtërore të pashembullta që do të siguronin një besim e siguri për brezat e ardhshëm!

Njëra prej faqeve më të shkëlqyera të trashëgimit tonë historik si muslimanë nga pikëpamja njerëzore dhe qytetërimore është edhe ringjallja morale dhe përsosja e njeriut me anë të vakëfeve, dhurimit, mirëbërësisë dhe edukimit shpirtëror, janë veprimtaritë që bëhen pretekst për ta pajisur njeriun me veti morale-shpirtërore që do ta realizonin në mënyrën më të përsosur qëllimin e krijimit të tij.

Me të vërtetë, të parët tanë të bekuar, duke ua zgjidhur çështjet njerëzve nevojtarë, e patën shtrirë dhe përgjithësuar mëshirën, dashurinë dhe shërbimin gjer te kafshët e dobëta e të sëmurë si krijesa të Allahut! Ky nivel nuk është arritur gjer më sot në asnjë vend të botës. Prandaj kemi shumë mësimë për të marrë nga historia jonë e famshme. Ata patën arritur një nivel mëshire, dashurie dhe qytetërimi të pamundur për t’u arritur gjer tani, siç ka qenë, për shembull, ushqyerja me mish gjahu dhe mjekimi me muzikë i të sëmurëve mendorë që të parët tanë i quanin me një edukatë dhe respekt të lartë, **“të sëmurët e nderuar”!**

Në qytetërimin islam-osman të vakëfeve, leprozëve të izoluar nga shoqëria për shkak të sëmundjes së tyre ngjitëse e të rrezikshme u është zgjidhur dora e dhembshurisë, për ta janë ngritur institucione ku atyre u bëheshin të gjitha llojet e shërbimeve.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që t’i mësojmë ashtu siç duhet praktikatat dhe veprimtaritë e muslimanëve që bënin fole të ashtuquajtura **“shtëpitë e zogjve”** nën strehët e ndërtesave për strehimin e zogjve dhe që ngrinin vakëfe për lejekët e plagosur që nuk shtegtonin dot kur vinte koha e shtegtimit, në mënyrë që ta vlerësojmë veten me kriteret e tyre!

Nga ana tjetër, të parët tanë muslimanë të çdo kombësie që e reflektonin mëshirën dhe dashurinë me përmasat më ideale në shërbimet vakfnore dhe mirëbërëse të tyre, kanë treguar edhe vëmendjen, delikatesën dhe përpjekjen më të madhe për ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të të mjerëve, të të vobektëve, të vejushave dhe jetimëve. Delikatesa të tilla si krijimi dhe caktimi nëpër xhami i **“gurëve të sadakasë”** (gurët e lëmoshës

ku liheshin lëmoshat) me qëllim për të siguruar që dhënësi i lëmoshës dhe marrësi i lëmoshës të mos e shihnin njëri-tjetrin, si shpërndarja në errësirën e natës nëpër shtëpi e ushqimeve për nevojtarët me qëllim për të mos e dëmtuar dinjitetin e tyre, janë një mënyrë sjelljeje shembullore përmes së cilës mëshira dhe dashuria realizoheshin në përmasa ideale. Madje ngritja e një vakëfi që kompensonte dëmet e bëra pa dashje nga shërbëtorët për të mos ua lënduar zemrën, është një thellësi ndjesore shembullore e tej çdo përfytyrimi! Edhe të gjitha këto janë parime jetësore që duhen kujtuar dhe ripërfutur me përparësi në ditët e sotme me qëllim për të vlerësuar denjësisht nderin dhe dinjitetin e njeriut.

Këto njohuri, bukurinë dhe vlerën e të cilave mund ta kuptojmë me aq sa t'i reflektojmë në jetën, sjelljet dhe ndjenjat tona, duke u nisur nga shembujt e mëshirës dhe delikatesës ideale në përmbajtjen e tyre, janë mjete paralajmërimi dhe orientimi të shkundjes dhe zgjimit për të cilin jemi jashtëzakonisht nevojtarë sot ne muslimanët!

Fakti që në librin "Vakëfi, Dhurimi dhe Shërbimi" autori i tij Osman Nuri Topbash i ka dhënë kaq shumë vend shembujve të tillë, nuk është thjesht për të larë borxhin e "besës dhe miratimit" që na takon ndaj të parëve tanë muslimanë, por, në të vërtetë, për t'i marrë si shembull bukuritë e tyre me qëllim për t'i zbatuar.

Në bartjen në shoqëri të kësaj dashurie, dhembshurie dhe mëshire, vakëfet janë, për njeriun tonë të ditëve të sotme, vende ku ekspozohet shembulli, modeli dhe ku merret mësim. Në këtë vepër lexuesi ka dalë për të vizituar një ekspozitë historike asistence sociale e mirëbërësie.

Të gjitha këto shërbime të begata, të larta e të bukura, disa shembuj të të cilave janë dhënë në libër, sigurisht që, para së gjithash, mund të realizohen në sajë të njerëzve shembullorë të shërbimit që janë gati të sakrifikojnë për t'i çuar në vend ato. E thënë ndryshe, të gjitha veprimet dhe shërbimet e bukura të bëra japin rezultat sipas zemrës dhe nivelit të përgatitjes së njerëzve që i marrin përsipër. Ndërsa punët e lëna në duar të një njeriu të aftë, të përgatitur mirë dhe të përkryer përfundojnë në mënyrë të përsosur, punët nën përgjegjësinë e njerëzve të paaftë e të papërgatitur mirë përfundojnë me mijëra pendime e dëshpërime! Duke u mbështetur mbi këtë të

Në bartjen në shoqëri të kësaj dashurie, dhembshurie dhe mëshire, vakëfet janë, për njeriun tonë të ditëve të sotme, vende ku ekspozohet shembulli, modeli dhe ku merret mësim. Në këtë vepër lexuesi ka dalë për të vizituar një ekspozitë historike asistence sociale e mirëbërësie.



vërtetë, autori Osman Nuri Topbash në veprën e tij ka hartuar një kapitull të veçantë mbi shërbimin dhe etikën e tij, ku trajton etikën dhe kriteret e domosdoshme për personat prijës në rrugën e shërbimit shoqëror që të arrijnë aftësimin dhe vetitë e duhura në shërbimet që do të kryejnë.

Etika dhe kriteret përkatëse të klasifikuara në dymbëdhjetë pika përmbajnë pjekurinë e dyanshme që përbën fushën materialo-shpirtërore të anës së jashtme e të brendshme, të diturisë dhe kulturës, të mendjes dhe zemrës, të kësaj bote dhe përjetësisë, të domosdoshme për njeriun e shërbimit shoqëror. Synimi ynë është që personat kandidatë për të arritur cilësi të bukura e sublime, të jenë dhe të bëhen persona cilësorë e të denjë, të zgjedhur e të përkryer, të përgatitur në të dy anët, si zogjtë me dy flatra! Duke përmbyllur këto rreshta i urojmë lexuesit shqiptarë që ka pasur rastin të ketë nëpër duar këtë vepër kaq të nevojshme për jetën sociale të bashkësisë muslimane të kombit shqiptar, lexim të mbarë!



Xhamia Blu siç njihet në masë nga përrëndimorët, xhamia e Sulltan Ahmetit siç njihet në Turqi në të vërtetë kur u pat ndërtuar u bë e njohur në mesin e një-rëzve të thjeshtë si Xhamia e Re, për shkak të madhësisë dhe bukurisë së veçantë që kish-te. Xhamia është ndërtuar përballë sheshit të vjetër të hipodromit antik dhe në të djathtë të derës së hyrjes kryesore gjendet xhamia e Shën Sofisë. Ndërtimi i saj pat filluar në vitin 1609 me një ceremoni madhështore në të cilën pati marrë pjesë edhe vetë sulltani i asaj kohe sulltan Ahmeti I. Në të vërtetë xhamia është vetëm një pjesë e kompleksit të madh (kuli-je) të planifikuar për tu ndërtuar nga sullta-ni i asaj kohe dhe së bashku me tregun pas saj (arasta) ndërtimi i saj përfundoi në vitin 1917, ndërsa pjesët e tjera të kompleksit siç qenë medreseja, hamami, mensa për nevoj-tarët (imaret), shatërvanët, shtëpia e mjeki-mit (darushifa) etj. përfunduan në vitin 1620. Projektuesi i kësaj xhamie që arkitekti me

originë shqiptare nga Elbasani, Mehmet aga Sedefqari. Para së gjithash atij i duhej të për-zgjidhte një vend të pozicionuar mirë gjë që paraqiste vështirësi në Stambollin e shekullit të XVII, pas periudhës së artë të ndërtimeve të arkitekt Sinanit. Për të ndërtuar kompleksin e këtushëm sulltani dëmshtëpërbleu të venë e ish-kryeministrit Mehmet pashë Sokolit (me originë nga Peja) sarajet e të cilit u detyrua ti prishte. Megjithëse i mbeti besnik në disa aspekte të arkitekturës klasike të arkitekt Si-nanit, sërish arkitekt Mehmet Sedefqari solli të reja në arkitekturën e brendshme të xha-misë. Portiku i brendshëm u ndërtua i lartë duke mundësuar që të mbetej superior mbi të ndërtimet e tjera të kompleksit. Hapësira për kryerjen e adhurimit brenda xhamisë është 64x72 m, ndërsa lartësia është 43 metër e mbuluar me një kube të madhe me diametër 22 m. Në katër skajet e mbetura bosh të kësaj kubeje të madhe që është e rrethuar edhe nga katër gjysmë kubesh të tjera është ndër-

tuar edhe nga një kube e vogël duke formuar kështu një plan qendror. Të 260 dritaret me qemer të përkulur që e rrethojnë xhaminë në pesë rreshta kanë bërë që ambienti i brendshëm i saj të jetë i ndriçuar mirë.

Muret e xhamisë janë të mbuluara me çini ku bie në sy ngjyra blu deri në rreshtin e dytë të dritareve. Edhe fil ayaklari nga gjysma e sipër, qemerët, sipërfaqet në formë trekëndëshi që quhen pandantiv, gjysmë kubetë dhe pjesa e brendshme e kubesë së madhe janë zbukuruar me punime kaligrafike ku për bojë është përdorur ajo ngjyrë blu. Në pllaka gjenden shumë motive floreale si tulipanët, zymbylat, karafili, gjethet e përkulura. Në hapësirën e brendshme të ndriçuar mirë nga numri i madh i dritareve mbizotëron ngjyra blu dhe kjo ka bërë që vizitorët perëndimorë, pjesa më e madhe e tyre ambasador të shteteve të tyre në Stamboll, në shkrimet e tyre e kanë cilësuar xhaminë si xhamia Blu, emër me të cilin u bë e njohur në Perëndim.

Një objekt tjetër i kësaj xhamie është edhe kulla e sulltanit, në të vërtetë dhoma ku ai shkonte për të falur namazin e xhumasë, në të cilën shkohej nëpërmjet një të tatëpjete. Një tjetër karakteristikë e xhamisë së sulltan Ahmetit janë 6 minaret e xhamisë. Katër minaret që ndodhen në katër skajet e xhamisë janë me nga tri sherefe (rrethe përqark minares)

ndërsa dy të tjerat me nga 2. Kështu xhamia ka plot 16 sherefe nëpër minare, numër sipas disa studiuesve që ka lidhje me numrin rendor të mbretërimit të sulltan Ahmetit I, i cili për nga radha qe sulltani i 16-të që hipte në fron.

Sipas asaj që rrëfen Evlija Xhelebiu ndërtimi i kompleksit të sulltan Ahmetit, në të cilin vendin më të rëndësishëm e zinte xhamia kushtoi plot 1811 barrë 2944 akçe. Duke ditur se atëherë një barrë kishte 100 mijë akçe dhe se 120 akçe ishin të barabarta me një monedhë ari atëherë arrijmë në përfundimin se kostoja e ndërtimit kapte vlerën 1 milion e 510 mijë monedha ari. Xhamia u zbukurua me 21.043 çini.

Ashtu sikur se ngjante përherë ndërtimi i xhamisë la pa gojë shumëkënd, por pati edhe nga ata që e kritikuan sulltanin se e kishte bërë xhaminë me 6 minare duke konkurruar kështu xhaminë e Mekkes, e cila atëherë ishte xhamia e vetme me gjashtë minare. Këto fjalë u frynë aq shumë sa që u kthyen në debat fetar midis dijetarëve të fesë, debate të cilave sulltani u vuri pikën duke ndërtuar me fondin e tij personal një minare të shtatë për xhaminë e Mekkes për ti lënë kështu superioritetin që i takonte asaj xhamie edhe në planin arkitektonik. Shkrimet kaligrafike të xhamisë u kryen nga Kasim Gubari Dijarbakërlliu.



Klerikë myslimanë shqiptar nga Kosova



Pasi kemi trajtuar në numrat e kaluar klerikët myslimanë shqiptarë të Shqipërisë së sotme politike dhe trevave shqiptare në Maqedoni, në këtë numër do të trajtojmë përmbledhtazi të dhëna në lidhje me klerikët myslimanë shqiptarë nga Kosova. Ashtu sikur se edhe dy herët e mëparshme edhe këtë radhë jemi mbështetur në të dhënat e botuara nga regjistrat e Myftinisë së Stambollit.

Abdureshit efendiu: Lindi në lagjen Karakapëxhë të vilajetit të Kosovës në vitin 1866. Biri i Sylejman Agait i njohur me mbiemrin Karababajt. Mësimet e para i mori në vendlindje për t'i vazhduar më

pas në medresenë Meddah që gjendej në Shkup. Këtu i vazhdoi mësimet deri tek lënda mësimore Fenari. Në vitin 1893 caktohet në gjykatën fetare të Shkupi nga e cila do të largohej në vitin 1909 për shkak të gjendjes së luftës që pllakosi Ballkanin duke shkuar si emigrant në Stamboll. Nga të dhënat e dosjes personale mësojmë se në vitin 1913 merrte rrogë nga fondi i Ajdinit, ndërsa në vitin 1916 nga ai i Izmirit.

Bilal Syhejl efendi: Lindi në vitin 1283 H në kazanë e Mitrovicës, biri i haxhi Mustafa efendiut. Pasi mori mësimet e para në shkollën fillore që gjendej në lagjen Gazi

Isa Bej të Mitrovicës, mësoi nga myderrizët Osman dhe Abdulhalim efendi gramatikë dhe sintaksë arabe, librat e fikhut Multeka dhe Halebi, Gjylistanin për gramatikën perse. Në muajin shtator të vitit 1896 caktohet si arkëtar i të ardhurave të Mitrovicës, ndërsa në muajin prill të vitit 1898 caktohet në sekretariatit e dokumenteve zyrtare, detyrë nga e cila largohet me kërkesën e tij në vitin 1901. Pas pushtimit të Mitrovicës nga forcat ushtarake serbe ai largohet në Turqi ku caktohet të shkojë në Trabzon dhe megjithëse nuk pranon të vejë, nuk i pritet rroga që merrte.

Ibrahim Haki Efendiu: Lindi në vitin 1279 H në Mitrovicë, biri i Haxhi Mustafa Efendiut. Në vitin 1900 caktohet mualimi i parë dhe sekretar në mejtepin Ruzhdije të kazasë së Mitrovicës. Në vitin 1903 caktohet anëtar i gjykatës së shkallës së parë të kazasë së Preshevës. Në muajin korrik të vitit 1914 caktohet anëtar i këshillit për studimin e botimeve të fesë detyrë që e kreu deri në muajin prill të vitit 1923. Në shkurt 1928 caktohet në myftininë e Bakërkojit në Stamboll.

Ahmet Edip efendiu: Lindi në vitin 1258 H në lagjen Tërnofca të kasabasë së Preshevës, biri i Shaban Efendiut. Mësimet e para i mori në shkollën fillore të kasabasë ndërsa mësimet e larta fetare i kreu në medresenë e Shkupit. Në dosjen që ka plotësuar personalisht për t'ia dorëzuar zyrës së personelit fetar, pohon se dinte të shkruante dhe të lexonte në gjuhën shqipe. Në muajin shtator të vitit 1894 caktohet në myftininë e Senicës, që ishte qendra e sanxhakut të Novipazarit.

Nuh Nexhati: Lindi në fshatin Ranicë të kazasë së Preshevës në muajin shkurt të

vitit 1284, biri i Jusuf agait që kishte profesionin bujk. Pas mësimave të para u muar me mësimin e gjuhës arabe në Medresenë e Vjetër të Kumanovës.

Abdurrahman Sabit efendiu: Lindi në vitin 1285 H në kasabanë e Prishtinës, biri i Abdylhalim Efendiut. Pasi mësoi në shkollën fillore dhe plotore (ruzhdije) të Prishtinës shkoi për të vazhduar studimet në Stamboll ku qëndroi 12 vjet derisa u diplomua. Në vitin 1900 caktohet si naip në kazanë e Mitrovicës nga e cila largohet në vitin 1903 për të vazhduar detyrën e kadiut nëpër kaza të ndryshme të Anadollit dhe Trakisë Lindore deri kur këto treva u pushtuan nga ushtritë greke. Pas kësaj kalon në nënshtetësinë turke. Nga dokumentet që gjenden në dosjen e tij kuptojmë se në muajin gusht të vitit 1924 mbulonte detyrën e myftiut të qytetit Vize në Turqi.

Mehmet Kamil: lindi në lagjen Lap të kasabasë së Prishtinës në vitin 1885, biri i haxhi Rexhep efendiut, myderriz në medresenë e Prepolit. Për tetë vjet me radhë mësoi në këtë medrese. Vdiq në vitin 1915.

Mehmet Ruzhdi : biri i mualim Agush Namik Efendiut, lindi në vitin 1875 në Prishtinë. Vdiq në vitin 1916.

Mustafa Hamdi: Biri i Mehmet Emin Efendiut, lindi në kasabanë e Gjilanit në vitin 1837. Mësimet e fesë i mori në medresenë e Sulltan Selimit në Prishtinë, ku mësoi shkencat fetare dhe gjuhën arabe nga myderriz Abdylhalim Efendiu. Në prill të vitit 1287 caktohet myfti në moshën 35 vjeçare në Senicë, qendrën e sanxhakut të atëhershëm të Novipazarit. Në vitin 1297 caktohet myftiu i Prishtinës.



Gjatë kohës që kryente detyrën e myftiut në vitin 1908 zgjidhet si deputeti i Prishtinës në parlamentin e atëhershëm osman. Vdiq në vitin 1909.

Ahmet Nazif: Lindi në Prizren në vitin 1253 H, biri i myftiut të atëhershëm të Prizrenit haxhi Ali Kastamonasit. Mësimet e para të fesë dhe ixhazetin e mori nga myderrizi prizrenas Tahir efendiu. Në muajin mars të vitit 1858 caktohet në zyrën e kadiut të kazasë së Prizrenit. Nga muaji shtator i vitit 1869 deri në muajin korrik të vitit 1870 qe me detyrën naip në Tiranë dhe Krujë. Në vitin 1874 caktohet me anë të një dekreti perandorak në kryesinë e këshillit të Temyizit të vilajetit të Manastirit dhe pas shkrirjes administrative të kësaj qendre në Manastir dhe krijimin e vilajetit të Kosovës, shkon atje me detyrën e nëpunësit. Në vitin 1879 caktohet si naip në Prizren. Bëhet anëtar aktiv i lidhjes së Prizrenit dhe shkon deri aty sa që mbulon

edhe detyra në këtë organizim gjë që bëhet shkak të përndiqet dhe të nxirret para gjyqit ushtarak të Prizrenit. Syrgjynoset për një vit në Kastamonu të Turqisë. Me dekret të vitit 1885 falet dhe lejohet që të kthehet në vendlindje. Në regjistrin e dekorimeve shënohet se ka marrë 8 dekorata të klasave të ndryshme. Në vitin 1909 del në pension.

Ekrem Memduh efendiu: Lindi në Prizren në vitin 1278, biri i Xhemali Agait. Pas mësimave të para në vendlindje shkoi në Stamboll ku ndoqi mësimet e fesë nga Ibrahim efendi Kavaja, një nga mësuesit e përgjithshëm të xhamisë Fatih në Stamboll. Mësimet e lëna përgjysmë këtu i vazhdoi në Prizren në medresenë e Mehmet Pashës nga myderriz Abdylaziz efendiu. Nga muaji prill i vitit 1894 deri në muajin mars të vitit 1905 kreu detyrën e sekretarit të gjykatës fetare të Prizrenit. Nga muaji mars i vitit 1905 dhe deri në vi-

tin 1907 caktohet naip në kazanë e Lumës. Nga viti 1910 deri në vitin 1913 caktohet si naip në kazanë e Gucisë.

Hysen Nexhmedin Efendiu: Lindi në vitin 1274 H në fshatin Radomir të kazasë së Lumës, biri i Sadik Agait. Autor i disa librave fetarë të shkruar në gjuhën osmane. Vdiq me datë 3 Dhjetor 1933.

Mehmet Emin: lindi në Prizren në muajin korrik të vitit 1852, biri i Tahir efendiut, atëkohë myfti i Prizrenit. Mësimet i mori në medresenë e Emin Beut, në të cilën jep-te mësim si myderriz i ati Tahir efendiu. Në vitin 1872 caktohet si imam në xhaminë e Emin Pashës në Prizren. Në vitin 1883 pas vdekjes së të atit caktohet myfti i Prizrenit.

Nusret efendiu: Biri i Galip Agait i datëlindjes 1887.

Mustafa efendiu: biri i Sylejman Agait me profesion tregtar, i datëlindjes shtator 1291, i lindur në fshatin Gjilan. Në vitin 1910 caktohet në myftininë e kazasë së Mitrovicës.

Mehmet Efendi: Lindi në kazanë e Vushtrisë (Vulçetrinë) në vitin 1878, biri i Rexhep Agait. Pas shkollës fillore mësoi në medresenë e Prishtinës. Në muajin maj të vitit 1912 caktohet në myftininë e kazasë së Vulçetrinës.

Adem Nuri efendi: Lindi në vitin 1262 H në Gjakovë, biri i tregtarit Mustafa Aga. Pas mësimave fillestare në vendlindje shkoi në Stamboll ku ndoqi mësimet në xhaminë Fatih nga haxhi Iljaz Prishtinasi, i cili ishte ndërkohë edhe një nga mësuesit e fesë së pallatit perandorak. Nga muaji shtator i vitit 1882 deri në vitin 1891 punoi në dikastere të ndryshme të Zyrës së Fet-



vave në Stamboll. Vdiq në vitin 1914.

Malik Bektash Efendi. Lindi në muajin prill të vitit 1861 në fshatin Belek të kazasë së Gjakovës, biri i Nezir Efendiut. Pas edukimit të parë fillon mësimet në Rushdije, por pa e përfunduar këtë shkollë hyn në Medresenë e Madhe (Medrese-i Kebir) që gjendet në Gjakovë. Pas 9 vjetësh mësim në këtë medrese shkon në Stamboll ku regjistrohët në Medresenë e Amxha Hysen Pashës që ndodhej në Saraçhanebashë. Megjithëse në moshën 46 vjeçare me datë 23 Qershor 1907 emërohet në Myftininë e kazasë së Krujës. Pas dy vitesh shërbim në muajin maj të vitit 1909 jep dorëheqje nga ky post. Pas dorëheqjes me kërkesë të masës së popullit vjen dhe vendoset si myderriz në medresenë e kazasë së Shijakut. Më pas caktohet zyrtarisht si myderriz me datë 14 Mars 1910 me një rrogë prej 200 grosh (kuruş).

SHQIPËRIA PJESËTARE E UNIONIT MESDHETAR



Në kryeqytetin e Francës, Paris ka filluar nga punimet samiti për themelimin e Unionit të Mesdheut, ku marrin pjesë mbi 40 kryetarë shtetesh dhe qeverish, mes të tjerash edhe delegacioni shqiptar i kryesuar nga kryeministri aktual Sali Berisha.

Me krijimin e Unionit të Mesdheut të 27 vendet e BE-së dhe 17 vendet që shtrihen përgjatë detit Mesdhe në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme duan t'i japin një impuls të ri bashkëpunimit mes tyre.

Janë planifikuar një sërë projektesh si pastrimi i Mesdheut, lidhjet rrugore mes për Afrikën e Veriut dhe shtrirja e sistemit të energjisë diellore. Nismën për këtë projekt e dha presidenti i Francës Nikolas Sarkozy (Nicolas Sarkozy), i cili kryeson këtë gjashtëmujor presidencën e radhë në BE. Ai bashkë me presidentin e Egjiptit Husni Mubarak e drejtojnë këtë samit.

E reja këtë herë është që procesin e Barcelonës të ridinamizohet me një emër të ri dhe të tërhiqen më shumë në këtë proces edhe vendet jugore. Për këtë arsye ka një presidencë të dyfishtë, që do të ndikojë në marrjen e vendimeve të përbashkëta për projektet ndërajonale dhe ndërkufitare, si për shembull autostradat në Afrikën e Veriut. Nga vendet ballkanike Unionit i përkasin përveç Shqipërisë, edhe Bosnje-Hercegovina, Kroacia e Mali i Zi.

ARRESTOHET IDEATORI DHE SUPERVISORI I MASAKRËS BOSHNIJAKE

Ish kreu serb boshnjak Radovan Karaxhiç, u arrestua të hënën me datë 21 korrik 2008 në Serbi. Ai është një nga kriminelët e luftës më të kërkuar në botë. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY) e paditi atë në lidhje me konfliktin e 1992-1995 në Bosnje dhe Herzegovinë (BiH) që rezultoi në rreth 200,000 vdekje dhe dy milion refugjatë.



Karaxhiç u padit së pari së bashku me ish shefin ushtarak serb boshnjak Ratko Mlladiç në korrik 1995. Një padi e dytë kundër të dyve u konfirmua në nëntor të atij viti. Një padi e amenduar u lëshua përfundimisht për Karaxhiç në maj 2000 por u mbajt e fshehtë deri në 11 tetor 2002. Ajo e akuzon ish kreun serb boshnjak me dy akuza për genocid, pesë akuza për krime kundër njerëzimit, tre akuza për shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës dhe një tjetër për shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës.

Në 27 mars 1992 Karaxhiç u bë president i Këshillit të Sigurimit Kombëtar të republikës serbe dhe në 12 maj të po atij viti, një anëtar i presidencës së njësisë. Në 17 dhjetor 1992, Karaxhiç u bë presidenti i vetëm i Republika Srpska (RS) dhe tre vditë më pas, komandant suprem i forcave të saj të armatosura. Ai mbeti në këto poste kyçe, duke përfshirë kreun e SDS, deri në 19 qershor 1996, kur njoftoi largimin e tij nga politika.

Disa ditë pasi Karaxhiç kryesoi Këshillin e Sigurimit Kombëtar, ushtria serbe boshnjake bëri rrethimin e qytetit të Sarajevës. Deri në fund të majit 1995, trupat serbe boshnjake dhe artileria vendosur në kodrat rrethuese bombarduan rrugët dhe tregjet e qytetit ndërsa snajperët godisnin qëllimisht civilët. Rreth 10,500 civilë, duke përfshirë 1,800 fëmijë, u vranë dhe rreth 50,000 të tjerë u plagosën gjatë rrethimit 44-muajsh të Sarajevës.

Karaxhiç i cili ushtroi si pushtetin dhe kontrollin zyrtar dhe atë de facto mbi forcat serbe boshnjake dhe të gjithë SDS dhe autoritetet qeverisëse, u padit gjithashtu në lidhje me vrasjet e korrikut 1995 të deri në 8,000 burrave e djemve muslimanë boshnjakë kapur në disa vende të ndryshme në dhe pranë "zonës së sigurtë" të Srebrenicës. Masakra është konsideruar më e keqja mizori në historinë evropiane pas Luftës së Dytë Botërore.

Ai jetonte me emër të falsifikuar si Dragan David Dabic. Punonte në një klinikë private ku merrej me medicinën alternative. Ka patur edhe një faqe në internet www.psy-help-energy.com nëpërmjet së cilës reklamonte dhe ofronte shërbimet bioenergji.

KUJDES SHOKUN: BËN QË TË SHËNDOSHENI

Sipas një studimi të kryer nga ana e universitetit Warwick të Anglisë, studim i kryer mbi 27 mijë persona në Evropë, ekziston mundësia që ju të shëndosheni duke pasur një rreth shokësh të shëndoshë dhe obezë. Sipas hulumtuesve kjo e ka zanafillën tek prirja e individit për të krahasuar karakteristikat e tij me njerëzit përreth, në rastin konkret duke krahasuar peshën e tij me atë të miqve të tij. Nga studimi doli rezultati se njerëzit i vlerësojnë për normale kilet që kanë njerëzit përreth tyre dhe në këtë mënyrë pa qenë të ndërgjegjshëm ata mundohen të përcaktojnë peshën që duhet të kenë vetë. Në këtë studim u parashtrua edhe ideja se kjo prirje psikologjike, pra të vlerësosh vetveten me kile të tepërta është më e madhe tek njerëzit e diplomuar me arsim të lartë krahasuar me personat me arsimim dhe edukim më të ulët.



RREZIKU QË U PRET NGA ORËT E ZGJATURA TË GJUMIT

Sipas një studimi të kryer në Amerikë ka dalë në pah lidhja mes kohës së gjumit tek njerëzit e moshës së mesme dhe rrezikut të paralizës.

Studimet kanë treguar se mundësia e paralizimit tek individët që flenë më shumë se 9 orë në mbrëmje rritet me 70 %.

Dr. Jiu Chiuan Chen, pedagog në universitetin e Karolinës së Veriut, u shpreh se në kërkimet e mëparshme është matur



lidhja ndërmjet përqindjes së kohës së gjumit dhe vdekjes, por se nuk është gjetur ndonjë lidhje ndërmjet mënyrës së të fjeturit dhe sëmundjeve në damar dhe zemër.

Sipas Chen hulumtimet janë kryer me 93 mijë persona ndërmjet moshave 50 dhe 79 vjeç dhe është konstatuar se 8.3 % e tyre flenë 5 orë në ditë, ndërsa 4.6 % flenë më shumë se 9 orë në ditë. Pas një studimi prej 7 vjetësh e gjysëm studimet treguan se një mijë e 116 persona kanë shqetësime zemre koronare dhe mendohej se kjo shkaktohej nga mosngopja me oksigjen e trurit. Chen u shpreh se studimet dhanë këto rezultate në lidhje me rrezikun e paralizës për shkak të gjumit duke e krahasuar këtë me gjumin 7 orësh: 14 % për ata që flenë 6 orë ose më pak, 24% për ata që flenë tetë orë dhe 70 % për ata që flenë 9 orë dhe më shumë.

TË PINI ILAÇET ME LËNGJE FRUTASH: KINI KUJDES!

Studiuesit bëjnë të ditur se shoqërimi me lëng fruti molle, portokalli dhe greifurti ndërsa pini ilaçet mund të ulë efektin e disa ilaçeve dhe për këtë arsye i hapin rrugën pasojave të rrezikshme.

Studimi i realizuar nga shkenctarët kanadezë ka arritur në përfundimin efekti disa lloj ilaçeve kundër kancerit, zemrës dhe damarëve, kundër tensionit të lartë dhe disa antibiotikëve të shoqëruara me lëngje frutash është më i ulët.

Disa prej të anketuarve iu dha të pinë feksofenadin me ujë, ndërsa të tjerëve i njëjti ilaç iu dha të pihet me lëng fruti dhe pas ekzaminimit u pa që ilaçi i pirë me lëng frutash u përthith në masën 50 %, ndërsa me ujë në masën 100 % nga trupi.

Eksperimenti klinik i kryer tregoi se narinzhini që gjendet në greifrut pengon përthithjen e ilaçit nga trupi, ul efektin në përthithjen e ilaçeve siç është ai i kolesterolit duke penguar enzimin CYP3A4, enzimë që ndihmon në përthithjen e përbërësve të ilaçit, madje mund ta shndërrjë në lëndë helmuese atë.

Që para 20 vjetësh kërkimet e kryera nga Bailey patën treguar se pirja e lëngut të greifrutit apo edhe vetë ngrënia e këtij fruti ndërsa marrim ilaçin felodipin kundër tensionit të lartë mund të rriten në masë rrezikshmërie.

Edhe studime të tjera kanë treguar se pirja shoqëruar me greifrut e 50 ilaçeve të tjera mund të çojnë në rezultate të njëjta.

Përfundimet e eksperimenteve klinike u paraqitën në konferencën e organizuar nga Shoqata Amerikane për Kiminë në Filadelfia.

MOTOR KËRKIMI MË I FUQISHËM NGA KOMPANIA GOOGLE



Ish punonjësit e Google, motorit të kërimit në internet, i pari deri tanimë në botë, kanë hapur një faqe interneti që do ta konkurrojë atë dhe besojnë se motori i ri i quajtur Cuil kryen kërime më të mira se Google. Bëhet e ditur se motori i ri kërkes Cuil kryen kërime skematike, ndërsa të zotët e faqes pretendojnë se ky motor ka indeksuar deri më tani 120 miliard faqe interneti duke ia kaluar kështu që në fillim motorit kërkes Google, për sa i përket faqeve të indeksuara. Edhe motorë të tjerë kërkes të mëparshëm si Teoma, Vivosimo dhe Powerset u patën krijuar si konkurrencë kundër Google por ato e patën humbur betejën duke ia lënë vendin e parë Google deri më sot.

TË REJA TEKNOLOGJIKE NË BATERINË E KOMPJUTERAVE LAPTOP



Një ndër prodhuesit më të mëdhenj, i dyti nga radha, për kompjuterët PC, DELL-i, njoftoi për serinë e re të baterive Latitude e cila punon pa ndërprerje për 19 orë. Modeli që mban emrin Latitude E6400, ofron një jetëgjatësi për 10 orë të baterisë së saj, ndrysa bateria e dytë që ndodhet nën baterinë kryesore ofron edhe 9 orë të tjera punë. Me fjalë të tjera ju mund të punoni afërsisht një ditë të tërë me kompjuterin tuaj pa

pasur shqetësimin e ndërprerjes së energjisë elektrike. Zëvendës kryetari i kompanisë Dell, Jeff Clarke, ndërsa shprehej se ata ia kishin dalë mbanë ti ofronin konsumatorit një bateri që punon kaq gjatë pa ndërprerje, theksoi se ata kishin rishikuar edhe shumë pjesë përbërëse të kompjuterit në mënyrë që të sigurohet një shfrytëzim më i vogël i energjisë.

Një teknologji e këtillë është zhvilluar duke analizuar shumë faktorë që ndikojnë në jetëgjatësinë e baterisë me në krye kohën e rikonfigurimit të ekranit dhe të tërheq vëmendjen fakti që është vepruar në drejtim të standardëve industrialë ndërsa është projektuar matja e kohës së punës së baterisë.

Gjëra të tjera që bien në sy në serinë e re të laptopëve Dell është konsumimi i energjisë.

TELEVIZORËT E SHESHTË TË BREZIT TË RI: OLED

Superprodhuesi i gjërave elektrike, japonezi Sony planifikon për vitin në vazhdim që të nxjerrë në shitje në Evropë modelin e ri të televizorit të projektuar prej tij duke përdorur teknologjinë OLED (dioda organike që shpërndan dritë).

Revista Nikkei Business Daily shkroi se televizori OLED, prodhim i Sonyt i cili ka ngjyra më të shkëlqyera krahasuar me LCD dhe televizorët plazma do të nxirren në tregun evropian në vitin 2009, i cili është edhe tregu më i madh i shitjes së televizorëve me ekran të sheshtë në botë.



Televizorët Oled me trashësi 3 mm dhe që shpenzojnë më pak energji krahasuar me modele të tjera televizorësh ndodhen prej një viti në tregun japonez dhe në fillim të këtij viti kanë hyrë në tregun amerikan. Por dy tregjet më të mëdha të Sonyt për televizorët LCD e përbëjnë Evropa dhe Amerika e Veriut.

Auto Servis ÇIMI




Adresa:

L: Naim Gjylbegu
Rr: Fahri Ramadani
Pranë shkollës "Oso Kuka"

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2252694

Travel Agency "Globus"



Adresa:

L: Kongresi Përmetit
Rr: Oso Kuka
Shkodër / Albania

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2521043

Firma ILIRIA sh.p.k. me qendër në Shkodër



Pajisje për ambiente lokalesh
Prodhim dyer e dritare
Dhoma fëmijësh
Pajisje kuzhine
Pajisje zyrash
Dhoma gjumi

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2523565

Firma Ilir Muçaj sh.p.k. me qendër në Shkodër



Tregton artikuj të
ndryshëm ushqimorë
dhe industriale me
shumicë dhe pakicë.

Mobil/Cel: 00355 (0) 68 4067440